

Rrugat e Arbërit

10 vjet
gazeta
Rrugat e Arbërit

www.rrugearberit.com

GAZETË E PAVARUR. NR. 7 (123). KORRIK 2016. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Liqenet
e Balgjajt,
bukuria e
heshtur

Nga **Agim Totraku**



3

Aty ku
shërohet
trupit dhe
shpirti

Nga **Shqip Marku**



4

Turizmit
i mungon
'mençuria
dibrane'

Nga **Edmond Hasani**



2

EKSKLUZIVE / Flet nënkampionia e Europës në atletikë, flamurbajtësja e ekipit tonë olimpiq në lojërat e "Rio 2016": Dua të nderoj Shqipërinë duke synuar medalje

Luiza Gega,
'Flutura kuq e zi'

Nga **Defrim Methasani** - faqe 12-13



Korabi,
surprizë edhe
në Superiore

Nga **Eduard Illica** - faqe 15

■ **Ç'kemi** asaj Dibre! ■ Reportazh: **'Prapë na çeli Grama...'** ■ **Pesë** kuriozitete rreth Kalasë së Dodës ■ **Ferma "Kryemadhi"**, një model i suksesshëm i frutikuturës ■ **Masakër** në pishnajat e Gurë Lurës ■ **Unë jam** djalë Dibre... ■ **Njeriu** që mposhti errësirën ■ **Muhurri**, vështrim ekonomik, historik dhe etnokulturor ■ **Kohë** korresh ■ **Okshtuni** në këngët e trimërisë ■ **Muza** poetike budiane ■ **Një libër** që përcjell tinguj dashurie ■ **Jashar Delishi**, veterani i lirisë ■ **Emigrimi** në sytë e një djaloshi

Traditë dhe turizëm

Ringjallja e Rekës së Epërme

Intervistë - Tafë Ameti



8

Guida malore, ja vendet që mund t'i vizitoni

Nga **Grehans Uka**



6

kNAUF

Bashkëpunon me komunitetin

www.knauf.al

KUJTOJMË BASHKËPUNËTORËT tanë se çdo shkrim i botuar në një media tjetër apo rrjete sociale nuk ka përparësi botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë! Faleminderit për mirëkuptimin!



Gazetë e pavarur.
Nr. 7 (123). 1 - 31 Korrik 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "e".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:

Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA

Kontribuan për këtë numër:

Xhafer MARTINI
Defrim METHASANI
Tafë AMETI
Shqip MARKU
Edmond HASANI
Agim TOTRAKU
Gazmend KËRKUTI
Eduart ILNICA
Nazmi KOÇI
Zaim ELEZI
Hamdi HYSUKA
Selman MËZIU
Dionis XHAFI
Ruzhdi BITRI
Metush SKEJA
Grehans UKA
Fitore DOMA
Renato TOTRAKU
Mevlud BUCI

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit www.rrugaearbërit.com.

Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit rrugaearbërit@gmail.com

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:

Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:

Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603

E-mail: rrugaearbërit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.



Opinion

Duke fotografuar brigjeve të Drinit...

Turizmit i mungon 'mençuria dibrane'

Nga EDMOND HASANI

Kur themi 'Dibra' nënkuptohet 'mençuria dibrane'. Kur shikoj resurset e pasura plot bukuri të natyrës dibrane plot gjelbërim, lumenj, male, fusha, pyje, bie në mërzi, sepse këtyre vlerave natyrore dhe klimës së shkëlqyer në të katër stinët e vitit, ju mungojnë dy gjëra kryesore, për të zhvilluar atë turizëm që bota e ka prej më shumë se 100 vjetësh: mungojnë disa rrugë të mira si dhe me kryesorja, mungon mendja e dibranit!

Shkoj shpesh pranë Korabit, falë dhe rrugës së asfaltuar, por hotele a motele nuk sheh askund! Edhe në dy a tre lokale ku gatimi është 'bio' lë për të dëshiruar higjiena, komunikimi, estetika etj. Iki shpesh shëtitje në këmbë a me makinë maleve të Dibrës. Bjeshka e Illicës ose e Fidës është pasuri magjike, por rruga është *ibret!*

Bëj shpesh në këmbë rrugën e vjetër Muhurr - Katund i ri, buzë Drinit dhe me sytë e mendjes e shikoj të asfaltuar, si bulevard, të ndriçuar dhe me kampingje turistike apo motele.

Dibra e mençur është e varfër në mendje turistike, jo vetëm nga mungesa e vizionit të qeverive, por edhe e vete banorëve, që shpesh herë prishin edhe ato vende, pronë e tyre, si kullat historike apo vende të gjelbëruara të pa shfrytëzuara për turizëm.

Unë jam përgjithësisht optimist dhe malet i ngjis në këmbë, por për turizmin në Dibër nuk kam shpresë për zhvillim, deri kur dibranët të hapin mendjen edhe për këtë vlerë fitimprurëse, relaksuese, sportive siç është Turizmi!

Ngjitem mbi Bugjunc deri ku mbaron asfalti dhe në liqenin e Kuplanit sipër e shoh veten si pronar të ndonjë fshati turistik që dominon mbi gjithë luginën e Drinit që sheh poshtë.

Iki në Arras, atje ku Bajram Krrashi ka ndërtuar një stacion trofte modern, ku Seta zbret bukur në Drin dhe ku asfalti mungon për ta shijuar këndshëm troftën dhe bukurinë turistike të zonës.

Lura, për të cilën flasim vazhdimisht me krenari për bukuritë e saj, por që mungesa e rrugës moderne nuk na lejon t'i shijojmë liqenet e famshme dhe gjithçka tjetër.

Qyteza, vendbanimi i lashtë prehistorik me pamje madhështore kalaje natyrore mes

Bellovës dhe Zagradit është gjithmonë një joshje, por kënaqësia nuk finalizohet dot nga mungesa e rrugës që mund të na ndihmojë të njohim bukuritë e bjeshkëve përreth...

Dibra e mençur është e varfër në mendje turistike, jo vetëm nga mungesa e vizionit të qeverive, por edhe e vete banorëve, që shpesh herë prishin edhe ato vende, pronë e tyre, si kullat historike apo vende të gjelbëruara të pa shfrytëzuara për turizëm.

Unë jam përgjithësisht optimist dhe malet i ngjis në këmbë, por për turizmin në Dibër nuk kam shpresë për zhvillim, deri kur dibranët të hapin mendjen edhe për këtë vlerë fitimprurëse, relaksuese, sportive siç është Turizmi!

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga BUJAR KAROSHI

Vapë e madhe këtë muaj. Aq vapë sa deputeti ynë i LSI tha një të vërtetë në Twitter dhe e përjashtuan nga grupi. Do Zoti nuk mban shumë vapë në gusht e thotë ndonjë të vërtetë tjetër që të bjerë qeveria...

Qeveria tha lajmin e madh se rrugën e Arbrit do ta taksojmë. Dhe e thonë me bujë të madhe. Kur vjen puna për të dhënë ndonjë lajm se kur do ta fillojnë, bëjnë të gjithë sikur nuk dinë gjë... E di vetëm Ai, i madhi...

Të paktën e shënuam një rekord: do ta mbajmë mend si të vetmen rrugë, që para se të fillojë të ndërtohet do ta vendosim se sa do të taksohet. Që t'i bëjnë mirë llogaritë kur të llogarisin fondet...

Ajo rrugë e shkretë po na del edhe natën në gjumë. Na bëri edhe Noizin me stres. U detyrua i shkretë të merrte helikopterin për Dibër, se po të shkonte nga rruga do shkonte për gjumë, jo për punë...

Turizmin këto kohë është një fjalë shumë e përdorshme. Dhe në Dibër ia kemi nisur në këmbë maleve... Zoti na nxjerrtë me hajër!

Jo vetëm turizmi që nuk po na ecën, por duket se na ka dënuar edhe Zoti! Ua lëshoj rrufenë në bjeshkët e Illicës, sa janë trembur jo vetëm ata, por edhe ne që kemi në plan të shkojmë.

Sikur të mos mjaftonin vështirësitë, një fantazmë na doli në liqenin e Fushë Studenit. Tani nuk na e mban më të shkojmë atyre anëve, sa të nxjerrë qeveria një lajmërim se në atë nahije ka hyrë policia...

Policia ka gjetur hashah në ca parcela nga Bulqiza e Dibra. Gojë të liga thonë se i gjeti dhe i asgjësoi ngaqë nuk kishin marrë leje...

"Roja i gjelbërt" i punon syri, është bërë para drejtorisë së policisë parkim lfish me dru ahu, ndërsa "rojes së sharrës" i duhen syze dhe dylbi, se as nuk sheh e as nuk mundet me ju ngjit Tërthores e me pa se kush po i rrëzon pishat përtokë...

Andej nga Lura, meqë rrugë nuk ka e turistë nuk duken, thamë ta marrim edhe njëherë sëpatën e ta provojmë pret a s'pret. Priste, priste, por më mirë pret motosharra.

U alarmua shteti dhe çojti sejmënët e vet në katund, por nuk tregon njëri se kush po i priste pyjet. Me sy kanë pa e me vesh kanë dëgju, por me gojë s'tregojnë...

Ama, gojën disa e kanë hap me lanë Dibrën e me u bashkue me Mirditën. Se kështu kanë shpresë me u lidh me Tiranën...

Kur të vjen e keqja, hapi derën, thuhet. Na ka zënë dermatozia lopët, dhe nuk ka vaksinë që i bën derman. Ndërsa qeveria që duhet me na ndihmue, e ka mendjen te plazhi dhe reformat...

Bashkinë e kemi akoma me kryetar të emëruar. Nuk po vendoset për zgjedhjet e reja, se kemi shpresë që gjykatat të na e kthejnë kryetarin në detyrë. Në fund të fundit, ne kemi prodhuar skandale të reja, kështu që nuk duhet të merremi me lajmet e vjetra.

Ky muaj ishte edhe muaji i korreve. Shyqyr që na kanë mbetur ca tomorrica që nga ajo kohë, se kombajnati nuk hyjnë më në arat me grurë: nuk ka rrugë dhe s'të lënë gardhet...

Të dhënat zyrtare thonë se në Dibër nuk kemi asnjë shkollë të atij, që s'duhet me ia përmend emrin, si ia thonë, Gulenit! Kështu që në marrëdhëniet ndërkombëtare i kemi ndërtue fuqishëm aleancat...

Në fillim të muajit patëm Ramazanin... "Shum majr ia kalum. Shtruan në shëtitorën e re një iftar për gjithë qitetin... Me na e pas zili edhe vetë Stambolli..."

Lajme më të mira këtë muaj na vijjnë nga Korabi. Jo nga mali, nga futbollit. Kemi gjet trajner, kemi gjet dhe pare. Tani na mbetet vetëm me luftë në fushë e me marrë ndonjë fitore. Që t'u tregojmë shqiptarëve se e kemi meritue kategorinë superiore...

Në fund, desha me shkrujt edhe për disa lajme të tjera për kronikat rozë dhe horror, por për to pyet Fejsbukun ose Gogolin, se unë nuk di gjë...

Udhëtim rreth liqeneve të mrekullueshme të Balgjajt: mes ajrit të freskët, florës së mrekullueshme dhe faunës së egër.

Liqenet e Balgjajt, bukuria e heshtur

Nga Agim TOTRAKU

Në vendin ku kryqëzohen të katër grykat e Katërgrykëve, teksa merr rrugën nga ura që të çon drejt Kacnisë, të del përpara me gjithë madhështinë e tij të padiskutueshme vargmali i Balgjajt. Natyra e tij kryelartë e madhështore, gjelbërimi gjithëbimor e pothuaj gjithëvjeter, ajri i freskët që, i dehur nga oksigjeni, zbret me valëzime nga majat e tij piktoreske, uji i kristaltë që me vezullime merr rrokullisjen nga liqenet e bukura, në të cilat laheshin dikur zanat e legjendave të të parëve tanë, të gjitha këto së bashku duket sikur të bëjnë një grishje të pakundërshtueshme për t'i pushtuar këto vise.

Pikërisht këtu fillon mëdyshja, pasi, për të arritur deri atje, janë dy rrugë të ndryshme.

Rruga e parë fillon e qete dhe e shtruar nga Ura e Lunares përgjatë rrugës automobilistike, duke e përshkuar Kacninë mospërmasë për rreth 3 km deri te Margjoket, aty ku ajo takohet me Përroin e Peshkut. Ky përrua e ka marrë emrin nga fakti se është i populluar në shumicë me peshq të egër të vegjël, por shumë të fuqishëm për të përballuar furinë e rrjedhës së tërbuar të ujërave shumë të ftohtë që burojnë nga mëma e tyre atje lart, te liqenet. Duke u nisur në këmbë nga ky vend e deri në lartësitë e liqeneve në Shtrunksë duhet rreth një orë e gjysmë. Me ndërtimin e hidrocentralit të Kacnisë, është bërë e mundur që edhe ky segment të përshkohet i tëri me fuoristradë.

Rruga e dytë, nga Ura e Lunares deri te ish-miniera në Hurdhë, për 17 km është e përshkueshme me fuoristradë apo me makina më të larta. Pjesa tjetër, në një gjatësi 4 km është më e vështirë, por që mund të kalohet nga automjetet e rënda. Ndërsa në këmbë përshkohet për rreth 1 orë e gjysmë.

Në varësi të rrugës që ndiqet, qëllimit të rrugëtimit, mënyrës se si vendos t'i shijosh këto bukuri, nevojiten një deri dy ditë për t'u bërë mysafir i këtyre perlave.

Konfiguracioni gjeografik i ka dhënë dhe emrin vendit që të shfaqet si në ekran, Shtrunksë, si ena e drunjte e shtrunksës, që të parët tanë përdornin për të mbajtur ujin e pijshëm. Gjithçka të bukur që natyra i ka dhuruar me shumë bujari këtij vendi të del përpara si në ekran. Pyjet e larta të pishës, armenit, bredhit, plepit të egër etj., formojnë kurorën mbretërore që plot krenari e mban mbi kokë ky vend. Bukuria që lulet e zonjës i japin këtij vendi është vërtet e pakonkurueshme. Drithërohesh nganjëherë kur shkon ndër mend faktin se duar të pamëshirshme mundohen ta prishin këtë bukuri vërtet përrallore. Liqenet e Shtrunksës, të vendosura si me dorë sipër njëri-tjetrit, me parimin e enëve komunikuese, të lënë pa mend kur i sheh në sfilatë tek tregojnë secili hijeshitë e tyre të papërsëritshme. Fusha e gjerë disahektarëshe e Shtrunksës, me ujërat që rrjedhin mospërmasë qetësisht e me ajrin dehës që e mbulon nga sipër, të krijon ndjesinë e pangopësisë me oksigjenin më të pastër në botë. Pasi të kesh përfunduar një ndeshje futbollit a volejbollit, lodhjen ta shuan si me magji uji tejet i freskët.

Pasi të jesh miqësuar me këtë vend që ngërthen plot tregime e gojëdhëna, kureshtja të shtyn për ta eksploruar më tej, ku mendja



Pesë liqenet e Shtrunksës. Foto ilustruese të këtij shkrimi: © Agim Totraku

vetvetiu është e përqendruar te liqenet që gjenden me shumicë në këto maja. Sipërfaqja e përgjithshme e liqeneve të Shtrunksës e Bataqeve është 21ha dhe me kapacitet total ujqor rreth 60 milionë m³ ujë. Origjina e tyre është akullnajore. Gjatë ngjitjes përmes pyjeve, papritmas, mes degëve të ahut e të pishave, fillojnë të shfaqen rrezatimet vezulluese të peizazhit që të del përpara. Befas, gjendesh përballë një hapësire ujore të madhe, Liqeni i Pishës së Lice me një sipërfaqe 1 ha, me kapacitet 10 mijë m³ ujë dhe thellësi 4 m. Sipër tij, më i madhi e më madhështori është Liqeni i Zi me sipërfaqe 10 ha, me kapacitet 400 mijë m³ ujë dhe thellësi 12 m. Në ngjitje, perëndim të Liqenit të Zi ndodhen liqenet e Barzane, njëri me sipërfaqe 1 ha, me kapacitet 5 mijë m³ ujë dhe thellësi 1-2 m dhe tjetri me sipërfaqe 2 ha, me kapacitet 20 mijë m³ ujë dhe thellësi 5 m, i mbuluar pothuajse tërësisht me zambakët e bu-

kur të ujit. Në krye të vendit, si për t'i dhënë më shumë rëndësi vetes, ndodhet Liqeni në Kep, me sipërfaqe 10-12 ha, me kapacitet 400 mijë m³ ujë dhe thellësi 8-12 m. Ky është liqeni që bën furnizimin me ujë të liqeneve që gjenden poshtë tij. Në veriperëndim të këtij grupimi ndodhet Liqeni i Kolemadhit, me sipërfaqe 6 ha, me kapacitet 5 mijë m³ ujë dhe thellësi 4 m, hapësira e të cilit ka shkuar drejt reduktimit si pasojë e prurjeve. Sipër tij, i fshehur e i qetë ndodhet liqeni i vogël i Loshe.

Nëse nga fusha e Shtrunksës merr drejtimin juglindor, pasi të lësh në të djathtë liqenin e vogël të Rame, të dalin para syve me po të njëjtën madhësi liqenet e bukura të Bataqeve. Duke marrë emrat e fiseve që zotëronin kullotat përreth tyre, këta liqene mbajnë emrat e Kalisë, Milloshit, Bruce etj. Mes disa liqeneve në këtë hapësirë, katër janë të mëdhenj. Po japim një vështrim të tyre duke u nisur nga veriu drejt

jugut. I pari me sipërfaqe 2 ha, me kapacitet 20 mijë m³ ujë dhe thellësi 5 m. Liqeni i dytë, i Kalisë, me sipërfaqe 2 ha, me kapacitet 30 mijë m³ ujë dhe thellësi 8 m. Liqeni i tretë është me sipërfaqe 2 ha, me kapacitet 15 mijë m³ ujë dhe thellësi 5 m, ndërsa liqeni i katërt është me sipërfaqe 1,5 ha, me kapacitet 15 mijë m³ ujë dhe thellësi 8 m. Në paraqitjen e këtyre detajeve do dëshiroja të falënderoja shumë Adem Ramën, një mbikqyrës nga Kacnia i punës në këto hapësira, së cilës i është përkushtuar me devotshmëri.

Nuk mund të lemë pa përmendur këtu edhe florën e faunën tejet të pasur të këtyre viseve. Nga flora mund të përmendim bredhin e bardhë, plepin e egër, pishën e zezë, armenin, bredhin e bardhë, qershinë e egër (boronicën), lulen e pishës, lulen e zonjës, luledelen, mjedra, luleshtrydhja e egër, lulja agulice, manushaqja blu dhe e verdhe, shtara, drunakuqi etj. Kurse nga fauna përmendim dhinë e egër, kaprollin, derrin e egër, lepurin e egër, gjelin e egër, thëllënzën, ariun e murrmë, ujkun, dhelprën, shqarthin, macen e egër, rriqebullit etj.

Në një numër të përgjithshëm rreth 15 liqenesh me origjinë akullnajore, në një lartësi 1700-1800 m mbi nivelin e detit, ku përkarshi tyre, me po të njëjtën bukuri e madhësi qëndrojnë liqenet e Allamanit në anën e Matit, me një florë e faunë shumë të pasur, e them me sigurinë më të madhe se kurora liqenore e Balgjajt konkurron me dinjitetin më të madh simotrën e saj, kurorën liqenore të Parkut Kombëtar të Lurës.

Këtu ka plot vend për ndërtimin e një parku veror, ndërtimin e një parku dimëror, ndërtimin e një spitali për kurimin e sëmundjeve të ndryshme të brendshme.

Ftojmë ta vizitoni këtë vend vetëm një herë ata që janë të pasionuar në ngjitjen e lartësive, ata që kanë vendosur që seriozisht të eksplorojnë natyrën e virgjër shqiptare, ata që vërtet dëshirojnë të shijojnë ajrin plot oksigjen, ujin e kristaltë të lartësive e natyrën plot ngjyra. Ju siguroj se nëse ka një herë të parë, patjetër do të ketë një herë të dytë.



Liqeni n'Kep (Shtrunkse)



Liqeni i Kolemadhit



Liqeni i Pishave te Lice



Liqeni i Zi, Shtrunkse

Dibër e Madhe: Ja vendet që mund të vizitohen gjatë kësaj vere

turizëm

Uji dhe mali, aty ku shërohet

Nga SHUIP MARKU

Edhe në Dibër të Madhe dhe rrethinat e saj ka një zhvillim të turizmit malor vitet e fundit. Përveç llixhave që është një destinacion jo vetëm turistik por edhe kurativ, në Dibër ofrohen edhe guida të tjera turistike gjatë vitit, sidomos në verë, që janë shumë ndjellëse për turistët vendas dhe të huaj.

Më poshtë po paraqesim një vështrim të shkurtër të disa vendeve që mund të vizitoni gjatë kësaj vere:

TURIZMI MALOR, NJË MUNDËSI QË TË BËN NJËSH ME NATYRËN

Masivi malor Deshat shtrihet përgjatë kufirit maqedono - shqiptar dhe përbën pjesë të vargmalit Sharr - Korab - Deshat - Kërçin - Stogovë - Karaorman. Maja më e lartë në masivin e Deshatit është Velivari 2,373 metra. Në vetë malin ka edhe disa liqenjë akullnajorë, më i njohuri është liqeni Lokuv, i cili është liqeni më i ulët akullnajor në Maqedoni. Në anën lindore të malit rrjedh lumi Radika, e cila e ndan Deshatin prej Bistres dhe Stogovës.

VELIVARI ndodhet në malin Deshat, në lartësi mbidetare prej 2.373 metrash. Në vetë majën Velivar, kalon kufiri në mes Maqedonisë dhe Shqipërisë, ku gjendet edhe guri kufitar i gjysëm i shkatërruar - piramida. Velivari përfaqëson shpat të lartë shkëmbor të mbuluar me bar të lartë dhe të dendur, i cili ngrihet mbi kurorën e Deshatit në luginën e Radikës nga ana e Maqedonisë dhe rrëzën e saj në luginën e Drinit të Zi nga ana e Shqipërisë. Deri të maja Velivar arrihet duke ecur në këmbë për rreth 3 - 4 orë prej fshatrave Bitushë dhe Trebishtë.

LOKUV është njëri prej pesë liqeneve akullnajor në malin Deshat. Ai është liqeni më i ulët akullnajor në Maqedoni dhe gjendet në lartësi mesatare prej 1.565m. Format e tokës dhe terrenit në cilin gjendet liqeni tregojnë se më e besueshme është se nuk ka prejardhje akullnajash (glaciale), por ka prejardhje natyrore tektonike. Emri Lokuv rrjedh prej bimës me të njejtin emër që rritet në rethinën e liqenit, pak e besueshme është se emri rrjedh prej fjalës "lokva" (pellg). Deri tek lokaliteti arrihet më këmbë në gjatësi prej 8 km nëpër shtigje të shënuara në mal. Ka mundësi për tu nisur prej dy lokacioneve edhe atë prej f. Bitushë prej tek karakolli i vjetër ose f. Trebishtë. Ka mundësi që të huazohen edhe kuaj, kurse shtegu është mesatarisht i rëndë dhe gjatë gjithë gjatësisë është e mbuluar me pyll të bukur dhe freski, bukur duket kanjoni i lumit Radika, Manastiri sh. Jovan Bigorski dhe pejsazhe tjera. Në afërsi të liqenit në rreth 30-40 minuta hecje në këmbë mund të vizitohen edhe disa «sy mali» (liqene të vogla me ujë të kthjellët të pastër të shpërndar në rrëzat e malit).

LUMI RADIKA është rrjedha e djathtë më e madhe lumit Drini i Zi dhe i takon pellgut ujqor të detit Adriatik. Radika buron në lartësi mbidetare prej 2.200 metra nën Vracë, prej burimit deri në derdhje në Liqenin e Dibrës është e gjatë 67 km. Radika ka ujë të kthjellët, të pastër dhe të ftohtë me nuancë të ngjyrës se gjelbërt të errët që është si rrjedhojë e kalcium karbonatit në të.



Kanjoni i lumit është i vjetër disa milion vjetër dhe përshkon mes maleve Bistra dhe Stogovë në lindje dhe maleve Korab e Deshat në perëndim. Lumi Radika është i vetmi lumë ujrat e të cilin derdhen në dy pellgje ujore atë të detit Adriatik dhe detit Egje. Me kanale pjesë të ujrave të Radikës dërgohen në Liqenin e Mavrovës të cilin e mbushën me ujë, e prej aty me tunel nëntokësor dërgohet në Vardar.

UJËVARA E DUFIT gjendet në rrëzën e Malit të Radostushës, 20 minuta në këmbë prej qendrës së fshatit Radostushë, në lartësi mbidetare rreth 1500 metra. Ujëvara është vepër e natyrës, që është krijuar prej ujrave të Lumit të madh dhe Lumit të Vogël, të cilat rrjedhin në vendin që është 2 km para rrugës. Në shkëmbinj të nëpër kanjon ka edhe njëzet shpella të tjera më të vogla e më të mëdha. Dimrit kjo ujëvarë ngrin dhe krijon një fenomen interesant. Për shkak të kondenzimit të lagështisë, këtu krijohet fenomeni i pikave të ujit, dhe krijohet përshtypja sikur bie shi.

SHPELLA E SHARKUT gjendet në komunën e Mavrova-Radostushës, në parkun nacional Mavrova, i locuar në afërsi të shtëpive të fundit të fshatit. Shpella gjendet në thellësi prej 20 metrash nga hyrja e saj, me gjërësi rreth 18 metra dhe gjatësi 25 metra. Në pjesën e poshtme të saj gjendet një vrimë e cila çon deri tek dy salla tjera të shpellës të cilat akoma nuk kanë qasje për turistët. Shpella është zbuluar para më shumë se tre dekadash. Sipas një përalle lidhur me gjetjen e kësaj shpelle, fshatari me emrin Sharko, i cili ka banuar në afërsi të shpellës, i pari ka marrë guximin. Ai ka prerë disa drunj dhe është lëshuar në vrimë dhe me ndihmën e fqinjëve, ka arritur të futet në mbrendësi të shpellës. Bukuroshen e nëntokës e zbukurojnë stalaktite dhe stalagmite të mbuluara me korale, pellgje, ushtima dhe zbukurime të tjera shpellash, të cilat i japin pamje të një bukurie të pa prekur. Pasi toka është e pasur me hekur,

shumica e dekorimeve janë me ngjyrë të kuqë-në të kafe. Në Vrimën e Sharkut, ka botë shtazore të llojllojshme si: lakuriq, merimanga, zvaranikë dhe lloje të ndryshme insektesh.

Diku në mes të rrugës, në mes banjës së Kosovrastit dhe Dibrës, ndodhet **SHPELLA E KRISTALTË**. Në të mund të shihet dhe gjendet kristali unik – seleni, që përveç se në këtë vend gjendet vetëm në Meksikë. Ky kristal i selenitit me 99% pastërti është unik edhe për shkak të kushteve, shtypjes së tokës dhe kodrës, përbërjes kimike dhe ujrave termal. Vetë pas disa metrave nga hyrja fillon të ndjehet ajri i ftohtë, por edhe era e sulfurit i cili vjen prej disa burimeve të ujit mineral në rrethinë. Temperatura në shpellë është gjithmonë 17 gradë celzsius.

SHTEGU MALOR Banjisht-Kosovrast. Një shtegu mjaft i bukur malor, fillon prej fshatit Banjisht, kalon mbi qytet nëpër fshatin Elevcë dhe mbaron në anën tjetër të malit në fshatin Kosovrast e Epër. Shtegu mund të kalohet edhe me biçikleta malore.

FSHATRA TË DUHEN VIZITUAR

FSHATI GAJRE është njëri prej fshatrave më të bukur në Maqedoni. Gjendet në shpatin e malit Stogovë, në luginën e Lumit të Gajres, fshati i takon rajonit të mijakëve. Në lartësi mbidetare prej 1170 m, fshati është ndërtuar në formë amfiteatri i kthyer kah Lumi i kulluar i Gajres, me arkitekturë të ruajtur karakteristike për traditën ndërtimore të mijakëve dhe me përdorim të theksuar të materijalit ndërtimor lokal. Karakteristikat e kësaj arkitekture rrjedhin prej vendndodhjes dhe kushteve klimatike të rajonit

të mijakëve. Lokacioni ku është vendosur fshati ka klimë karakteristike kontinentale me verë të freskët dhe dimra të ashpër.

GALIÇNIKU më së shumti njihet sipas zakoneve të Dasmës së Galicnikut. Fshati është përfaqësues i drejtpërdrejtë i arkitekturës tradicionale, adeteve lokale, dhe traditave indigjene. Fakti se fshati është pjesë e parkut nacional "Mavrova" karakterizon veçanërinë e vet dhe kujdesin e merituar të cilin e gëzon. Shtëpitë në këtë fshat janë të tipit të mbyllur, me organizim të thjeshtë të brendësisë, të ndërtuara me materijal lokal. Çardaku, element karakteristik i arkitekturës tradicionale maqedonase, është i pranishëm thuajse në secilën shtëpi dhe është i tipit të mbyllur.


KIÇINICA është pasqyrim i jetës së përditshme të shekullit të XIX, përshkrim antropologjik i kohës kur në rajonin e Dibrës-Rekës është zhvilluar tradita e pikturimit, sot ajo shihet në kishën Shën Nikolla. Fshati malor i llojit kompakt, i vendosur në shpatet e malit Bistra në parkun nacional "Mavrova", jep përshtypjen se aty ka qenë përgjithmonë, mes shpateve përreth, pyjet me pisha të argjenda dhe kullosave të afërta. Shtëpitë tipike fshatare në Kiçinicë kanë koncept të pozicionimit, funksionalitetit dhe energjisë në rrethinën e vet që të kujton historitë popullore-vlerat kulturore të treguara në rrethet familjare.

HAMAMET E DIBRËS

Hamami i ri gjendet në qendër të qytetit të Dibrës. Nuk ekzistojnë të dhëna të sakta se kur është ndërtuar objekti, por spjegimet datojnë



Foto: © Gazmend Kërkuti



FSHATI GALIÇNIKU

trupit dhe shpirti

kah shekulli XVIII dhe rindërtimi i cili besohet të jetë realizuar në shekullin e XIX. Hamami sipas konceptit dhe funksionit i takon llojit të zhvilluar të hamamëve. Ky hamam është i njohur pas asaj se është hamami i vetëm në Maqedoni i cili i përmban elementet funksionale - sallë shadërvani, kapallëk, halvë, haznë dhe qulhan, dhe më gjatë ka funksionuar si hamam, deri në vitin 1992. Sot ky objekt është rekonstruktuar, i shëndruar në galeri arti.

Hamami i vjetër i Dibrës është monument kulturor në të cilin janë të dukshme vlerat stilistike dhe arkitekturore të stilit klasik të arkitekturës osmane. Konstruktivi është prej mureve masive dhe kupolave të realizuara me gurë dhe tulla me materijal gëlqeror. Hamami i përmban të gjitha karakteristikat dhe hapsirat e nevojshme për funksionim. I vendosur në pjesën qendrore të qytetit, Hamami i Vjetër në Dibër, edhe pse momentalisht i braktisur, i larguar prej vëmendjes, përsëri disponon me hapsira dhe energji të cilat mund të shëndrohen në rikapitulum të vlerave tradicionale dhe ringjalljen e Hamameve.



SHTËPIA E SURI VELIUT

Kjo shtëpi e mrekullueshme në qendër të qytetit do t'ju shtyjë të ëndëroni për të dhe kohën në të cilën ka funksionuar - shekulli XIX. Shtëpia e Suri Veliut meriton vëmendje të posaçme, si nga koncepti arkitektonik por edhe prej enterierit të pasur. Shtëpia paraqet llojin themelor të shtëpisë simetrike dibrane me përdhësë dhe kat, me çardak të mbyllur tradicional. Edhe pse prej jashtë e braktisur, mbrendësia e shtëpisë zbulon një histori me dekorimin e pasur të theksuar, me tavane të gdhendura, dyer dhe dritare.

OBJEKTET RELIGJIOZE

Xhamia e Inqarit, në Dibër, është njëra prej xhamive më të vjetra të ndërtuara në Maqedoni (me e vjetra prej 9 xhamive në Dibër). E ndërtuar në shekullin e XV (në vitin 1468) me urdhër të Sulltan Mehmetit të II.

Xhamia Bajram Beg, është ndërtuar në shekullin XIX.

Kisha e Shën Mërisë është kishë e famullisë Dibrano-Rekase. Gjendet në lagjen Varosh në pjesën e epërme të qytetit. Kisha është ndërtuar në mesin e shekullit të XIX, rreth vitit 1840 në themele më të vjetra të shekullit të XI. Kisha është një arkitekturë tre-nef bazilikë me afreske, dhe ka një ikonostas veçanërisht të bukur të shekullit të XIX. Kjo kishë ishte dikur selia e Dioqezës, e cila përfshinte zonën ngjitur me qytetin shqiptar Peshkopia.

Manastiri Bigorski, Kisha Shën Jovan Preteça. E ndërtuar në shpatet e malit Bistra e rretuar me pyll të dendur, dhe nën të në afërsi rrjedhin ujrë dhe kthjellta të lumit Radika. Prej manastirit shfaqet një pamje e mrekullueshme kah mali i Korabit me majat e saj Korabi i Vogël dhe i Madh, si dhe kah fshatrat piktoreske Radostushë, Velebërdë, Bitushë dhe Trebisht. Në afërsinë e tij janë fshatrat e rekës Gajre, Osoj, Tresonçe, Galiçnik, Rosokë dhe Lazaropole. Vende prej kah kanë dalë plejada e ndërtuesve, zograf-ikonograf, dhe drugdhendës të cilët gjatë gjithë shekullit XIX ndërtuan, skalitën, stolisën me drugdhendje në ikona numër të madh të kishave dhe manastirëve në hapsirat e gjithë Gadishullit Ballkanik. Manastiri i Bigorit ka qenë një kandil dhe shtyllë e ndriçimit shpirtëror i veprimtarisë arsimore, dhe qendër letrare e aktivitetit përshkruar. Në të janë shkolluar numër i madh i klerikëve, murgjive dhe mësuesve të cilët e kanë përhapur arsimin në të gjitha rrethet e Maqedonisë. Prej këtu kanë dalë edhe emrat e mëdhenj si arhimandriti Partenije Zografski, arhimanditi Arsenije prej Galiçniku-igumeni i manastirit, Gjorgji Puleski dhe shumë të tjerë. Kisha e Manastirit ishte e ndërtuar në themelet e një kishë më të vjetër. Manastiri është ndër më të bukurit në Maqedoni dhe më gjërë. Lokaliteti ku është ndërtuar është përplot me burime mjekuese dhe ujë - në dimër të ngrohtë, në verë të ftohtë, që në një mënyrë quhen si të bekuara.



Në foto: Hamami i Dibrës, Ujëvara e Dufit dhe Ura e Kaprollit. Foto: © G. Kërku

Themelues i Manastirit ka qenë monahu Jovan nga Dibra në vitin 1020, i cili në atë kohë ka qenë kryepeshkop i Ohrit. Manastirin ja ka përkushtuar Shën Jovan Pagëzuesit, për shkak të gurit prej të cilit është ndërtuar dhe lokalitetit të bigurit ku është ndërtuar ky objekt, Manastiri e ka marrë emrin Shën Jovan Bigorski, dhe me këtë emër është i mirënjohur në botë. Shkaku i ndërtimit të këtij manastiri posaçërisht në këtë vend ka qenë ikona e Shën Jovan Pagëzuesit, e cila është gjetur duke u luhatur në ajër mbi burimet. Kjo ikonë është çudibërëse. Pavarësisht se ikonografia e manastirit është e bukur dhe unike bërë me dru të gdhendur, është një nga thesaret më të mëdha të manastirit dhe përfaqëson një kryevepër të llojit të vet, në të cilën janë gdhendur pjesë të biblës, dhe janë të punuara në periudhën në mes viteve 1829 dhe 1835 prej mjeshtërve Marko dhe Petar Filiposki nga fshati Gajre.

Manastiri Shën Gjergji Fitimtari. Kisha Shën Gjergji Fitimtari në fshatin Rajçicë, gjendet në dy kilometra prej qytetit të Dibrës - dikur seli e Manastirit të Bigorskit, sot është manastir i urdhërit të murgeshave. Tek manastiri, i qëndron kohës kisha Shën Gjergji Fitimtari e ndërtuar në



Dasma e Galiçnikut

vitin 1835 dhe e bekuar në vitin 1836 e cila ka qenë seli e peshkopatës së dikurshme të Manastirit të Bigorskit. Përveç kishës në oborr ka pasur rënoja të objekteve ekonomike të përdorura për strehim të barit, dhe në kohën më të re, me siguri në kohën kur është ngritur kisha, është ndërtuar një çezmë me ujë të pijshëm mali.

DASMA E GALIÇNIKUT

Dasma e Galiçnikut ose Dasma liçanase e Petrovdenit mbahet çdo vit në Petrovden - 12 korrik. E pasur me shume origjinalitete, rituale dasme origjinale, unike dhe të papërsëritshme. Në ditët e dasmës, dëgjojnë zurla dhe jehojnë lodrat "prej në Galiçnik deri në Rekë" me gjithë jehonën nëntoksore e mbitokësore kah shpatet e Bistrës dhe qiellit. Ata janë shoqëruar të gurbetqarëve të kësaj ane të Maqedonisë dhe lajmërojnë Dasmën e Galiçnikut e cila është me më së shumti krushq. Dasma Galiçanase me ekzistencën e saj ka kontribuar që të ushqejë adetet dhe ritualet unike, të banorëve të kësaj ane, të ruhen vallet këngët burimore dhe veshja tradicionale famoze e përpunuar me precizitet filigran të rrobaqepësve. Çdo vit komisioni i posaçëm zgjedh dy të rinj të cilët do të kurorëzohen në dasmë e Galiçnikut. Njëri prej parakushtve është që të paktën njëri prej të rinjve të ketë prejardhje prej familjeje galiçanase.

VENDE HISTORIKE

Banjishti: Abranoci, varreza mesjetare; **Krasta,** kishë dhe varreza mesjetare

Kosovrasti i epërm: NaCrkov, varreza mesjetare; **Kalaja,** fortifikim i kohës së vonë antike

Dibër: Udova e epërme, lagje prej kohës së hekurit dhe mesjetës (Sot lokaliteti është i përmbetur prej ujrave të hidrosistemit Shpilje); **Shtëpia e Kapllan Arifit** zbulim i vetmuar prej kohës romake. **Shtëpia e Muhamed Karpuzit,** depo e monetave mesjetare; **Stojanica,** kishë mesjetare dhe vareza. **Çezma e thatë - Gipsara e re,** vareza mesjetare. në fabrikën e vjetër të qilimave ekziston kishë dhe vareza mesjetare.

Kosovrast i poshtëm. Elica, kishë dhe varreza mesjetare. **Zagradishta - naklak,** fortesë mesjetare. **Rruga e vjetër,** rrugë mesjetare.

Elevca. Bezhan, lagje mesjetare. **Rajki Evler,** lagje mesjetare.

Krifca. Alakati, varreza mesjetare. **Ogragja,** varreza nga koha romake dhe kishë mesjetare. **Opre,** varreza mesjetare.

Mogorçë. Shënmëria, kishë mesjetare; **Shkëmbi i Vranës,** fortifikim prej antikitetit të vonshëm. **Koshare,** varreza romake. **Nikolica,**

lagje mesjetare dhe varrezë

Osoj. kryqi - Shën Arangjel, kishë dhe varrezë mesjetare.

Otishani. Groboj, varrezë mesjetare.

Rajçica. Rabroeci i poshtëm, kishë dhe varrezë mesjetare.

Sollokiç. Mersuid, varrezë mesjetare.

Kisha e Mojsiut, kishë dhe varrezë mesjetare.

Muzlagëjca, lagje nga koha e neolitit. **Kisha e vjetër,** Varrezë nga antika e vonshme.

Taranesh, lagje dhe varrezë nga koha romake dhe antika e vonshme.

Shullan, varrezë mesjetare.

Spas. Troja, varrezë nga periudha e vonshme antike.

Bomovë. Varrezat, varrezë mesjetare, këtu gjendet edhe **Varri i Mirë,** (banorët besojnë se është çudibërës, shëron sëmundje, sjell fat dhe sukses)

Banjisht. Shpella e Pëllumbave, shpellë që gjendet mbi fshat, emrin e ka marr prej pëllumbave, të cilët strehohen në të. Aty janë strehuar luftetarët, me i njohuri Haxhi Lleshi në luftën e dyte botërore.

Banjat e Ali Agës, vend i ngrohje, ku nuk qendron bora, zogjite dimrit mblidhen tek ky vend. Thuhet se ndëgjohej gurgullima e ujit nëntokë.

Oxhaku i vullkanit, ekzistojnë tre vrime nëpër të cilat mer frymë vullkani, prej tyre del avull, një legjendë thotë se një bariut i ka ra fyelli mbrenda, e ky fyell ka dalë tek lixhat në Peshkopia.

Hame. Raveni, varrezë mesjetare. **Kisha,** varrezë mesjetare.

Xhepsh. Izvor, Varrezë nga koha romake, **Manatirec - Shën Arhangel,** kishë mesjetare.

Paraspuri, lagje nga koha romake.

Ura e kaprollit është ndërtuar prej kohës së perandorisë Osmane. Me të janë lidhur shumë legjenda e mite, prej të cilave më interesante është ajo kur një aga turk ka dashur të gjuaj një kaproll, i cili tek popullata e atëhershme njiheshte për shkathësinë, zgjuarsinë dhe fuqinë, dhe vazhdimisht u ka ikur gjahtarëve. Gjatë një ndjekjeje kaprolli ishte plagosur dhe i shtyrë në një situatë pa rrugëdalje, pra në vendin ku është ndërtuar ura më vonë. Në bregun e lumit të Gajres ai e ka bërë të pamundurën dhe ka arritur ta kapërcejë lumin edhe pse ka qenë i lodhur, dhe me plagë të thellë, e pastaj ka ngordhur. I mahnitur prej guximit të kaprollit dhe këmbënguljes së kaprollit që të luftojë për lirinë e vet deri në fund, beu urdhëroi që për nder të tij të ndërtojë urën, e cila në të ardhmen do të simbolizojë guximin, nderin, forcën dhe luftën që duhet të vazhdohet deri në frymën e fundit. Interesante është që ky monument i kulturës, është se ai është ndërtuar në vendin ku ka kaluar Via Ignatia

Guida malore, ja vendet që mund t'i vizitoni

Guida më e re në qytet, Grehans Uka, certifikuar nga GTZ dhe Shoqata Alpine Gjermane, tregon disa nga destinacionet e turizmit malor gjatë kësaj vere, problemet që shfaqen në terren dhe e ardhmja e këtij sektori të rëndësishëm për ekonominë lokale.

Turizmi malor në Dibër është në hapat e parë dhe përveç investimeve në infrastrukturë dhe shërbime, ka nevojë edhe për guida të specializuara. Prej vitesh disa agjenci ofrojnë këto shërbime dhe agjentë të rinj janë futur në treg. Njëri prej tyre, Grehans Uka, 24 vjeç, është njëri nga guidat më të reja në turizmit malor në Dibër. Ai sapo është certifikuar nga GIZ (Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar) si guidë malore dhe është i certifikuar edhe nga Shoqata Alpine Gjermane - DAV dhe njihet si guidë e certifikuar edhe në vendet e BE-së.

"Trajnimi që kam zhvilluar është një kurs për turizmin malor dhe njihet si kursi i Guidave Malore, i cili u zhvillua me mbështetjen e Ambasadës Gjermane dhe Organizatës Gjermane GIZ. Gjithashtu, ky trajnim u mbështet edhe nga Ministria për Zhvillim Ekonomik dhe Shoqata Alpine Gjermane-DAV. Me anë të këtij trajnimi, që ishte i treti i këtij lloji, u certifikuan 27 persona si Guida Malore që operojnë në të gjithë Shqipërinë", - thotë Grehans Uka.

"E veçanta e këtij trajnimi, tregon ai, ishte edhe veprimtaria në terren për të aftësuar secilin nga guidat që të ofrojnë siguri, cilësi shërbimi dhe larmshmëri të terrenit. Pra, secili nga personat e trajnuar të bëjë të mundur që çdo turist të mbetet i kënaqur dhe i frymëzuar nga turet. E gjitha kjo bëhet me qëllim që sektori i turizmit të ndikojë pozitivisht në ekonominë e çdo familje dhe personi që zgjedhin të merret me këtë sektor".

"Ne kemi edhe kartën e anëtarësisë së Shoqatës Alpine Gjermane - DAV, e cila zyrtarisht na përfshin në rrjetin e saj ndërkombëtar të guidave malore në të gjitha vendet ku operon".

Gjatë periudhës së trajnimit ata janë fokusuar në të gjitha detajet që janë të rëndësishme për çdo guidë malore. Duke filluar nga njohja me grupin dhe objektivat përgjatë turit, itinerari i lëvizjes dhe koha që duhet për ta përshkuar e deri tek elementet më të detajuara si ndihma e shpejtë, të cilat gërshtohen me anën teorike dhe praktike. Pra, në thelb të këtij trajnimi është synimi që turistët të ndihen të sigurt dhe të mbeten të kënaqur nga ajo që guidat e specializuara ofrojnë dhe qëllimi final është që turistët të frymëzohen dhe të mendojnë seriozisht rikthimin në këto guida, por edhe të përcjellin në vendet nga ato vijnë përshtypjet më të mira".

Por si paraqiten guidat turistike në Dibër në sytë e një të riu që sapo ka filluar në këtë fushë? Për këtë, ne zhvilluam një bisedë të shkurtër:

- Pas certifikimit si guidë malore, me se po merreni tani dhe a e mendoni se trajnimi juaj ka qenë i vlefshëm?

- Trajnimi im ka qenë shumë i vlefshëm për mua. Kam mësuar shumë gjëra në pak kohë dhe njëkohësisht më ka krijuar hapësira të reja se si mundet në të ardhmen të menjohet për investime në këtë sektor.



Një falënderim për anëtarët e një grupi të mrekullueshëm, të cilët na morën në Liqenin e Gramës. Një eksperiencë e mrekullueshme kampingu në Malin e Korabit, ku prapa supeve tuaja shkëlqen perëndimi i diellit. Jam me të vërtetë i kënaqur që kam ndarë këtë udhëtim me Ju dhe me një "bandë të tërë mushkonjash". Foto dhe teksti: © Alter Cuca Photography

Aktualisht unë jam punësuar në rolin e guiderit turistik pranë "Outdoor Albania Association" dhe njëkohësisht pjesë e stafit të "Peshkopia Backpacker Hostel" - shtëpi pritëse për turistët, që gjithashtu është pjesë përbërëse e kompanisë së mësipërme. Pra, përveç shoqërimit të grupeve turistike në terren, më duhet të organizoj edhe udhëtimin, strehimin dhe gjithçka tjetër të nevojshme për turistë përgjatë periudhës që ata vendosin të qëndrojnë në Dibër.

- Çfarë turizmi ofron Dibra në këtë sezon?

- Këtë sezon turistët që kanë vizituar Dibër kanë shprehur interesin e tyre për shëtitjet në vargmalin e Korabit (hiking), shëtitjen me varka në lumin e Drinit të Zi (rafting), ngjitjet alpine, sidomos në majën e Korabit (climbing), peshkimin, çiklizëm e

motoçiklizëm dhe vizitat në parkun kombëtar të Lurës. Pra, aktualisht sezoni turistik në Dibër ofron këto lloje të turizmit që bëjnë një ndërthurje të terrenit me elemente historikë, socialë dhe elemente kulturorë që ofron Dibra. Gjithashtu, është Panairi i të Vjelave me prodhime bujqësore dhe blegtorale nga Dibra, që njihet si Agroturizëm.

- Nga janë zakonisht turistët?

- Turistët që vizitojnë më shumë Dibër vijnë nga Holanda, Gjermania dhe Franca, të cilët në pjesën më të madhe vijnë nga Kosova - Kukësi në drejtim të Tiranës; dhe së dyti nga Maqedonia (Ohri - Dibra e Madhe) - Dibra në drejtim të Kukësit e pastaj në Theth ose Kosovë.

- Ata që ke shoqëruar, çfarë u pëlqen nga Dibra?

- Turistët që kam shoqëruar kanë pasur pothuajse të njëjtat zgjedhje në itinerare apo në preferencat e tyre. Një ndër zonat më të vizituara është kompleksi i Ilixhave, duke vizuar drejt fshatrave Bellovë, Rabdisht, Cerjan dhe Zagrad e në fund në qytezën historike të Bellovës. Në këtë rast duhet të përmendim që kemi përzjerje të elementeve historikë, arkitekturorë me turizmin shëtitës.

Së dyti, është shprehur interes për itineraret Peshkopi - Bjeshka Cerjanit - Mali i Gramës drejt Liqenit të Gramës; Peshkopi - Radomirë drejt Majës së Korabit ose me një devijim drejt liqenit të Gramës. Këto itinerare janë bërë më shumë nga të rinjtë, sidomos gjermanët dhe holandezët, që janë të pasionuar për lëvizjet në terrene të tilla.

Gjithsesi, ka pasur interes dhe rezervime për rafting në lumin e Drinit të Zi, që është një variant i ri i turizmit në Dibër, por me perspektivë, sepse sjell grupe të mëdha që janë të interesuara për këtë të fundit. Shembull më tipik për këtë janë grupe nga ambasada gjermane dhe kompania Coca-Cola.

Por, ka akoma mundësi të reja për zhvillimin e turizmit malor edhe në pjesë të tjera të Dibrës që presin të evidentohen si pjesë e një plani zhvillimi.

- Si mendon ti, çfarë është me interes për turizmin në Dibër?

- Sektori i turizmit në Dibër ka mundësi të mëdha zhvillimi, sepse mund të shtrihet gjatë gjithë vitit, duke shtuar edhe variante të tjera të tij siç janë: hipizmi, skitë në dimër.

Por ajo çfarë duhet pasur parasysh është se në çdo pjesë të Dibrës ku shkon ka një gërshtetim të historisë, kulturës dhe natyrës. E tillë është Qyteza e vjetër e Bellovës, e ndodhur në majën e malit të Bellovës, e cila na kujton historinë nëpërmjet elementeve të arkeologjisë. Është në një pozitë gjeografike të tillë, ku natyra e patrazuar nga njeriu na jep një peizazh mahnitës. Për sa i përket kulturës, vlen të përmendim kulinarinë - ku janë ruajtur gatimet tradicionale në fshatrat përreth, arti i ndërtimit të shtëpive dhe rugicave. E njëjta gjë ndodh në të gjithë rajonin e Dibrës, ku mjaft thjesht i gjen të ndërthurura natyrën me historinë dhe kulturën.

Tjetër element që e bën turizmin interesant është edhe mikpritja. Ky është një element tjetër mjaft i rëndësishëm, që bën të mundur që turistët të ndihen mirë dhe të ndjejnë akoma më shumë feedback-un nga turizmi në Dibër.

- Çfarë mendon se nuk shkon mirë me turizmin?

- Problemi për zhvillimin e turizmit në Dibër lidhet me mungesën e një plani zhvil-

GUIDAT TURISTIKE AKTUALE NË DIBËR:

- Peshkopi – Bellova – Rabdisht - Bjeshka e Rabdishtit - Bjeshka e Cerjanit. Dhe mund të vazhdohet drejt Gramës ose kthimi në Cerjan dhe drejt Peshkopisë.
- Peshkopi – Melan – Illicë - Bjeshka e Illicës - Mali Velivarit.
- Peshkopi – Radomirë - Fusha e Korabit - Maja e Korabit.
- Peshkopi – Arras – Lurë.
- Peshkopi - Maqellarë – Pocest - Ujvara e Pocestit - Bjeshka e Pocestit.
- Peshkopi - Grezhdan (Kalaja e Grazhdanit).
- Peshkopi – Bugjunec - Liqeni i Bugjunecit.
- Peshkopi – Arras – Sinë (Muzeu Historik i Kastriotëve).
- Peshkopi – Maqellarë - Kërcisht (Kishat e Kërcishtit).



- Një ndër zonat më të vizituara është kompleksi i Ilixhave, duke vijuar drejt fshatrave Bellovë, Rabdisht, Cerjan dhe Zagrad e në fund në qytezën historike të Bellovës.
- Interes është shprehur edhe për itineraret Peshkopi - Bjeshka Cerjanit - Mali i Gramës drejt Liqenit të Gramës; Peshkopi - Radomirë drejt Majës së Korabit ose me një devijim drejt liqenit të Gramës.
- Interes dhe rezervime për rafting në lumin e Drinit të Zi, që është një variant i ri i turizmit në Dibër, por me perspektivë, sepse sjell grupe të mëdha që janë të interesuara për këtë të fundit.

limor të këtij sektori nga qeveria lokale, pra, Bashkia e Dibrës, si dhe qeveria qendrore në një kontekst më të gjerë të rajonit verilindor. Mungesa e këtij plani ka sjellë mungesën e investimeve dhe orientimit të të rinjve në drejtim të këtij tregu pune. Mungesa e këtij plani, ka shkaktuar edhe mungesën e trajnimeve të të rinjve në fushën e turizmit, duke çuar në rënie interesin për këtë sektor.

Së dyti, problem tjetër për turizmin është mungesa e shtigjeve dhe hartave për vendet, hotelet dhe resortet që mund të vizitohen nga turistët. Gjithashtu, këtu përfshihet edhe mungesa e informacionit turistik nga Bashkia e Dibrës, me mungesën e një Zyre Informacioni Turistik (më saktë e mbyllur). Në këtë rast kjo ka krijuar konfuzion tek turistët për të vizituar Dibrën; ndërsa për ato turistë që e kanë vizituar Dibrën, mungesa e një infrastrukture të tillë është një problem gjetja e informacionit që ato të arrijnë në një feedback pozitiv.

Mungesa e infrastrukturës rrugore, lëvizja e paplanifikuar e banorëve (emigrimi dhe migrimi), mungesa e një shërbimi cilësor është një problem tjetër që ndikon në cilësinë e turizmit. Kjo do të thotë që mungesa e këtyre faktorëve ndikon negativisht tek tërheqja e turistëve për të vizituar Dibrën.

- Në të ardhmen, në cilin drejtim mendon se turizmi do të ketë rritje në Dibër?

- Mendoj që sektori i turizmit në të ardhmen do të jetë një ndër sektorët më zhvilluar në vend në Dibër, por edhe në nivel kombëtar. Kjo do të thotë është një sektor me perspektivë.

Besoje se turizmi në Dibër do të ketë një shtirje në shëtitjet malore (hiking), në shëtitjet me varkë (rafting) dhe sportin e skive. Këto do të jenë 3 fushat që do ta mbajnë turizmin si sektor që ndikon në zhvillimet ekonomike për familjet dhe rajonin. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh që edhe agroturizmi është një fushë tjetër që ndikon në zhvillimin e turizmit.

Bisedoi: **BUJAR KAROSHI**



Pesë kuriozitete rreth Kalasë së Dodës

Nga **METUSH SKEJA**

1 Në Kala të Dodës ndodhet mali më i lartë në Shqipëri, Korabi. Ai është "Himalaja" shqiptare. Ky fakt është i njohur edhe nga nxënësit e shkollave. E panjohur është fakti se është unik për bukuritë e tij. Eqrem Bej Vlora e ka vizituar në verë të vitit 1912 dhe është shprehur: "Korabi për bukuritë e veta krahasohet vetëm me Tirolin". Në Shqipëri nuk ka si Korabi. Kjo mund të jetë një arsye se shumë njerëz për të menduarit dëshirues kanë emrin e këtij mali të lartë e të bukur. Ky mal është mjaft interesant nga ana gjeologjike e shtresat tektonike. Ka formacione gëlqerore e serpentinore. Në Panair takohen dy formacione të ndryshme gjeologjike, sikur ke kapur me kasë dy letra. I tërë relieve është i mbuluar me bimë drunore e kullota alpine pa shkëputje. Ka shumë bimë të rralla, endemike e kuruese. Bimët kanë lule me ngjyra të ndezura. Çdo vit botanistët zbulojnë bimë të reja. Ka kapacitet për të mbajtur afro një milion krerë bagëti të imëta për kullotë në stinën e verës.

I tërë Korabi është për turizëm, por veçanërisht pylli më mëshketna në Ploshtan, Rrafshi i Sorokolit, Liqeni i Zi mbi Tejtës me peshqit e epokës së akullnajave, Fusha e Korabit, Panairi me barin e veçantë janë margaritarë. Ujëvarat, liqenët karstike, shpella e Ago Imerit janë një tjetër atraksion turistik. Ka peizazhe interesante që i gjen veten në Korab e askund tjetër. Kepi i Stojgjit të ngjall frikë dhe të sjell në kujtesë Grykën e Rugovës ose shkëmbinjtë ku është gozhduar Prometeu. Por, nëse në Himalaje shkojnë njerëz nga gjithë bota, në "Himalajet" shqiptare numri i turistëve është i kufizuar për shkak se nuk ka rrugë makine deri në Rrafshë të Korabit. Si mund të lihet e braktisur kjo perlë e fjetur vetëm për dhjetë km rrugë! Kjo është një thirrje për Bashkinë Dibër, për Ministrinë e Turizmit e Transporteve, për deputetët e Qarkut Dibër. Në majën e lartë të Korabit ke ndjesinë sa shumë gjëra ndodhen poshtë teje

nga ku duken si në pëllëmbë të dorës malet e Sharrit, Shtaravica, Mavrova e liqeni i saj i mbushur me ndërtesa të bukura turistike.

2 Në Kala të Dodës është tabani i këngës së bukur të Fushës Korabit. Kjo këngë ka tre mijë vargje. Sa për krahasim "Baba Tomorri" ka një mijë e dyqind vargje. Kënga e Fushës Korabit është një poemë. Fjalën "poemë" disa nuk e pranojnë, se nuk ka subjekt. Studiues të tjerë pohojnë se ka subjekt. Diskutimet, natyrshëm, do të vazhdojnë. Por, pa diskutim, ajo këndohet në gjithë trevat shqiptare dhe të shqiptarët e diasporës. Vazhdon të habis kompozitorë e këngëtarë, është visar në visaret e kombit tonë.

"Këngët e vjetra janë visari ma i çmushmi i gjuhës, shprehja ma e gjallë e shum ndiesive bujare e perfytyri tipik i fizionomis së kombit t'onë. Këngët janë monument i gjallë fisnikrije shpirtnore." (Visaret e kombit, ribotim, Shkodër 2007, f. 9) Për herë të parë është mbledhur dhe botuar në "Visatet e Kombit" në vitet 30-të të shekullit kaluar nga prifti françeskan i Shkodrës.

3 Në kohën e perandorisë osmane Kalaja ka qenë zona më e pasur. Ajo ka pasur një milion krerë bagëti të imëta. Këtë na e tregojnë dokumentat osmane. Ka jetuar në luks. Më 1863, konsulli austro-hungarez Han e ka vizituar Kalanë. Ai është surprizuar nga pasuria e luksi i jetesës. Ai ka shkruar se është i vetmi vend në Shqipëri ku ka fjetur me çarçafë të bardhë e të pastër. Lufta e Parë Ballkanike ua shkatërroi gjithë pasurinë. Ushtritë pushtuese ballkanike ua morën delet e u dogjën shtëpitë. Studiuesi i nderuar Shefqet Hoxha ka përgatitur e botuar studimet e Qamil Hoxhës, ku jepën me hollësi numri deleve të çdo fshati e përoni që ua ka marrë ushtria greke, bullgare e serbe në Kala të Dodës. Për këtë e të tjera ka gjithë respektin e mirënjohjen tonë.

4 Kalaja ka nxjerrë një ndër personalitet më të mëdha të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Fjala është për Dervish Caren. Ai ka lindur në Ceren. (Fjala Ceren në botimet e hershme dhe në të folurën e prindërve tanë shqiptohet me "a" dhe jo me "e".) Prindërit e Dervish Carës në vitin 1795 kalojnë nga Cereni në zonën e Pollogut. Lufta e Dervish Carës në vitet 1843-1844 kundër ushtrisë pushtuese osmane ka përfshirë gjithë trevat shqiptare që nga Çamëria, Vlora, Manastiri, Shkupi e Kosova. Ka qenë luftë kundër reformave të tanzimatit. Ndoshta është e vetmja kryengritje me përfshirje të njëkohshme mbarëshqiptare. "Në vitet 1843-1844 Kosova dhe trevat lindore shqiptare u bënë vatër e njëjës prej kryengritjeve më të fuqishme kundërosmane të gjysmës së parë të shek.19-të, e cila, sipas emrit të udhëheqësit të saj është quajtur "Kryengritje e Dervish Carës". Kryengritësit hyjnë në konflikt të armatosur me ushtrinë osmane. Në shkurt 10 000 kryengritës të armatosur hyjnë në Shkup, e çliruan atë. Porta e lartë përqendroi në Manastir 32 000 ushtarë të komanduar nga Omer Pasha." (Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i historisë, Historia e popullit shqiptar, volume 2. Tiranë, 2002, f.92-93)

5 Në perandorinë osmane Kalaja ka qenë njësi administrative "kaza". Ka qenë njësi e qeverisjes e barabartë me Lumën e Dibrën. E përkthyer në shqip fjala "kaza" do të thotë "rreth". Quhej kazaja e Radomirës. (Historia e popullit shqiptar, vol.2, Tiranë, 2002, f.42). Krahina e Lumës ka pasur shtatë bajraqe, nga këto katër kanë qenë të Kalasë. Vetëm tre bajraqe ka pasur pjesa tjetër e Lumës. Bajraku i Radomirës me prijës Shavellin e më pas Xhilagen, bajraku i Qafës me bajraktar Kolgjinin, Flisin, Kolgjinin e Gjinin, bajraku i Kalisit me prijës Imerin, bajraku i Çajës me udhëheqës Gracin.

Greahans' Tour Guide
GREHANS UKA
+ 355 69 32 14 210
epokagreahans@gmail.com

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në goftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të shkruajnë email në adresën <rrugaearberit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

Bëj pajtimin tënd me **PayPal**
përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

31 korrik - 5 gusht, zhvillohet "Takimet e Rekës së Epërme"
Bisedë me anëtarin e kryesisë së shoqatës, Tafë Ameti

veprimtari

Ringjallja e Rekës së Epërme

Veprimtaritë kanë të bëjnë me prezantimin e veshjeve tradicionale të Rekës, të traditave dhe zakoneve, lojërave popullore, folklorit dhe ushqimeve tradicionale të kësaj ane, para vendasve dhe mysafirëve me prejardhje nga territoret e Rekës së Epërme dhe të tjerë.

"TAKIMET E REKËS SË EPËRME" janë një serë veprimtarishë kulturore, artistike dhe tradicionale që këtë vit regjistrojnë edicionin e tretë. Lidhur me këtë veprimtari, qëllimet, organizimin dhe çështje të tjera që lidhen me këto krahina, ne biseduam përmes emailit me z. Tafë Ameti, anëtar themelues i shoqatës për Kulturë "Reka e Epërme" dhe njëkohësisht edhe drejtues i sektorit të medias në shoqatë.

- Çfarë është festa "Takimet e Rekës së Epërme"?

- "Takimet e Rekës së Epërme" janë veprimtari vjetore që realizohen në javën e parë të gushtit, kur janë të pranishëm mërgimtarëve tanë që kthehen në vendlindje për pushimet verore. Takimi e këtij viti janë të tretat në radhë. Veprimtaritë kanë të bëjnë me prezantimin e veshjeve tradicionale të Rekës, të traditave dhe zakoneve, lojërave popullore, folklorit dhe ushqimeve tradicionale të kësaj ane, para vendasve dhe mysafirëve me prejardhje nga territoret e Rekës së Epërme dhe të tjerë.

- Kush e organizon atë dhe cili është qëllimi?

- Shoqata për kulturë "Reka e Epërme" me seli në Gostivar, e përkrahur financiarisht nga komunat shqiptare të Maqedonisë, Ministria e Kulturës, anëtarësia, biznesmenë dhe mërgimtarët tanë nga Italia, Gjermania dhe Zvicra, të përfshirë në dy degët tona në këto shtete.

Qëllimi është realizimi, mbrojtja dhe harmonizimi i interesave dhe besimeve të rekalinjve, si dhe për të kryer veprime për përmirësimin dhe promovimin e jetës argëtuese, kulturore dhe sportive të Rekës së Epërme.

- Çfarë veprimtarish do të mbahen atë ditë?

- Në kuadër të "Takimeve të Rekës së Epërme 2016", më datë 31 korrik 2016 do të mbahet Marshi Tradicional në vendet e bukura të Bistrës, me pikënisje dhe pikëarritje në fshatin Sencë, në kohëzgjatje prej 5 orësh. Para nisjes do të hapet pllaka përkujtimore nga Shoqata jonë, kushtuar atdhetarit të këtij fshati, Qemal Bajramit, ndërsa do të lexohet edhe një referat kushtuar të gjithë personalitetëve të kësaj krahine. Në fshat, grupi i artistëve të Gostivarit do të pikturojë natyrën dhe shtëpitë e vjetra, të cilat do të jenë dhuratë e shoqatës, ndërsa më datë 1 gusht 2016, në fshatin Rimnicë, do të mbahet manifestimi qendror i takimeve, i pasur me program të pasur kulturor-artistik, me pjesëmarrje të shoqërive kulturore artistike dhe grupeve folklorike.

Nuk do të mungojnë traditat e dasmave



TAFË AMETI është profesor i fizikës. Ai e ka nisur punën si mësues në gjimnazin e Gostivarit, ku edhe aktualisht punon me një përvojë 25 vjeçare në arsim dhe edukim të brezave të rinj. Ai drejton edhe Fondacionin Qendra informatike në Gostivar dhe është Kryetar i Sindikatës të Pavarur për Arsim, Shkencë dhe Kulturë i rajonit të Gostivarit. Zotëron aftësi menaxhuese në shumë projekte të sferave të ndryshme nga disa organizata joqeveritare vendase dhe të huaja. Ka marrë shumë certifikata dhe mirënjohje për punën e tij të palodhshme në arsimim, edukim dhe ngritje të vlerave kombëtare, për të cilën edhe është i njohur në shoqërinë e ngushtë të Gostivarit dhe rrethina. Është një ndër themeluesit dhe anëtar i Shoqatës për Kulturë "Reka e Epërme" ku drejton sektorin për median.

dhe lojërave tradicionale sportive të Rekës së Epërme, të përcjellura me curla dhe tupana të Dibrës së Madhe.

- Kjo veprimtari është e vetmja në vit apo keni edhe të tjera gjatë vitit?

Shoqata për Kulturë "Reka e Epërme", përveç "Takimeve të Rekës së Epërme", përkrah dhe organizon çdo veprimtari tjetër që kanë të bëjë me ringjalljen e vlerave të kësaj ane. Mund të përmendim organizimin e konferencave, simpoziumeve, seminarëve si dhe tubimeve të ndryshmeve shkencore, kulturore, argëtuese dhe sportive me tema të rajonit të Rekës së Epërme dhe më gjerë; rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik i rajonit të Rekës, nxitja e bashkëpunimit shkencor, ndërtimi dhe ndërfetar; mbledhja e materialeve të shkruara dhe dokumenteve, artefakteve, kostumeve, arkitekturën nga historia e rekasve; organizimi i kolonive

artistike, shkrimtarëve dhe manifestimeve të tjera të aktorëve të Rekës së Epërme dhe mbështetjen e tyre me mjete financiare për të theksuar identitetin kulturor të rajonit; organizimi i lojërave tradicionale sportive, marshimet malore, gjueti dhe peshkim dhe sporte të tjera ekstreme përshtatur për bukurinë e vet rejonit etj.

- Sa veta parashikoni që të marrin pjesë këtë vit?

- Për shkak të terrenit të largët nga qyteti i Dibrës dhe Gostivarit, shpërngulja e kaheshme e këtyre vendbanimeve, pa asfaltimit të rrugës dhe në varësi të kushteve klimatike, presim rreth 2500 - 3000 veta në manifestimin qendror, ndërsa pjesëmarrje në marshim do të jetë 100 deri në 150 veta.

- Si paraqitet gjendja e popullsisë sot në Rekë?

- Reka e Epërme është banuar me njerëzit shqipfolës myslimanë dhe krishterë. Për popullsinë shqipfolëse, një pjesë që mbeti krishterë ortodoks u asimiluan dhe identifikohen si maqedonas ndërsa ata që pranuan Islamin e konsiderojnë veten si shqiptarë. Për shkak të migrimit të të krishterëve ortodoksë në qendrat urbane disa dekada më parë, sot shumica e Rekalinjëve janë shqiptarë myslimanë, me një pakicë shqipfolës ortodokse, të cilët vetë-identifikuan si maqedonas. Vendbanimi më i madh mysliman shqiptarë sot në Rekën e Epërme është Verbjan me 625 banorë. Ndërsa vendbanimi kryesor ortodoksë sot është Verben me 142 banorë.

Për shkak të rrethanave të vështira e jetesës dhe nganjëherë trazirat sociopolitike, sidomos në shekullin 19, Reka e Epërme ka qenë historikisht një rajon me emigrime të vazhdueshme. Tradicionalisht, populli (Vijon në faqen 10)



reportazh

Nga **RRUZHDI BITRI**

Dëshirën për të vizituar Gramën kishte kohë që e shuaja në mendjen time. Ku dy bashkë moshatarët e mi: Fatmiri dhe Halimi më thanë se do të shkojmë për 2-3 ditë në Gramë. E prita me kënaqësinë më të madhe.

... Kishte 40 vjet që unë nuk e kisha shkelur Gramën. Kujtoja me nostalgji çdo ditë timen dhe bashkëmoshatarëve të mi që të gjithë pushimet e verës (që nga klasa e pestë deri sa mbaronim shkollën e mesme), t'i harxhonim për të siguruar drutë e zjarrit për dimër. Në grykën e Gramës mund të kalonin deri në fillim të viteve '90, mbi 300 djem e burra në ditë (nga Sohodolli, Bresti, Kastrioti, Bllaçja e Rrenxi) me kuaj e gomarë për të siguruar drutë e zjarrit për dimrin e ashpër të radhës.

... Por pas 40 vitesh nuk shkoja për dru zjarri, as për lëndë për shtëpinë, por për turizëm. Nuk do të shkoja nga gryka e Gramës për në mal, por sipër nga bjeshkët e Gramës, që nuk i kisha vizituar asnjëherë. Në bjeshkë ishte e ndaluar të ngjiteshe pa lejen e degës së brendshme.

Aty ngjiteshin vetëm barinjët, por pasi kishin kaluar "sitën" për në zonën kufitare.

... Në Bllaçe na priste Rexhepi, një bashkëfshatari ynë me një makinë fuoristradë për atë rrugë.

Lamë asfaltin në Kaush dhe u drejtuan drejt Sllatinës. Deri në dalje të këtij fshati rruga ishte e pranueshme, pastaj fillonte pjesa alpine e rrugës deri tek varri i Sejmenit. Dhe për çudi kasetofoni i makinës kishte zërin e këngëtares Lirie Rasha me këngën "Fusha e Korabit" dhe tamam në vargjet "Prapë na çeli Grama" ishim përballë Gramës.

Aty ishim përballë bukurive të vargmalit të Korabit dhe të bjeshkëve të Gramës dhe asaj të Preshit që ndodhet nën këmbët e Korabit.

PAK HISTORI

Sapo jemi ndaluar të Varri i Sejmenit. Që këtu fillon një element historik. Selman Çuni, një burrë i mençur nga Fusha, i plagosur në Rekë (në krye të punës së tij) vdes në rrugë dhe le amanet varrin, pikërisht aty ku fillon Grama.

Shtirja e bjeshkës së Gramës nga kjo pikë deri në pjesën më jugore të saj, që është Dersa në fund të malit të Bardhë, ka një gjatësi 7-8 km dhe një gjerësi 2-3 km. E gjithë bjeshka është aty tek 20 km2.

E veçanta e saj janë lartësitë maksimale në relieve, që shkojnë jo më shumë se 250 m, nga mbarimi i halorëve deri në fund të Gurit të Kuq.

Ndërsa për të dhënat gjeofizike të kësaj zone informacionet më të sakta i ka dhënë një nga bashkëfshatarët e mi, profesor Vesel Hoxha, i cili ka harxhuar një pjesë të madhe të studimeve dhe të jetës së tij profesionale në këto zona.

Gramë shëron. Nga vetë emri lidhet në latinisht me yndyrën, ujin dhe lulet. Nëse gramatikët morën emrin nga Grama, apo Grama nga gramatikët, kjo vlen për t'u diskutuar. Etimologjia e këtyre dy fjalëve është e ndryshme, por ato i bashkon Grama e bukur. I bashkojnë toponimet e shumta dhe gjurmët e lashtësisë.

Aty ku jetuan zonjat ilire dhe romake, aty ku jetuan edhe Kastriotët.

Gramën e kanë vizituar shumë biologë, mjekë dhe udhëtarë të mençur dhe janë shprehur për të: Aty ku sëmundjet e mushkërive nuk kanë nevojë për sanatorium, por vetëm për Gramën. Aty ku është lehtësuar dhimbja për sëmundje të pashërueshme, aty ku thuhet: "Bjeshka e Zonjave ka shëruar plagët e plumbave pa mjekim".

Aty ku është vendi i quajtur "Lakja e xhipçe" dhe zona e historive tragjike, e vetmja e



'Prapë na çeli Grama...'



Gjurmë vendbanimesh të hershme

portë hyrëse-dalëse. Aty ku u vranë shumë bashkëfshatarë tanët për të kaluar kufirin në periudhën e Komunizmit. Aty ku batalionet serbe u dyndën në luftëtarët në vitin 1913-1920. Aty ku legjendari Iljaz Prifti vetë i pesti mbajti të stokuar një batalion serb derisa u zhvendosën stanarët me gra, fëmijë e bagëti në drejtim të Drinit të Zi.

Një turist do të na thoshte "Po kaq i çmendur ka qenë ai regjim që ka bërë një rrugë me gjatë 2 km në fund të malit vetëm që të mos shkelë njeri. "Rrugë" që të jetë ndaluar ecja në të, vetëm këtu kam parë.



Lakja e xhipçe. Fotot ilustruese të këtij shkrimi janë të ©Rruzhdit Bitri

E pra ky ishte "brezi i butë", ku numëroheshin edhe gjurmët e kafshëve të egra kur kalonin. Tashmë kjo i takon të kaluarës së afërt, por që sot është dhe bëhet një atrakcion turistik.

Në këtë bjeshkë jeta ka vazhduar që para 2000 vjetëve. Ka shenja të vendbanimeve të hershme që askush nuk i mban mend të ketë patur stane.

Bjeshka e luleve, e barit, e burimeve ujore, aty ku vëzhgohen më bukur se kudo: Gjeomonumentet e Gramës si Lakja e xhipçe, Shllinasit, Guri i Kuq dhe Pasqyrat, aty ku "Brezi i butë" vija kufitare e ndaluar për t'u prekur në kohën e diktaturës.

NË STANET E BASHKËFSHATARËVE TË MI

Sapo kemi hyrë në bjeshkën e Gramës dhe përballë nesh në perëndim duken pothuajse të 15 fshatrat e krahinës së Çidhnës, krahinë kjo që e ka shtrirjen nga Runja në Korab. Pjesë e pronësisë së kësaj krahine janë dhe shumë pjesë të territorit të Gramës.

Poshtë liqenit të Gramës në krye të malit ndodhen stanet e bllaçjanëve, të cilët historikisht kanë veruar aty, përjashtuar periudhën 40-vjeçare të komunizmit.

Me makinë Rexhepi, shoferi dhe shoku unë, na zbrit deri tek stanet me sigurinë e tij në punën që bën si shofer i një guide

HUMOR POLITIK NË BJESHKË

Në mes të bjeshkës, takuam për herë të dytë njërin nga mikpritësit tanë, një djalë. Ishim ulur të pushonim e mezi mbusheshim me frymë.

- E more mësues, po të bën dëm oksigjeni i pastër.

- Po si more më bën dëm? - i them unë.

- Po mushkëritë e tua, këto 20 vjet janë bllokuar nga mazuti i padjegur i makinave të Tiranës por edhe nga pordhët e Sali Berishës e të Edi Ramës.

- Të parën e pranoj - i thashë, - të dytën ta diskutojmë.

- Tërhiqem, - më tha. Se këtë të dytën e kemi ngrënë edhe ne këtë në bjeshkë. Nuk thonë kot se "Pordha e madhe çan brekët e veta".

turistike.

Ndalemi tek stani i Emri Spatës. Pas mirëseardhjes dhe kafes së parë i shpjeguar se kemi vendosur të rrimë 3-4 ditë këtu, ngjitur me stanet tuaja.

Është e pamundur - na e preu shkurt. Ju jeni bashkëfshatarët e mi. Ju jeni shokët e vëllait tim, Rufatit, ndjesë pastë. Homazh për Rufat Spatën edhe nga Grama, ku kaloi 2 verat e fundit të jetës së tij.

Për dy netë fjetëm dhe hëngrëm në stanin e familjes Spata. Me kuzhinë me tapete, me dhomë fjetje për 4 miq me të gjitha që ka një stan i këtij niveli.

Nuk vonuan të na ftojë për kafe Xhevhiri, Agimi, Meta, Ramazani e shumë të tjerë. Por ne e kishim të pamundur të shkonim të 15 shtëpitë - stanet e fshatit tonë.

Të gjithë ishin me familjet e tyre, por jeta vazhdonte si në fshat.

Drekën e fundit do kalonim në stanin e Aranit Skepit. Një drekë që s'do të harrohet kollaj nga ne. U bëmë 10 burra në stan. Do të mbetet e paharrueshme për ne. E në biseda me të gjithë stanarët, veçanërisht me Emriun e Nitin ishte thirrja për të ndryshuar drejtimin e jetës së tyre nëpërmjet turizmit.

Ditën e dytë të qëndrimit në Gramë me udhërrëfyesin tonë 6-vjeçar e nisëm me udhëtimin nëpër bjeshkë. Ishte ora 9 e mëngjesit kur u nisëm. Kaluam liqenin artificial të Gramës në mes të bjeshkëve, pastaj liqenet e akullnajave që krijojnë lidhjen e magjishme në liqenin e madh. Kodrat e

(Vijon në faqen 10)



SHOQATA PËR KULTURË REKA E EPËRME - GOSTIVAR në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë u regjistrua më datë 16 qershor 2015 ndërsa Kuvendin themelor u mbajtë më datë 5 prill 2015. Kryetar u zgjodh Xhelil Rufati. Shumë shpejt kjo shoqatë formoj edhe dy degët e saja në Itali (Trento) dhe në Zvicër e Gjermani (Cyrih).

Qëllimi kryesor i shoqatës është ruajtja dhe promovimi i kulturës, adeteve, traditës dhe veshjes autoktone të Rekës së Epërme.

Për këtë periudhë të shkurtë kohore organizoj çdo vitë manifestimin "Takimet e Rekës së Epërme", me unionin e nxënësve shqiptarë mori pjesë në panairin e shkencës dhe të kulturës në Mitrovicë të Kosovës, duke prezentuar veshjen autoktone, lashtësinë e saj zakonet dhe traditat. Në bashkëpunim me SHAFM "Draudacum" nga Gostivar në kuadër të "Takimeve të Rekës së Epërme 2015" u organizuar ekspozita nacionale, promovimi i librit "Jeta e fshatarëve shqiptarë në grykën e Rekës së Epërme - Dibra e Madhe" të autorëve Franz Baron Nopcsa dhe Bajazid Doda, shqipëruar nga origjinali Nexhat Mehmedi; promovimin e librit "Veshja autoktone e meshkujve të Rekës së Epërme" të autorës Edibe Osmani, promovimi dhe financimi i video klipit "Pyete zemrën" dedikuar Rekës së Epërme nga këngëtari i mirënjohur Ilir Shaqiri etj. SHK "Reka e Epërme" edhe më tej do të organizoj konferenca, simpoziume, seminare dhe tubime të ndryshme shkencore, propagandistike dhe kulturo-artistike, rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik, formimi e shoqërisë kulturore dhe artistike, ekspozimin e librave, broshurave, gazetave, katolinave etj., organizimi i lojrave tradicionale sportive, marsheve malore, gjueti dhe peshkim, indentifikimi i familjeve dhe individëve, të cilët kanë nevojë për ndihma humanitare etj.

Ringjallja e Rekës së Epërme

(Vijon nga faqja 8)

sia është marrë kryesisht me blegtori dhe bujqësi, të cilat ruhen edhe nga popullsia e vogël në numër që jetojnë aktualisht në Rekë. Gjatë epokës osmane, meshkujt e rritur të Rekës së Epërme shkronin më kurbet. Shpesh ata gjetën punë si bërës të pastave apo si tregtarë të hallvës, salepit dhe bozës, edhe si shitës në Stamboll apo qytete të rajonit si Shkup dhe Edrene. Në Rumani dhe Bullgari, disa njerëz prej Reka e Epërme ishin të punësuar edhe në industrinë e ndërtimit të banesave, si muratorë ose ndërtuesit, dhe po kështu edhe në qytete të tjera si Shkodra dhe në krahina të tjera. Ndërsa flukset migratore të përhershme gjatë periudhës së vonë osmane ishin kryesisht për në fshatrat fqinje dhe rajonet ku sot këto popullata shpesh formojnë disa familje brenda një vendbanim mes popullsisë së tyre më të gjerë shqiptare. Në rajonin e Pollogut të Epërme, Rekalinjët u zhvendosen në fshatrat Koritë, Balindoll, Banjicë e Poshtme, Zdunjë etj. Në Pollogun e Poshtëm kryesisht në fshatrat Sallarevë dhe Gurgurnicë. Në fshatrat brenda në afërsi të qytetit të Shkupit si Cërnivor, Krushapek, Sveta Petka dhe Patishka Rekë, ndërsa në afërsi të Velesit në Jabollcisht i Epërm, Sogllë, Kukavec dhe Buzallakovë. Në disa fshatra, rekalinjët emigruan atje si krishterë, për shembull në Lukovica, dhe më pas ndryshuan fenë në Islam. Ndërsa në Patishka Reka, ata mbetën ortodoksë dhe shqipfolës deri në Luftën e Dytë Botërore, para se të zhvendosen në Shkup. Disa banorë rekalinj prej Vërbjani kanë migruar në dekadat e fundit në fshatin fqinje musliman maqedonas Zheranicë, me shërbimet komunale në Rekën e Poshtme dhe ata numërohen rreth 258 njerëz. Ndërsa të krishterët ortodoksë emigruan prej vitet 1950-të në kryeqytetin jugosllav, atëherë Beograd, qytete të tjera, si në Shkup dhe në qytetin e afërt të Gostivarit, ku ata formojnë popullsinë kryesore të lagjes Durtlllok. Për shkak të kryengritjes së vitit 2001 në Maqedoni veriore, fshati Tanushaj është prekur nga lufta dhe bëri që disa banorë të migrojnë më pas në vende

Për shkak të terrenit të largët nga qyteti i Dibrës dhe Gostivarit, shpërngulja e kahershme e këtyre vendbanimeve, pa asfaltimit të rrugës dhe në varësi të kushteve klimatike, presim rreth 2500 - 3000 veta në manifestimin qendror, ndërsa pjesëmarrje në marshim do të jetë 100 deri në 150 veta.

të tjera. Rekalinjët të rinj, kohët e fundit kanë emigruar edhe në vendet e Europës perëndimore, ndërsa disa banorë të moshuar kthehen në shtëpitë e tyre në Rekën e Epërme gjatë periudhës së verës.

- Sa mendoni se kjo do ta ndihmojë zhvillimin e turizmit në zonë?

- Në territorin e Rekës së Epërme ndodhen një numër i madh e shtigjeve, të cilat mund të shfrytëzohen për ecje dhe për çiklizëm malor. Ata janë me përdorshmëri, vështirësi, gjatësi dhe shkallë të ndryshme të përdorimit. Shumica e shtigjeve janë për turizmin malor, çlodhje dhe argëtim. Ato janë të standardizuara dhe të kategorizuara nga ana e Asociacionit të Maqedonisë, një udhëheqës profesional nëpër male, në bazë të kriterëve ndërkombëtare. Këto shtigje janë pjesë e trashëgimisë kulturore dhe civilizuese të Republikës së Maqedonisë. Për mirëmbajtjen e tyre dhe rregullimin e infrastrukturës kujdeset Parku Nacional i Mavrovës, me asistencë të udhërrëfyesve profesionist. Ujëvara e Proit të Thellë dhe Maja më e lart e Korabit janë tërheqës të veçantë për turistët në këtë zonë. Peizazhet e bukura të natyrës së bashku me rrjedhjen e ujit të pastër të lumit Radika, janë një magnet tërheqës për çdo turist vendas dhe të huaj. Peshkimi dhe zhvillimi i sporteve ekstreme i tërheqin turistët e shteteve të Europës perëndimore, me kamping në vende tërheqëse në bjeshkët e Korabit dhe të Bistrës.

Intervistoi përmes emailit:
BUJAR KAROSHI

Grama ju thërret të gjithëve: Vizitoheni atë! Çlodhuni, argëtohuni, kurohuni në këtë bjeshkë të mrekullueshme. Kush nuk ka vizituar Gramën, nuk ka shkelur perlën e bjeshkëve shqiptare.

'Prapë na çeli Grama...'

(Vijon nga faqja 9)

buta të bjeshkës të bëjnë të soditësh dhe të kënaqesh duke parë nga të gjitha anët. Pushimet i bënim të shpeshta, pranë burimeve të shumta të ujit. "Uji që vlon", nuk është burim i nxehtë, por i akullt, por gurgullon që bën burimi të krijojë ndjesinë e vlimit. Aty pihet uji vetëm me pipëza, sepse për shumë pak kohë po pive me buzë, ato të plasim në 2-3 ditë e para. Kjo është e Dedes, na thoshte Jasmini, kjo është e Isufit, ajo atje është e Sllatinës. Shumë i saktë në orientime.

Ne filmonim dhe fotografonim si amatorë. Nuk janë të rralla rastet kur amatorët realizojnë gjëra të bukura. Lulet e shumta, bari i butë na bënin që të mos e ndjenim lodhjen. Kishim dalë në pikën ku shikonim të plotë "Bjeshkën e Zonjave" kryebjeshkën e Gramës.



JASMINI, SHOQËRUESI YNË 6-VJEÇAR

Jasmin Spata u miqësua shumë shpejt me ne. E ëma na porositi që të kishim kujdes me të.

Në atë moshë kishte një inteligjencë të jashtëzakonshme. I rritur në bjeshkë e njihte atë në mënyrë të mahnitshme. Na shoqëroi kudo. Na tregonte, na krijonte rrëngje nga më të çuditshmet. Bëri 12 km rrugë nëpër bjeshkë me ne dhe nuk u ul njehëri.

Jasmini duhet të jetë e nesërmja turistike e Gramës.

ELEZ CIBAKU – LEGJENDA E GRAMËS

Ma do mendja se nuk ka dibran që nuk ka dëgjuar për baxhierin legjendë të Gramës, Elez Cibakun.

Pasi arritëm në stan nuk vonoi dhe vizitën e parë na e bëri Elezi.

Zakonisht nuk vij t'i vizitoj të gjithë njerëzit që vijnë tek Emriu, por për ju erdha. Ishte me ramazan dhe ne i lamë mënjane gotat e rakisë dhe filluam bisedën me të.

Jam 82 vjeç. E kam filluar punën në baxho që në vitin 1962, ndërsa nga Grama nuk jam larguar që nga viti 1965. Kam pak më shumë se 50 vjet që punoj në këtë baxho. Ky është profesioni im, kjo është jeta ime.



Dy kohërat i kam jetuar: Atëherë punoja për shtetin, sot punoj si të gjithë për veten dhe familjen time, për nipa e mbesa, që e kam shtëpinë plot.

Dhjetëra kuintal qumësht në ditë përpunon dhe e kthen në djathëra kaçkavall dhe të bardhë, në gjalpë dhe gjizë.

Të gjithë stanarët e sjellin qumështin në baxhon time. Për veten e tyre mbajnë sa për konsum ditor.

Ka dyqanin në Peshkopi ku shet prodhimet e tij të një cilësie shumë të lartë "Made in Grama".

Është i dashur me të gjithë. Energjitë dhe puna e tij nuk e tregojnë moshën 82-vjeçare. Por ka jetuar në Gramë e s'ka si të jetë ndryshe,

- Herë tjetër mos rri 3 ditë, por të paktën 2 javë - na thotë Elezi, sepse kështu i shërbeni trupit tuaj më mirë.

U ndamë me këshillën në mendjet tona të bllokuara nga smogu i metropolit.

GRAMA THËRRET

"Merr pare me fajde, e njera unë o, merr rrugën e e hajde, e njera unë o..."

Nuk është klithma e dhimbjes së nënës, që pret djalin e saj nga kurbeti, nuk është shpirti i trazuar i nuses për burrin e saj kurbetli, por është klithma e Gramës për njerëzit e saj.

Është thirrja për ju bashkëfshatarët e mi: Për Ilirin, për Araniti, për Arifin, për Ramazanin, për Halimin, Maliqin e shumë të tjerë: Filloni dhe ngrini stanet e para për turistë. Të thjeshtë si stanet tuaja krijoni mundësi që Jasmini 6-vjeçar të menaxhojë nesër resortet apo guidat turistike. I keni të gjitha mundësitë. Nesër do të jetë vonë për ju. Nuk jetohej gjatë me lavdinë e të kaluarës.

Gramë gërthet për shtetin, për qeveritë, për gojëkçurit dibranë të Parlamentit, që vetëm peneli i Bujar Kapexhiut dhe pena e Agron Tufës e ngrënë në art klithmën e Dibrës dhe dibranëve.

Gramë thërret biznesin të bashkëpunojë me bashkëfshatarët e mi për t'u dhënë jetë turistike bukurive të kësaj bjeshkë të mrekullueshme shqiptare.

Gramë ju thërret të gjithëve: Vizitoheni atë! Çlodhuni, argëtohuni, kurohuni në këtë bjeshkë të mrekullueshme. Kush nuk ka vizituar Gramën, nuk ka shkelur perlën e bjeshkëve shqiptare.



Rreth 10 hektarë tokë, nga të cilat, tetë hektarë janë të mbjellura me pemë, qershi, mollë dhe arrë, i japin hijeshi hyrjes së qytetit të Peshkopisë në çdo stinë.

Prodhimet e fermës së vëllezërve Kryemadhi në Ravna të Dibrës shumë shpejt do kenë vulën e tyre, duke siguruar konsumatorët vendas dhe të huaj, se po blejnë produkte bio, të shijshme dhe cilësore.



Ferma "Kryemadhi", një model i suksesshëm i frutikulturës

Nga **OSMAN XHILI**

Rrugës për Peshkopi, dy kilometra pa aritur në qytet, në anë të majtë të rrugës, në vendin e quajtur Ravna, ndodhen disa ndërtesa, shtëpi, stalla, magazina, të gjitha të rrethuara nga pemtore. Nëse është pranverë do të shohësh mrekullinë e luleve shumëgjyreshe, një muaj më vonë kuqëlimin e qershive të pjekura, kurse vjeshta të ofron të kuqen e starkingut apo jeshilen e gransmithit. I sheh të gjitha këto në stinë të ndryshme, dhe natyrshëm kërkon të njihesh më nga afër me këtë peizazh të këndshëm, me këto njerëz punëtorë, që kanë gatuar mrekulli të tilla me duart e tyre.

Ata janë tre vëllezërit Kryemadhi: Bilbili, Medini dhe Nderimi. Ndonëse i kanë bizneset e ndara, shumicën e punëve i bëjnë së bashku. Ferma e tyre është rreth 10 hektarë tokë, nga të cilat, të paktën, tetë hektarë janë të mbjellura me pemë, qershi, mollë, arrë. Një pjesë e qershive, të llojit "napolon", janë që nga koha e fermave, e më pas u shtuan me llojin "burlat". Kështu u shtuan katër hektarë mollë starking, hajdaret, gransmith, janagold dhe një hektar me arrën kokërrmadhe të Dibrës.

Të gjitha këto duken bukur nga rruga, për syrin e vizitorit, të turistit, por sa punë, sa lodhje dhe sa djersë pak e dinë. Sa netë të pagjuma me frikën se si do të jetë moti nesër? Sa frikë se mos vapa do të vazhdojë për shumë e shumë ditë? Se mos shiu do të shplajë spërkatjen e porsabërë? Se mos ngricat e prillit do të dëmtojnë lulet e pemëve? Se mos prodhimi i vjelë nuk do të gjejë treg për t'u shitur, duke shkatërruar fermerët, bashkë me shpresat e ëndërrat e tyre. Të gjitha këtyre frikërave e strese, po t'u shtosh edhe punën e rëndë fizike, bëhen një mal i madh.

Por, vëllezërit Kryemadhi, kanë ditur të notojnë në këtë det të trazuar, kanë ditur të operojnë, të menaxhojnë proceset e punës, për të arritur në një rezultat final të pëlqyeshëm. Ata e kanë të qartë se vaditja për pemën është primare. Por, edhe koncepti primitiv i vaditjes së lirë, apo me brazhdë uji, po evolon në një vaditje moderne me pika. Kjo gjë, jo vetëm e ruan pemën nga sëmundje që barten me ujin e kontaminuar, kursen kohën, energjitë, pse jo dhe paratë, duke ulur ndjeshëm koston e prodhimit. Deri tani, ata kanë arritur të aplikojnë këtë lloj vaditje në 1,5 ha me mollë dhe 1 ha me qershi. Një pus 40 metër i thellë dhe një

rezervuar uji me kapacitet 200 metër kub, përveç ujit që vjen nga fshati, plotësojnë në një farë mase nevojat për vaditje që ka ferma e vëllezërve Kryemadhi në Ravna të Peshkopisë. E megjithë këto punë e përpjekje, sërish nevojitet një pus i ri me 40 metër thellësi, pasi tre hektarë qershi janë të pavaditura deri më sot dhe hapin sytë nga qielli, nëse Zoti do ti kujtojë me ndonje shi, kur ky është i nevojshëm.

Teknologjia është përmirësuar ndjeshëm dhe në procesin e spërkatjes së pemëve, ndaj sëmundjeve e dëmtuesve. Pompa e shpinës ka kohë që është zëvendësuar nga pompa me kapacitet 450 litra. Një pompë e tillë e mbushur, bën mesatarisht një sipërfaqe prej pesë dynymë, ku dhe cilësia është shumë e lartë, me një shkallë pulverizimi të helmit, shumë të kënaqshme. Tre familjet, që tani janë shtuar dhe me çiftet e reja, jo vetëm që janë vetpunësuar në biznesin e prodhimit, por në krasitje, në vjelje të qershisë dhe të mollës, punësojnë tre deri në dhjetë veta të tjerë.

Vëllezërit e fermës "Ravna" janë të ndërgjegjshëm se shkenca dhe teknologjia ecin gjithmonë përpara dhe nuk dëshirojnë të mbeten shumë prapa tyre. Ata kanë një

bashkëpunim aktiv me të gjithë aktorët që mund të sjellin diçka të re në biznesin e tyre. Ka kohë që koordinojnë projektet me specialistët e Drejtorisë së Bujqësisë të rrethit apo me fondacione si ADAD me qendër në Tiranë dhe Agrinet me qendër në Korçë. Me to konsultohen për mënyrat e vaditjes, mënyrat e krasitjes, normat dhe llojet e plehrave, kohën optimale të kryerjes së shërbimeve, e plot elemente të tjerë, me qëllimin final për ta maksimalizuar prodhimin.

Medini, vëllai i mesëm, sikur ka një energji të lindur. Ka siguruar dhe një paisje që tregon se kur duhet vjelur molla, në bazë të sasisë së sheqerit që ka arritur fruti. Me "starkingun" duhet filluar, kur fruti ka rreth 11 përqind sheqer, duke përfunduar me "gransmithin" në një afat më të vonë. Si përsheptimi i vjeljes, apo vonimi i saj në kohë, japin efekte negative në ruajtjen dhe shitjen e prodhimit. Interesimi i Medinit shkon dhe për studimin e tokës ku janë mbjellur pemët. Të dijtë çfarë nevojash plotëson vetë toka dhe çfarë duhet t'i shtojë, duke llogaritur elementët bazë, pse jo dhe mikroelementët. Shumë shpejt mendon të dërgojë disa mostra në Institutin e tokave në Fushë Krujë, meqë në Dibër nuk mund të kryhen analiza të tilla.

Në rrethin tonë ka qenë një laborator për studimin e tokave, e fatkeqësisht, sot ai nuk është më. Mirë është që kjo mangësi të korrigjohet sa më parë, pasi përcaktimi i llojit të tokës dhe i përmbajtjes së elementeve kimikë në të, është hapi i parë nga ku fillon ngritja e një pemtorje, apo çfarëdo lloj mbjellje dhe aktivitet tjetër.

Nuk ka panair, seminar, apo veprimtari tjetër, ku të mos jetë i pranishëm Medini dhe vëllezërit e tij. Në muajin tetor të vitit të kaluar u realizua për të dhjetin vit radhazi panairi me produkte bujqësore dhe blektorale, i titulluar "Festa e të vjelave". Medini kishte ekspozuar produktet cilësore të fermës së tij, nën logon e fondacionit ADAD, duke tërhequr mjaft vemendjen e vizitorëve të shumtë. Vitin e kaluar, ministri Panariti, pasi vizitoi panairin e Dibrës, bëri një ndalesë të shkurtër në fermën e Medinit, duke i bërë vlerësime maksimale. Para pak muajsh, Medini pati një ftesë të vecante nga televizioni "Top Channel", në dritaren e emisionit "Në shtëpinë tonë". Para gjithë teleshikuesve shqiptarë, ai ekspozoi arrën e Dibrës, si një produkt nga më të mirët në Shqipëri.

Në mes të fermës së vëllezërve Kryemadhi, ku ndodhen dhe shtëpitë e tyre të bukura e mikpritëse, gjenden të parkuara një mori mjeteve motorike. Furgona, zetora, taksi, freza, pompa spërkatëse. Këtij arsenalit mjeteve, ju shtua para dy muajsh edhe një zetor i ri, falë një kooperimi me projektin "Sared". Vlen të përmendim këtu punën me plot përkushtim, të koordinatorit të këtij projekti për Dibrën, ekonomistit vizionar, Dalit Horeshka. Po aty pranë, ndodhet dhe një dhomë frigoriferike me kapacitet 40 ton, ose 200 metër kub, e përfutur para pak vitesh nga një projekt me "Madën". Aplikime të reja dëshiron të bëjë në të ardhmen, për një pus uji, për platformë krasitëse, për vaditje me pika, apo plot projekte të reja, që garantojnë një rritje të sigurtë të prodhimit, por dhe të cilësisë së tij.

Duke pasur disa mjete transporti në pronësi, vëllezërit i kanë shitur vetë prodhimet e tyre në tregun agroushqimor të Kasharit apo dhe në Berat. Jo vetëm kaq, por grumbullojnë dhe mollët, arrat dhe qershitë e shumë fermerëve të tjerë të Dibrës, duke u bërë kështu një shërbim të çmuar fermerëve të tjerë të qarkut.

Vëllezërit Kryemadhi premtojnë se, shumë shpejt, prodhimet e fermës në Ravna të Dibrës do kenë vulën e tyre, duke siguruar konsumatorët vendas, pse jo dhe të huaj, se po blejnë produkte të pastra, të shijshme dhe cilësore.



Dibra ka nevojë sa më parë për një laborator për studimin e tokave, pasi përcaktimi i llojit të tokës dhe i përmbajtjes së elementeve kimikë në të, është hapi i parë nga ku fillon ngritja e një pemtorje, apo çfarëdo lloj mbjellje dhe aktivitet tjetër.

Vëllezërit Kryemadhi me fermën e tyre nuk janë të njohur vetëm në Peshkopi, por edhe në Tiranë e deri në Berat, ku nxjerrin në treg jo vetëm frutat nga ferma e tyre, por edhe nga fermerë të tjerë dibranë

EKSKLUZIVE / Flet Luiza Gega, nënkampionia e Europës në atletikë, flamurbajtësja e ekipit tonë olimpiq në lojërat e "Rio 2016" që zhvillohen nga 5-21 gusht në Brazil: Dua të nderoj Shqipërinë duke synuar medalje

Luiza Gega, 'Flutura kuq e zi'

Unë jam dibrane dhe ndjem krenare për këtë fakt. Gjithnjë më ka shërbyer vendlindja ime për të qenë më ambicioze dhe të kem një lloj krenarie.



Nga **DEFRIM METHASANI**

"Flutura kuq e zi" do ta quaja atleten e talentuar Luiza Gega, e cila vijon të nderojë vetën dhe Shqipërinë në sa e sa veprimtari kombëtare e ndërkombëtare. Sihariqi më i fundit ishte medalja e parë e argjendtë që kjo atlete e vrapimeve të gjata sollti në Shqipëri, duke e kthyer një vend të vogël si i yni, në qendër të vëmendjes së opinionit sportiv botëror. Pas kombëtares së futbollit në "Francë 2016", sukcesi i saj në kampionatin Europian të Atletikës zhvilluar në Holandë, ka nderuar kombin dhe ka gëzuar zemrat e çdo shqiptari, të cilët krenohet me një sportiste dhe fituese model si ajo.

Që nga vitit 2010 Luiza Gega shpallet kampione në rang Ballkanik, nënkampione në ligat e evropiane, duke shkruar historinë e atletikës shqiptare. Megjithatë, përtej medaljeve jeta e Luizës shënon sakrificat dhe regjim deri diku të pabesueshëm të stërvitjes që atletika e detyron. Pasioni i saj i jashtëzakonshëm ka mposhtur vështirësitë jo të pakta në 15 vite të angazhimit të saj me sportin. Stërvitet mbi 6 orë në ditë. Rastet për të pushuar ose festuar, mund të numërohen me gishta në jetën e saj, sepse koha e thërret vazhdimisht në pistë.

Mbrëmja gala në hotel "Tirana International" më 22 korrik me sportistët e ekipit tonë olimpiq, me dha jo thjesht një mundësi për të moderuar një veprimtari të madhe sportive, por edhe të realizoja një intervistë me atleten e shquar dhe kampionen Luiza Gega, e cila ndjehet krenare për dy gjera: Së pari si nënkampione e parë dhe medaliste e Europës në atletikë në garën e 3000 m me pengesa dhe së dyti që është dibrane. Kjo e fundit, me nxitje që të mundësoja një intervistë për gazetën "Rruga e Arbërit", gazetë e cila ka promovuar vlerat e Dibrës dhe dibranëve kudo që ata jetojnë e kontribuojnë. 28 vjeçarja Luiza Gega, pohon faktin se "të qenit dibrane e ka nxitur në jetë për të qenë ambicioze dhe krenare, për të arritur gjithçka nga këmbët e saj dhe askush tjetër..."

- Urime Luiza! Përgjigjet e testeve antidoping erdhen dhe ju rezultuan negative. Si ju bën të ndjeheni ky fakt!



Në foto: Luiza Gega dhe gazetari Defrim Methasani / Njësh me natyrën / Me trajnerin Taulant Stermasi / Pas garës me flamurin shqiptar.

- Faleminderit! Në fakt, pyetja është për ata që i prisnin këto analiza, pasi unë ndjeha krejt e sigurtë në rezultatin e tyre. Unë dhe trajneri im Taulant Stermasi e kemi bazuar punën tonë vetëm mbi rezultatet tona, pa asnjë lloj ndihme nga substanca të jashtme. Por, sigurisht, përgjigja zyrtare është një konfirmim i pastërtisë së ekipit olimpiq që pas pak ditësh nisët për në Rio.

- Duke parë skedën tuaj, shoh faktin që keni lindur në Dibër. Për të shuar jo vetëm kuriozitetin tim, por edhe lexuesit, a mund të tregosh disi më tepër për origjinën tuaj?

- Po Defrim, unë jam dibrane dhe ndjem krenare për këtë fakt. Gjithnjë më ka shërbyer vendlindja ime për të qenë më ambicioze dhe të kem një lloj krenarie. Unë kam lindur në fshatin Okshun të Dibrës dhe kam ardhur 5 vjeç në Durrës, në një fshat diku afër plazhit, në Arape. Prindërit e mi janë njerëz mjaft pu-

nëto. Babai im, Abazi, ka punuar agronom, ndërsa nëna Zgarifete, punon kuzhinierë. Nena me flet shpesh për ty, sepse keni qenë në një shkollë në të mesmen në Peshkopi. Jemi 5 fëmijë, katër motra dhe një vëlla. Unë, që e vogël, kisha prirje për atletikën dhe fillimet e mia i takojnë pikërisht këtij sporti në qytetin e Durrësit. Që e vogël dallohesha në fshat nga vajzat dhe fëmijët e tjerë, sepse vrapoja në ato pllaja të bukura të fshatit tim dhe vendeve piktoreske që kemi atje.

- Ju tani jetoni në Durrës, por si i mbani lidhjet me vendlindjen? A keni nostalgji?

- Tani që merren me sport e kam disi të vështirë të shkëputem dhe të shkoj në vendlindje, por para disa kohësh kam qenë, madje kam dëshirë të shkoj shpesh. Kemi njerëzit tanë atje dhe i ruajmë shumë mirë marrëdhëniet, edhe pse jo pak kanë zbritur në Durrës dhe Tiranë. Na merr malli për vendin,



malet, lumin, gurët, ajrin e pastër, Zallin e Okshunit (qesh) e zemrën e bardhë të atyre njerëzve. Mbiemri Gega atje është shumë i njohur dhe unë vërtet ndjem krenare që fisin tim, Okshunin, por dhe Dibrën i kam bërë të ndjehem krenarë. Sa herë dëgjoj këngët dibrane, kujtoj ritet tona, dasmat, madje kam marrë pjesë edhe në disa gëzime familjare atje dhe me pëlqejnë edhe kur vishen gratë dhe vajzat e fshatit. Kur ka dasëm vjen i gjithë fshati e kërcejnë. Sa zakone të bukura që kemi, se ke idenë. I kam si sot në mendje dhe më merr malli shumë të jem pranë tyre. Motrat e mia shkojnë më shpesh, madje njëri e kam sportiste dhe kërkon të ecë në gjurmët e mia, ashtu si vajza e tezes, e cila ka dale fituese në shumë gara kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kam bindjen se do të bëhet si unë. Ajo quhet Relaksa Dauti dhe ka të dhëna shumë premtuese, madje shumë shpejt do merreni në intervistë edhe atë, jo vetëm me mua

- Luiza Gega, solle të parën medalje në Shqipëri si nënkampione Europe, pra medalja e parë e argjendtë. Si u ndjeve kur u ngjite në pod?

- Të betohem sa s'më ra të fikët. S'ju besoja syve, madje kam qarë prej gëzimit. Flamurin e kisha me vete, sepse besoja shumë që në kampionatin e fundit Europian që u zhvillua në Holandë, do të isha fituese. Koha ime ishte 9 minuta 28 sekonda e 52 të qindtat. Ishte rekord i ri kombëtar dhe u gëzoja shumë. Vetëm kundërshtarja ime gjermane më doli para, ndërsa në finish të tjerat i lashë pas. U rendita pas atletes turken Gesa-Felicitas Krause dhe lash pas gjermanen Meryem Akda, në garën 3000 metra me pengesa, e cila konsiderohet nga disiplinat më të vështira në atletikë. Gjithsesi, e dyta në një Europian nuk ishte pak. Të gjithë kamerat u përqendruan tek unë, sepse ishte e papritur për ta, nuk kish ndodhur ndonjëherë. Unë derdhja lot dhe se lëshoja flamurin. S'ka gjë më të bukur të fitosh për vendin tënd. Jam akoma e emocionuar....



Luiza Gega, e para majtas, me medaljen e nënkampiones së Europës

Sa herë dëgjoj këngët dibrane, kujtoj ritet tona, dasmat, madje kam marrë pjesë edhe në disa gëzime familjare atje dhe me pëlqejnë edhe kur vishen gratë dhe vajzat e fshatit. Kur ka dasëm vjen i gjithë fshati e kërcejnë. Sa zakone të bukura që kemi, se ke idenë. I kam si sot në mendje dhe më merr malli shumë të jem pranë tyre.

- Kujt ia dedikon suksesin më të fundit si nënkampione Europe në garën e 3000 metrave me pengesa?

- Natyrisht, trajnerit tim Taulant Stërmasi, që është njeriu i suksesit tim. Kam shtatë vite që punoj në mënyrë intensive me këtë trajner dhe tashmë ja ku doli rezultati. Kam besuar tek vetja, sepse trajneri gjithnjë me thoshte: "Luiza, do vijë dita jote"! Dhe sot ky është një realitet shumë i bukur.

Së dyti, ia dedikoi prindërve dhe familjes sime, që kanë sakrifikuar shumë për mua. Kemi qenë shumë fëmijë, por asnjëherë s'më penguan prindërit që unë të realizoj ëndrrën time të sportit. Madje, studimet e mesme i kam bërë në shkollën e mjeshtërisë në Durrës. Gjithsesi, sukcesi im, edhe pse është personal, ka edhe elementë të tjerë që duan të vlerësohet, si klubi Tirana, KOKSH, federata e atletikës ku bëj pjesë dhe mjaft të tjerë dashamirës që më nxitën të jem e tillë. Ah, se harrova, edhe ju Defrim, ty dhe disa gazetarëve të tjerë që s'më latë vetëm asnjë moment, as atë mbrëmje të paharruar natën e kthimit nga Holanda, por edhe në veprimtari të tjera ku unë kam marrë pjesë dhe kam sjellë shumë tituj e trofe, medalje e rekorde.

- Si e vlerëson priten në Rinas pas kthimit në atdhe si nënkampione Europe dhe si qëndron ajo historia e limuzinës që u përfol gjatë në media dhe rrjetet sociale?

- Bëre mirë që ma bërë këtë pyetje, sepse edhe pse e kam sqaruar në shumë ekrane televizive apo gazeta, dua të ritheksoj përsëri: Në Rinas më priten jo autoritetet e larta zyrtare të shtetit, por drejtuesit e federatës, të drejtorisë së sporteve në ministri dhe mbi të gjitha shumë qytetarë dhe fansa. Arsyeja që m'nguan drejtuesit e lartë të shtetit, apo ministrisë, siç e mora vesh më vonë, ishte fakti që duhej të mos ndodhte ndonjë problem si me peshëngritjen, që pasi i pritën me pompozitet, ardhja e përgjigjeve për doping ndryshoi gjithçka dhe s'ju njohu as rezultatet e arritura, madje i shkurorëzoi nga medaljet. Ndaj, nuk donin që kjo të ndodhte as me mua, deri në prite të përgjigjeve të analizave për doping, që zgjasin disa ditë pas gare. Gjithsesi, kjo për mua kishte pak rëndësi. Me rëndësi ishte ardhja në aeroport e shumë njerëzve të thjeshtë, saqë se besoja kur dola nga mjedisi i aeroportit. Lule e pankarta në duar, fjalë mirëseardhje, gazetarë me kamera dhe shume fotoreporterë. Vërtet, nuk kishte gjë më të bukur. U ndjeva shumë e lumtur dhe mu duk se kishte dalë gjithë Shqipëria aty. Aq u emocionova, saqë nuk dalloja dot as motrat dhe njerëzit e familjes sime... Vetëm lotoja prej gëzimit dhe faktit që i bëra këta njerëz kaq të lumtur. Pasi dhashë intervistat, ku ju ishit prezent, u futëm në një limuzinë, që presidenti i Federatës së



Foto nga garat ku u shpall nënkampione e Europës

Atletikës, Gjergj Ruli, kish porositur për mua dhe Izmir Smalajn, atletin tjetër që ishte me mua në European dhe doli i teti në kërcim së gjati. Pasi bëmë disa qindra metra rrugë, duhej të zbrisnim, sepse unë do të shkoja në Durrës me njerëzit e familjes sime që kishin dale të më prisnin dhe Izmiri do ikte me familjen e tij në Shkodër. Kjo është e vërteta. Pra, nuk na zbriti askush, por donim vetë sepse ishte shume vonë dhe po vinte mëngjesi e ishim të lodhur nëpër aeroporte...

- Brenda këtij viti ju siguroat edhe titullin kampione Ballkani në garën e 1500 metrave në salla të mbyllura zhvilluar në Stamboll. Pra, jeni në Top formë. A do të jeni kështu edhe në olimpiadë?

- Vërtet gëzoj një super formë sportive. Jam stërvitur fort këtë vit në Tiranë dhe Korçë me trajnerin tim Taulant Stërmasi, të cilin dua edhe ta falënderoj nga zemra. Falë punës së tij, jam kjo që flasim sot, sepse kurba ime që kur nisa të punoj me këtë trajner, ka ardhur në ngjitje, madje shënon kulmin me Kampionatin European. Olimpiada është një rast ideal për mua të tregoj sa vlej. Ka shumë konkurrence, natyrisht, madje nuk mund të krahasohet me një kampionat European. Por, deri tani, me stërvitjen time dhe rezultatit që kam, hyj në zonën e pretendentëve për medalje. Dua ti shkoj deri në fund kësaj rruge të bukur, sepse Shqipëria dhe shqiptaret meritojnë të gëzohen me mua, pse jo edhe dibranët që i kam shumë për zemër.

- Vështirësitë a janë bashkudhëtare në këtë rrugë të gjatë të jetës tënde sportive dhe si ia ke dalë?

- Më preke në tela tani. Natyrisht, nëse do më kishin përkulur vështirësitë, sot nuk do isha kjo që jam. Ankesat nuk kanë fund, si për pistën, pagesat, mungesa e mjekut, fizioterapistit, të ardhurat e pagesat që nuk janë aspak shpërblyese. Por, pasioni im i ka sfiduar të gjitha këto. Ndryshe, s'do arrija deri këtu ku jam sot. Nëse vetëm ankoresh, qahesh, apo bën vetëm kritika, kurrë nuk ia del. Unë i kam hyrë detit me këmbë dhe deri tani ia dola. Por, rruga është e gjatë dhe vazhdon akoma. Natyrisht, që kam nevoja, sepse jam edhe femër, familjare, sporti është i vështirë, shumë pajisje shtesë që më nevojiten për stërvitjen kushtojnë, pa përmendur ushqimet apo nevojat e tjera që ka jeta. Unë tashmë jetoj në Tiranë

"DO TA BËJ ME VRAP RRUGËN E ARBRIT..."

"Të jap fjalën se nëse ndodhte ajo mrekulli, pra të bëhej rruga e Arbrit, unë do e bëja me vrap dhe jo me makine. Aq e lumtur do të isha. Dibranët do të shpëtonin vërtet me rrugën, sepse Tirana do ishte shumë afër dhe ajo zonë atje do pasurohej më shumë dhe shumë shpejt, duke rritur interesin edhe për biznesin, por veçanërisht për turizmin. Fshati im është shumë i bukur dhe jam e bindur që nëse do të bëhej rruga, shumë vizitorë do të çoja dhe unë nga jashtë, që ta shihnin atë perlë të natyrës shqiptare..."



Në stërvitje.

në shtëpi me qira, sepse si dal dot çdo ditë të vij nga Durrësi e të kthehem. Më besoni, nuk kam kohë të shoh as familjen time...

- Të jesh flamurmbajtësja e një vendi në lojërat olimpikë sa emocion, krenari dhe përgjegjësi është për një sportiste si ti?

- Të treja bashkë. Singërisht, kur më dorëzoi flamurin kombëtar ministria e Arsimit dhe Sportit Lindita Nikolla, m'u drodhën duart dhe se besoja as vetë. Është një nder shumë i madh dhe mezi e pres 5 gushtin, që të ec krenare me këtë flamur kaq të bukur që kemi ne si shtet dhe komb. Kjo është një arsye më shumë që unë dhe trajneri im kërkojmë një rezultat fantastik, sepse kemi një nderim dhe përgjegjësi të shumëfishtë. Ky është momenti më i rëndësishëm në jetën time....

- Gazeta ka emrin "Rrugë e Arbërit", emër që përkon me rrugën e Arbrit që dibranët kanë vite që e kërkojnë, por akoma se kanë. Nëse bëhej si do të ndjehej Luiza Gega dhe a do ta bënte atë rrugë më shpesh drejt vendlindjes së saj?

- Të jap fjalën se nëse ndodhte ajo mrekulli, pra të bëhej rruga e Arbrit, unë do e bëja me vrap dhe jo me makine. Aq e lumtur do të isha. Dibranët do të shpëtonin vërtet me rrugën, sepse Tirana do ishte shumë afër dhe ajo zonë atje do pasurohej më shumë dhe shumë shpejt, duke rritur interesin edhe për biznesin, por veçanërisht për turizmin. Fshati im është shumë i bukur dhe jam e bindur që nëse do të bëhej rruga, shumë vizitorë do të çoja dhe unë nga jashtë, që ta shihnin atë perlë të natyrës shqiptare...

Mediat e tjera për Luizën

Reporter.al

Luiza Gega, atletja pa pistë vrapimi që garon në Lojërat Olimpikë

Mungesa e infrastrukturës sportive dhe vëmendja institucionale nuk janë të vetmet pengesa të cilat atletja shqiptare është detyruar të kalojë për t'u shpallur nënkampione e Europës.

Autor: Lindita Nikolla | BSHN | Tirana

Ajo është shqiptarja e parë që shpallet nënkampione e kontinentit në një kampionat europian të atletikës. Luiza Gega u rendit e dyta në garën e 3000 metrave me pengesa që u zhvillua nga datat 6 deri më 10 korrik në Amsterdam të Hollandës, duke e ndalur kronometrin në 9 minuta, 28 sekonda dhe 52 të qindat...

Më shumë mund të lexoni në linkun e mëposhtëm:

<http://ëëë.reporter.al/luiza-gega-atletja-pa-piste-vrapimi-qe-garon-ne-lojrat-olimpike/>

QYTETI NË DY SHTETE / Uliksi në Itali: Pjesa 2



Emigrimi në sytë e një djaloshi

Nga **DIONIS XHAFA**

Ishte vapë e madhe. Gjinkallat zhukasnin nëpër fusha. Uliksi gjendej në një vend i cili i dukej sikur të jetë fundi i botës. Qetësi e madhe. Rreth e rrotull sera e fusha të mbjella me duhan. Gjithashtu edhe magazina e kabanone. Përpara Uliksit u shfaq një derë e hekurt. Kjo dukej se ishte e vjetër qysh para lindjes së Dante Aligherit dhe përpara Jezu Krishtit madje. Aty brenda Uliksi shikoi gjendjen e rëndë, apokaliptike. Ai pa dy rumunë që punonin duhanin në dy të drekës kur dielli të binte mu sipër kokës. Të dy ishin zhveshur nga mesi e lart dhe shfrynin ndërsa punonin në duhan. Si bëri pak më tutje, vuri re edhe një dhomë të vogël. Brenda në dhomë gjendeshin emigrantë të etnive të ndryshme. Aty kishte shqiptarë në të shumtë, por gjendeshin edhe dy rumunë.

Në të kishte shtretër sikur në konvikte, të krijuar me mjete rrethore dhe thjesht një televizor të vogël, i cili herë kishte sinjal dhe herë nuk kishte. Një hapësirë tepër e vogël ishte kjo që të mund të banonin dhe të jetonin aty kaq shumë njerëz. Aty Uliksi pa edhe roba krejt të papastrë të lëshuara në tokë. Ai vuri re se edhe punëtorët e duhanit aty ishin krejt të dobët dhe se iu kishin dalë kokat jashtë. Kurrë nuk kishte parë të tilla pamje. Ishte hera e parë që shikoi të tilla skena që për syrin e tij ishin të tmerrshme. Uliksi vërejti se edhe emigrantët aty nuk shkonin kaq mirë me njëri-tjetrin. Rumunët e kishin ulur kaq shumë pazarin për të punuar në duhan sa që shqiptarët ishin irrituar fort me këtë fakt. Shqiptarët urrenin rumunët për shkak se këto të fundit e kishin ulur pazarin shumë, kurse rumunët "kokëkrisur" punonin me pagë më poshtë se normalen në duhan, në atë pikë vepër, në atë zagushi të tmerrshme dhe rraskapitëse.

PUNA E RËNDË

Uliksi 14 vjeçar sapo kishte parë një skenë e cila nuk i pëlqeu aspak. Nga ana tjetër "trandja" që kishte marrë i shërbeu jo pak për të burrëruar në mendje e në shpirt. Adoleshenca e papërfunduar siç duhej e tij kishte mbaruar dhe e vërejti se kjo rrugë ishte përplot pengesa e vështirësi. Ai pa sesi njeriu e shtyp njeriun apo sesa e vështirë është që ta fitosh paranë. Tashmë ra mbrëmja dhe Uliksi u nis për në Nola, në periferi të Napolit. Aty takoi babanë por edhe zuri mik

një bashkëmohatar. Edhe ky i fundit kishte ardhur tek babai i tij. Me bashkëmohatarin Uliksi fliste sinjerisht për atë sesa e vështirë është jeta apo sesa e vështirë është të mësosh. Por se e biseduan se në një vend si Shqipëria, edhe po të mësosh, prapë e vështirë është të përparosh.

Kështu dy-tri ditë qëndruan thajse së koti derisa baballarët i morën nëpër fusha që të shihnin sesi punohej në emigrim. Uliksi u çua në orën 05.00, kohë kjo e zakonit për emigrantët për të zgjuar nga gjumi. U bënë katër persona tanimë, miq nga Shqipëria. Dy baballarët e dy djemtë e tyre do të punonin. Uliksi dhe shoku i tij u lutën që të punonin edhe ato, por baballarët nuk pranuan. Në të tillë mënyrë Uliksi pa një ditë pune të emigrantëve. Ai vërejti sesi tufat e emigrantëve që nga Afrika Qendrore, Afrika Veriore, nga Ballkani dhe më gjërë punonin për orë të tëra në fushë. Ai pa sesi punëtorët ngrinin duart që kur dielli lindte e derisa perëndonte. Pak pushonin.

Kjo sepse ritmi i punës ishte i lartë dhe ishte koha e prodhimit të domateve. Ndërsa çudi e madhe ishte fakti se duke qenë se ishte muaji i Ramazanit, shumica e emigrantëve, ata të besimit islam edhe agjëronin. Sakrifika e tyre ishte e dyfishtë. Djersët iu shkonin çurg dhe as nuk pinin ujë. Uliksi pa se një ditë pune në tokë të huaj ishte e rëndë dhe vetëm e imagjinonte sesi mund të jetë vite të tëra pune. E kishte dashur fort Italinë dhe kishte menduar se ishte paradisi. Mirëpo ai perceptim që kishte patur për këtë vend i ishte shembur jo pak në tokë nga realiteti që po e shikonte me sytë e tij. Atë natë, pas pune, pa babain teksa shtrihej i lodhur sikur të ishte ndonjë i vdekur.

Vetëm tani e kuptoi sesa me vështirësi ishte rritur ky baba dhe sesi e fitonte paranë. E pa babanë teksa u shtri plumb i rëndë sepse nesër sërish do të punonte. Kështu thajse të ngjashme me këtë i shkuan Uliksit 30 deri në 40 ditë. Ai vërejti goxha errësirë. Në tren me babanë teksa ktheheshin për në Napoli, i ati i tregoi Uliksit qytetin historik. "Ja ku është Napoli. Kjo është qendra e qytetit historik që njihet nga e mbarë Europa dhe bota. Kudo të shkosh, edhe në Amerikë, nuk gjen më tepër zhvillim sesa kaq. Edhe ndërtesat kaq të larta janë dhe jo më tepër", tha babai. Uliksi, si u kthye rroku mësimet dhe nuk e donte të ardhmen të atillë. Por se edhe me të mësuar, asgjë nuk ishte e sigurt nëse Uliksi kthehej apo jo në atë vend ose në vende si ky.

Pishat e mbetura në Lurë rrezikohen të priten

Më datë 26 korrik 2016, përmes rrjeteve sociale, qytetarë të angazhuar dhe specialistë të pyjeve ngritën shqetësimin se në Gurë Lurë, në vendin e quajtur Tërthore, disa individë kanë filluar të presin pishat dhe kanë vendosur makineritë e përpunimit të tyre, me qëllim nxjerrjen në tregun e zi.

Disa banorë të Lurës na thanë përmes telefonit se kishin dëgjuar se ishin prerë disa pisha, por nuk e dinin se kush po e bënte këtë.

Një burim pranë policisë së Dibrës tha se në terren kanë shkuar specialistë nga Inspektoriati i Pyjeve, nga bashkia Dibrë dhe forca të policisë dhe se po punohet për identifikimin e pasojave dhe personave përgjegjës. Të dhënat e para tregojnë se pishat e prera nuk kanë qenë për t'u nxjerrë në treg, por për nevoja të disa familjeve në Gurë-Lurë. "Por derisa hetimi të dalë në konkluzione të sakta, ne nuk mund të japim më shumë informacion", theksoi burimi nga policia e Dibrës.

Lidhur me këtë ngjarje, ne po botojmë një reagim të Dr. Selman Mëziut, njëri prej specialistëve të pyjeve, i cili ka qenë edhe njëri nga projektuesit e pyllëzimit në këtë vend.

Gjithashtu, redaksia konfirmon edhe njëherë ndjeshmërinë rreth çështjeve mjedisore, kështu që është e gatshme të botojë çdo lloj raporti në këtë drejtim, me qëllimin e mirë që të mbrojmë mjedisin tonë natyror, si shërbimi më i mirë që mund ti bëjmë komunitetit dhe vendit. / **Redaksia**



Parcelat e Tërthores janë pyje mbrojtës, sepse ndodhën në shtatë më pjerrësi që i kalojnë të tetëdhjetë përqind. Pra, prerja e tyre pa kriter teknike do të sjellë në një të ardhme të shpejtë, rrëshqitjen e tokës dhe krijimin e ortekëve të borës, duke u bërë rrezik vdekje për familje të tëra të fshatit Gurë-Lurë.

Masakër në pishnajat e Gurë Lurës

Nga **Dr. SËLMAN MËZIU**

Pyjet ende në rrezik nën terrorin e motosharrave. Bandat e masakrave të vegjetacionit më dinamik e më të gjallë, kanë ende fuqi shkatërruese mbi këto. Pyjet iu kanë kaluar bashkive më një amendament ligji para disa muajsh. Moratoriumi u aprovua nga pozita duke vënë në dukje se ishte zgjidhja historike e problemeve të mprehta e shqetësues të pasurisë pyjorë.

Por, më gjithë këto masa nga qeveria, më 26 korrik 2016, disa individë kanë filluar më motosharra më një terror naziskin, pa iu trembur farë syri, të presin pa kurrfarë leje e rregull teknike pishnajat e Tërthorës mbi Gurë-Lurë. Kriminelët e shkatërrimit të pyllit punojnë kaq të qetë, sa që i rrezikojnë pishat e zëza shtatlarta shtatëdhjetë vjeçare dhe kanë vënë skelat ku çajnë edhe dërrasa plotë mjeshtri e qetësi absolute.

Më sa duket, këto "banditë" për të cilët nuk dimë së nga vijnë, kush janë, punojnë pa iu trembur syri. Populli i Gurë Lurës dhe i Lurës është tmerruar, indinjuar, zëmëruar dhe revoltuar tej mase. Por, nuk janë në gjendje as t'u afrohen. Dhe ato me të drejtë presin që t'u ndalohet dora këtyre banditëve, ndoshta të mbrojtur nga shteti në fuqi. Atyre u duhet dhënë dënimi më i egër, më i pamëshirshëm. Sepse e meritojnë. Por kush t'ua jap vallë?

Lë ta shtrojmë problemin në disa këndvështrime:

Së pari: a ishte ky shtet që trumbetoi me të madhe duke filluar nga Kryeministri Rama në Elbasan dhe në Parlament kur theksoi se ky moratorium ka rëndësi historike dhe do të arrijë të ndalojë shfrytëzimin e pyjeve për dhjetë vjet. Ndërsa Ministri Lefter Koka, në disa intervista në televizionet shtetërore e privatë, në gazeta etj, u çjerr duke bërtitur se jo vetëm nuk do të priten pyjet por do të mbijellim dhjetë milionë fidanë. Ku shkuan këto premtime. Apo demagogji e paskrupullt për të mbajtur pushtetin e mbjellur korrupsionin.

Së dyti: po kaq mburrëse e zgjidhje historike ishte kalimi i fondit pyjor bashkive. Dhe kjo u arrit. Atëherë pse Bashkia Dibrë me organikën e vetë më specialistë pyjesh nuk paraqitet urgjentisht në vendin e batërdisë pishnajorë? Apo nuk funksionon asgjë?

Së treti, propaganda vesh shurdhuesë për shtetin ligjor ka marrë arratinë, shpateve të zhveshura të maleve e përranjëve. Po ai kod

penal për krimet e mjedisit ku ka mbetur që edhe ky u trumbetua me të madhe në shkurt në Elbasan nga Kryeministri Rama. Sepse nuk ka së si shpjegohet që një grusht matrapazësh të presin këto kolona të gjelbërta në muajin korrik, ku ligjërisht në mbarë botën, nuk lejohet shfrytëzimi i pyjeve së ato janë në periudhë e vegjetacionit të plotë. Kjo e shpjeguar më thjeshtë është një lloj si të therësh lopën, delen ose dhinë barsë.

Së katërti, pse nuk veprohet urgjentisht në privatizimin e pyjeve, por qeveritë e demoshkatërrimit përgjatë 25 vjetëve ia hedhin fajin njëra-tjetër. Duke i lënë ato pak "thërrimë" sipërfaqesh pyjorë që kanë mbetur nën shkatërrimin huliganist të disa njerëzve.

Prandaj, kërkohet veprim energjik i Ministrisë së Mjedisit, i organeve të administrimit të pyjeve në Bashkinë Dibrë të veprojnë urgjentisht për ndalimin e kasaphanës së pishnajave të Gurë-Lurës, të vetmet masivë që kanë mbetur. Plagë të pashërueshme i janë hapur mjedisit pyjor Lurë, e megjithatë akoma shkretëtira të tjera po përgatiten pa kurrfarë përgjegjësie qytetare, ligjorë apo shtetërore.

Parcelat e Tërthores janë pyje mbrojtës, sepse ndodhën në shtatë më pjerrësi që i kalojnë të tetëdhjetë përqind. Pra, prerja e tyre me rrysh, pa kriter teknike do të sjellë në një të ardhme të shpejtë, rrëshqitjen e tokës dhe krijimin e ortekëve të borës, duke u bërë rrezik vdekje për familje të tëra të fshatit Gurë-Lurë.

Atëherë çfarë duhet të presim? A nuk duhet të bashkohem me revoltën zemëruese, të dhimbshme të banorëve të Lurës e Gurë Lurës, të gjithë pylltarët, bijë e bija të atyre zonave, ish banorë të Lurës kudo që janë, duke jetuar brenda Shqipërisë, apo jashtë saj? Për të ndalur dorën mafioze të shkrimit të mëtejshëm të atyre pyjeve që kanë mbetur në malësi të atjeshme. Duhet që të gjithë, të bashkuar, të tundim nga themelet shtetin që të mbrojmë pasurinë pyjorë si pjesë e ushqimit dhe e mbrojtjes së popullsisë nga katastrofat natyrore. Lejimi i dhëmbëve të motosharrave që përdoren nga matrapazët e vegjetacionit pyjor, do të na çojë në përgatitjen e varreve tona.

Prandaj, zgjohuni e demaskoni politikën e pakryer të qeverisjes të pasurisë pyjore. Kjo mospërgjegjësi do të jetë me pasoja katastrofike për banorët që jetojnë sot dhe për brezat që do të vijnë.

27.07.2016

Faza përgatitore do të fillojë më 1 gusht në Peshkopi, ku do të qëndrohet deri në fund të gushtit, për të ardhur më pas në Tiranë për t'u bërë gati për ndeshjen e parë të sezonit më 7 shtator, teksa shorti ende nuk është mësuar.

Korabi, surprizë edhe në Superiore

Nga EDUARD ILLICA

Pas më shumë se pesë dekadash Korabi rikthehet në elitën e futbollit shqiptar dhe në sezonin e ri do të garojë në Kategorinë Superiore, krahas skuadrave me emër, si Skënderbeu, Partizani, Tirana, Vllaznia e të tjerë. Një realitet i pranuar tashmë nga opinion sportiv shqiptar. Kuptohet, si një ekip pa shumë pwrvojv në këtë kategori, edhe organizimi nisi me vonesë. Për të zgjidhur ngërçin kanë menduar sërish dy donatorët dibranë në Amerikë, Selim Rusi dhe Naim Agolli. Falë tyre, me anë të një sponsorizimi emergjent, Korabi nisi të "lëvizë", madje në dy javë arriti të lërë shenjë, duke qenë klubi më aktiv në merkato, pasi afroi plot 20 lojtarë. Fillimisht, pas emërimit të ish-donatorit Fehmi Mëziu në krye të klubit, biznesmenët në Amerikë ia besuan drejtimin e ekipit trajnerit Artan Mërxhushi. Ky emërim edhe për faktin se trajneri ka qenë pjesë e Korabit në vitet 80' dhe e nje mirë ambientin dibran. Trajneri Mërxhushi mori si ndihmës ish-futbollistin e njohur dinamovit, fierakun Artion Poci, i cili në mesin e viteve 2000 shpallej kampion i Shqipërisë. Trajner i portierëve në sezonin e ri do të jetë Ermal Nexhipi, që më parë e ka bërë këtë detyrë te Tërbuni dhe Bylisi.

MERKATO

Shumë ishin skeptikët që nuk besonin që Korabi do të ndërtohej i fortë, me një grup lojtarësh cilësorë. Por shprehja "O Korab mos ki frikë, se ke djemtë në Amerikë" sërish u bë lejmotiv te klubi dibran. Menjëherë në arkat e klubit u derdhën 75 mijë dollarë nga Naim Agolli dhe drejtuesit nuk humbën kohë. U nënshkruan edhe kontratat e para, një grup prej gjashtë lojtarësh, të gjithë me eksperiencë, fitues të Kupës së Shqipërisë dhe finalist edhe sezonin e fundit me ekipin e Laçit, duke filluar me portierin malazez Miroslav Vujadinovic, mbrojtësit Emiljano Cela dhe Arjan Sheta, për të vijuar me mesfushorët Emiljano Veliq, Alfred Zefi dhe Agim Meto. Pak ditë më pas ishte radha e sulmuesit Denis Peposhi, që sezonin e fundit ishte pjesë e Kukësit. Në provë erdhën shumë futbollistë, madje edhe nga Brazili i largët, por edhe nga Kosova dhe vende të tjera. Por në fund nga të huajt bind vetëm mbrojtësi i krahut të djathtë Dushko Dukic,



Drejtesit e Korabit gjatë një konference shtypi

që në muajt e fundit të sezonit të fundit ishte pjesë e Bylisit në Superligë. Pastaj do të ishte radha e grupit që udhëhoqën Korabin drejt majave. Firmos kapiteni Sokol Mziu, shkodranët Daniel Jubani dhe Fatjon Kiri. Por pjesë e Korabit në sezonin e ri do të jenë edhe dy djemtë e legjendës së gjallë dibrane Kujtim Prençi. Elvisi dhe Endri, dy djem dibranë do të jenë në grupin bardhekuq, për të dëshmuar edhe njëherë se Dibra nxjerr talente edhe në sportin e futbollit.

Por, merkatoja e Korabit nuk do të përfundonte këtu, trajneri Mërxhushi merr nga Apolonia dy lojtarë cilësorë, kavajasin Ervis Kaja dhe fierakun Rudin Nako, i pari mesfushor shkatërrues dhe i dyti mbrojtës. Për të vijuar me mesfushorët Meglid Mihani dhe Gabriel Mezini dhe për të përfunduar me portierin e dytë Spahija. Pra, në më pak se një javë, Korabi firmos me plot 18 futbollistë, si asnjë ekip tjetër në Superiore, duke u hedhur "dorashkën" skuadrave të tjera, sidomos rivalëve për të mbijetuar në kategorinë e më të mirëve.

ORGANIZIMI

Korabi i Superligës nuk është duke punuar vetëm në aspektin e ndërtimit e ekipit të ri, por edhe në anën administrative, që nga ngritja e strukturave, krijimi i shoqërisë aksionare, marrjen e zyrave të reja, afrimin e sponsorëve të ekipit, trajtimin e futbollistëve sipas standardeve europiane dhe deri kushtet e akomodimit dhe lëvizjes së skuadrës apo

krijimin e kushteve stërvitore. Së pari, çka është edhe më kryesorja, biznesmeni Selim Rusi është interesuar personalisht për të marrë Korabin në mënyrë ligjore, çka do të thotë se klubi i Korabit fillimisht do të kalojë në sh.a, ku 75% të aksioneve (maksimumi që mund të marrë një person ose biznes do të jenë të Zotit Rusi dhe 25% të Bashkisë Dibrë, e cila zotëron edhe logon e klubit dhe asetet e patundshme. Ndërkohë, drejtori Fehmi Mëziu ka blerë edhe autobusin për të lëvizur ekipin, madje me dedikim të logove të ekipit të Korabit, ashtu siç i ka hije një klubi pjesëmarrës në Superligë. Futbollistët që nuk janë me banim në Tiranë janë strehuar pranë qendrës stërvitore ku do të kryejnë stërvitjet, pranë kompleksi "Skënder Halili". Ndeshjet do të luhen në stadiumin "Selman Stëmasi", ku është lidhur edhe kontrata për një sezon me këtë impiant. Para çdo ndeshje do të ketë grumbullim dhe trajtimi ushqimor do të vijojë gjatë gjithë javës.

SPONSORËT

Përveç donatorëve kryesorë nga Amerika, pranë ekipit janë afruar ose janë tentativë për t'u afruar edhe të tjerë biznesmenë. Kështu, baza materiale për 25 futbollistë dhe për stafin teknik është sponsorizuar nga firma "Armierungen Armafix" me në krye Zotin Jeton Kraba. Edhe baza didaktike është porositur po nga kjo firmë, pa harruar që faza përgatitore e janarit do të mundësohet në Spanjë nga Zoti Kraba. Ndërsa Zoti Fehmi

Pas emërimit të ish-donatorit Fehmi Mëziu në krye të klubit, biznesmenët në Amerikë ia besuan drejtimin e ekipit trajnerit Artan Mërxhushi (në foto). Ky emërim edhe për faktin se trajneri ka qenë pjesë e Korabit në vitet 80' dhe e nje mirë ambientin dibran. Trajneri Mërxhushi mori si ndihmës ish-futbollistin e njohur dinamovit, fierakun Artion Poci, i cili në mesin e viteve 2000 shpallej kampion i Shqipërisë. Trajner i portierëve në sezonin e ri do të jetë Ermal Nexhipi, që më parë e ka bërë këtë detyrë te Tërbuni dhe Bylisi.

MERKATO

Shprehja "O Korab mos ki frikë, se ke djemtë në Amerikë" sërish u bë lejmotiv te klubi dibran. Menjëherë në arkat e klubit u derdhën 75 mijë dollarë nga Naim Agolli dhe drejtuesit nuk humbën kohë.

ORGANIZIMI

Biznesmeni Selim Rusi është interesuar personalisht për të marrë Korabin në mënyrë ligjore, çka do të thotë se klubi i Korabit fillimisht do të kalojë në sh.a.

SPONSORËT

Përveç donatorëve kryesorë nga Amerika, pranë ekipit janë afruar ose janë tentativë për t'u afruar edhe të tjerë biznesmenë.

STËRVITJA DHE MIQËSORET

Korabi po e kryen stërvitje të kompleksi "Internacional" në Pezë-Helmës. Miqësorja e parë është fituar 5-0 kundër Internacional. Miqësorja e dytë është programuar me Kamzën. "Qershia mbi tortë" do të jetë miqësorja në Peshkopi kundër Skënderbeut.

Mëziu, edhe pse në rolin e drejtorit sportive, vijon të sponsorizojë pranë ekipit, pa harruar edhe dibranin Altin Elezaj, që kujdeset çdo ditë pranë ekipit me shërbime të ndryshme. Njëkohësisht, është arritur akordi që restoranti "Pëllumbat e Paqes" me pronar Zotin Fatmir Kurti të trajtojë me ushqim ekipin e Korabit gjatë 24 orëve para ndeshjes së radhës, por edhe në raste të veçanta. Ndërkohë, kompleksi "Eiba" në Peshkopi nuk do të mungojë edhe gjatë këtij sezoni, teksa futbollistët do të trajtohen gjatë fazës përgatitore. Por nuk do të mungojë edhe Zoti Musa Ricku apo Shemsi Prençi, të cilët me premiot apo me donacione të ndryshme do të nxisin ekipin për të marrë sa më shumë rezultate pozitive.

STËRVITJA DHE MIQËSORET

Për më shumë se dy javë me radhë Korabi ka kryer stërvitje të kompleksi "Internacional" në Pezë-Helmës. Paradite është vrapuar te "Kodrat e Liqenit", ndërsa pasdite është punuar kryesisht me topin dhe teste të vogla brenda grupit thuajse çdo ditë. Ndërsa miqësorja e parë është fituar 5-0 kundër Internacional. Miqësorja e dytë është programuar me Kamzën, që ka ndërtuar një ekip të denjë, duke pretenduar Superiore. Por "qershia mbi tortë" do të jetë miqësorja në Peshkopi kundër Skënderbeut, ku i pranishëm pritet të jetë edhe vetë Zoti Selim Rusi. Një miqësore luksi edhe për tifozët e shumtë dibranë, të cilët do të kenë mundësinë për herë të parë të shohin ekipin kampion të ndeshet me Korabin. Faza përgatitore do të fillojë më 1 gusht në Peshkopi, ku do të qëndrohet deri në fund të gushtit, për të ardhur më pas në Tiranë për t'u bërë gati për ndeshjen e parë të sezonit më 7 shtator, teksa shorti ende nuk është mësuar.



Fletë nga cikli BURRAT E DIBRËS: Me Dr.As. Nazmi Koçin, "Pesë orë udhëtim në këmbë"

Nga ABDURAHIM ASHIKU

(Vijon nga numri i kaluar)

Vitin e parë të punës më janë bërë disa emërime. Njëherë u emërova në hekurudhë, në Elbasan. Isha kandidat për pedagog në fakultetin e mjekësisë. Dekani ishte dibran dhe i ruhej kësaj. Kështu u dogjëm unë dhe Qemal Çadri, kandidatë pothuaj të deklaruar për pedagogë.

Emërimin në Elbasan e prita mirë sepse atje punonte Jashar Menzelxhiu dhe ishte një mik i babait tim. Po pastaj sekretari i parë i Dibrës kishte vajtur atje dhe tërhoqi tre persona që kemi mbaruar në të njëjtën kohë, unë në mjekësi, Biba në art, Fitim Sula skulptor.

Bibado të shkonte në kinostudio, Fitimi në Lice Artistik dhe unë në fakultetin e mjekësisë.

Na mori Dibra dhe përfundimisht shkua të tre atje.

Më 3 janar 1970 u paraqita në komitetin ekzekutiv të Dibrës dhe fillova punën.

Kemi qenë dy mjekë. Isha mjek i ri, nuk i kisha bërë 22 vjet. Kam gjetur një mjek shumë të mirë Qeram Nurën, një njeri shumë miqësor, shumë shoqëror. Më ndihmoi për të rregulluar fjetjen. Punuam bashkë. Ai kishte punuar i vetëm dhjetë vjet dhe ishte lodhur. Unë kisha vrullin e të riut. Bëra një vite gjysmë aty.

U dha mendimi që të shpërndaheshim për ti shërbyer popullit në zona. Fillimisht më emëruan në Klenjë, pastaj në Ostren dhe më në fund në Shupenzë ku kam punuar shtatëmbëdhjetë vjet.

Më kujtohet një rast kur si mjek i ri dhe më dërguan në Shupenzë. Me pasionin e një të riu fillova punën. Më dhanë një magazinë e cila kishte një bodrum dy kate të thellë të mbushur me kripë. Iu futa punës dhe bëra aty një klinikë të bukur për kohën. E shtrova me mermer, e ndriçova me neon dhe bëra dhe një ujesjellës nga 400-500 m. të gjatë e solla ujë të rrjedhshëm në klinikë, ndërsa në pazarin e Shupenzës shitej ujë me gjyma...

Njeri nga ata që kontribuoi dhe më donte në Shupenzë si mos më keq, i thotë Sali Stafës, aso kohe Sekretar i Parë, në një takim pune që kuadrot kryesorë kryenin çdo mëngjes në zyrën e tij:

"Në Shupenzë janë bërë shpenzime të mëdha dhe gjëra të tepërta, prandaj mendoj ta shohë prokuroria këtë çështjen e klinikës dentare atje".

Saliu, babaxhan ashtu siç ishte, i ishte përgjigjur:

"Po, por a e keni parë, ishte bërë një gjë e bukur atje. Shkoni shikojeni një herë dhe hajdeni e bisedojmë pastaj. Nuk duhet të na shqetësojnë gjerat e bukura, por shkatërrinat që kemi nëpër këmbë."

Më vonë për atë klinikë u botua një shkrim në gazetën "Zëri i Popullit" më datës 8 janar të vitit 1972 me titullin: "Si një kartoline e bukur". Nuk ia harrova kurrë këtë fjalë të mirë edhe pse nuk që një nder personal. E respektova sa që gjallë dhe sa herë më është dhënë rasti, si pacient, si mik, si qytetar. Edhe fakti që po tregoj këtë ndodh kur ai nuk është më, tregon se e respektoj edhe tani, si atëherë kur pinim kafe dhe kënaqesha me rrëfimet e tij.

Në vitin 1982 bëra një specializim në Tiranë. Po e kaloja moshën për specializim. Nuk më kishte planifikuar komiteti ekzekutiv. Shefi i seksionit i kohës dr. Tush Balliu më kishte pyetur përpara në se dëshiron dhe kur rrethi çoi një kandidaturë tjetër, ministria i pyeti nëse keni ndonjë kandidaturë tjetër. Shkoi edhe emri im por që nuk ishte kaluar në komitet dhe kjo më kushtoi shumë më pas. Ministria sapo e mori emrin tim nuk e lëshoi kurrë. Mua erdhën e më gjetën në Okshatinë në aksion duke mbledhë misra. Vajta, drejtori i kuadrit më tha se do të shkosh në specializim dhe se je i pari në grup.

Specializimin e mbarova në fund të vitit 1982 dhe u ktheva përsëri në Dibër. U vërtetua ajo që kisha thënë që unë nuk bëja specializim për të zënë vendin e ndokujt, por specializim për tu kualifikuar. Unë punova edhe pesë vjet të tjerë në Shupenzë.

Nga Shupenza ika krejt rastësisht. Kisha planifikuar të projektoj largimin prej Dibre. Njerëzit e mi kishin ikur që në vitin 1976 në Lezhë dhe unë doja të largohesha nga Dibra. Si duket rashë në sy të autoriteteve të kohës për punën time në gjerësi.

Më thirrën dhe më thanë se kemi menduar të vish në Peshkopi. Mendova se duan të më

Unë jam djalë Dibre...



RRUGËVE TË KURBETIT...

Kështu zgjodha kurbetin,

Më ndihmoi përsëri zanati. Në klinikën universitare ku ishte një shoku im drejtor më mori për tre muaj në një vend bosh dhe atje erdhën e u mjekuan italianë që kishin hapur një fermë në Bestovë të Kavajës. I mjekova. Ata mbetën shumë të kënaqur. Vendosi të më bëjnë një dhuratë dhe unë u kërkova dy viza. Me një biletë që më ndihmoi ime motër për ta prerë, bashkë me një shok tjetër që ishte mekanik në fabrikën e bukës, i hipa tragetit dhe ika në Bari. I panjohur, i pa ditur, për herë të parë. Dija pak më mirë se të tjerët pak italisht. Kisha bërë nja dy gramatika, kisha studiuar në shkollë.

Kurbeti është gjithmonë i vështirë por dita e parë është më e vështirë. Sepse nuk të pret askush. I lodhur dhe i dërmuar ke nevojë të ulti në një vend, të mbështesësh kokën diku. Unë nuk e pata atë mundësi.

Ditën e parë kemi ndenjur tek një bar. Ditën e dytë unë nuk dola më tek bari. Ishte një kurs i gjuhës italiane falas. Shkova në kurs. Kursi ishte gjashtëmuajor dhe profesoresha që ditën e parë më diferencoi madje me shaka u tha "unë nuk do të vij herën tjetër sepse ky shkruaka më mirë se unë".

Bëra për dy muaj kurs të gjuhës italiane. Ndërkohë fillova të kërkoj punë.

Një kolonel që punonte në ministrinë e mbrojtjes në Itali, që ishte shumë kureshtar, në njohjen e parë më tha:

"Kam qenë kureshtar të njoh ndonjë nga Shqipëria sepse si pjesëtar i forcave të NATO-s kam bredhur gjithë botën por në Shqipëri nuk kam qenë".

Më ofroi një punë. Unë bashkë me mekanikun përfundua atje: Punuam, bëmë punën

marrin si mjek. Kështu u bëra shef i seksionit të shëndetësisë. U thashë me sinqeritet se Dibra ka shumë figura, mjekë me eksperiencë por ata thanë se ne e kemi menduar shumë mirë. Ne duam një njeri që e njeh fshatin, traditat, politikën shëndetësore, një njeri me përvojë të gjatë dhe me rezultate të mira.

E quajta nder. Këtë gjë ia tregova vetëm shoqes time, Vjollcës, në mbrëmje. Para se të fillonin proceset demokratike mua mu vlerësua puna, isha edhe anëtar i kolegjiut të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ai seksion i krahasuar me rrethet e tjera pati rezultate. Dhe mua një ditë të bukur mu propozua një vend në Ministrinë e Shëndetësisë. Ishte krijuar një drejtori e re në Ministrinë e Shëndetësisë dhe përfundimisht përfundova kryetar dege, detyrë të cilën e ushtrova më pak se një vit. Filluan proceset demokratike, u bënë zgjedhjet e para, u bënë të dytat dhe më 19 qershor të vitit 1992 kur kisha punuar, puna më ishte vlerësuar, më kishin bërë leje banimi, isha në rrjedhën si çdo kuadër që kishte punuar një jetë të tërë, u ndryshua kabineti dhe ministri i ri që erdhë vendosi ta suprimojë këtë drejtori dhe bëri një listë emërore që mban datën 19 qershor 1992 ku unë isha me numrin rendor NJË dhe hiqesha pse isha anëtar i një partie edhe pse kisha punuar 17 vjet në fshat.

Para meje kisha dy mundësi. Njëra ishte të kthehesha në Dibër dhe unë këtë e kam edhe sot në ëndërr sepse unë jam djalë Dibre dhe jam krenuar me këtë. Çdo gjë në Tiranë është e lidhur me Dibrën, edhe shtëpia, edhe klinika, edhe klientela, edhe miqtë. Çdo gjë është e lidhur me Dibrën por kthimi në Dibër si ndëshkim nuk më pëlqente. Ndërkohë kisha bërë leje banimi, kisha shtëpi. Ime shoqe u hoq nga ai vend pune ku ishte dhe përfundoi në shtëpi. Problemi vajti tek mbijetesa.



■ Unë jam djalë Dibre dhe jam krenuar me këtë. Çdo gjë në Tiranë është e lidhur me Dibrën, edhe shtëpia, edhe klinika, edhe klientela, edhe miqtë...

dhe fituam ca lekë. Pastaj na rekomandoi një punë tjetër ku punuam dy muaj. Na e pëlqyen shumë punën. Morëm ca para. Sigurova ca lekë dhe i çova në shtëpi. Isha shumë i lumtur se po bëja diçka, tu çoj një copë bukë fëmijëve në shtëpi.

Pasi e mora veten fillova të lidhesha me klinikat dhe më në fund gjeta një klinikë, të cilin e kishte mashtruar njëherë një mjek italian. Me origjinë nuk ishte italian por kishte mbetur jetim që 13 vjeç atje. E kishte mashtruar një infermiere bullgare, e cila ishte paraqitur si mjeke. Më kërkoi një mendim për një të sëmurë dhe mendimi që i dhashë atij ishte i suksesshëm. Më ofroi punë.

Nuk më njihej diploma e lartë por ajo e shkollës së mesme. Kishte një marrëveshje ndërshtetërore të cilën unë edhe e dokumentova dhe me këtë u futa në punë. Më pas unë bëja çdo gjë dhe ne plotësonim njeri-tjetrin sepse ai njihte shumë mirë kirurgjinë, kishte bërë mjekësi të përgjithshme. Unë njihja mirë dhëmbin dhe gojën. Kështu kalova afër katër vjet.

Kam ndenjur vetëm. Në atë kohë vështirësia nuk ishte puna. Unë arrita të integrohem mirë. Fëmijët i kishim të vegjël. Vështirësia ishte ndërlidhja. Nuk kishte celularë si sot. Më është dashur natën e Vitit të Ri, ndoshta të vitit 1993, që ti them djalit gëzuar dhe nuk arrita.

Fëmijët e mi janë rritur, janë diplomuar, janë specializuar edhe jashtë. Ime shoqe gjithashtu ka qenë pedagoge. "Jeni një familje katedër"- më tha Elmas Lala. E kam pëlqyer këtë komplement dhe i them faleminderit atij që e kapi i pari.

BASHKË ME DJALIN DHE VAJZËN...

U ktheva. Mund të kisha qëndruar në Itali. U ingranova shumë mirë, gjuhën e kisha mësuar mirë, punoja mirë, zura shumë miq. Ndihej shumë shqiptarët që vinin për herë të parë. Edhe për ndonjë punë, kur kishin ndonjë nevojë. Bëmë atë që duhet të bëjë çdo shqiptar.

Më në fund fillova të mendoj. Bindja ime ishte se të gjithë ato që kishin ndodhur mund të rregulloheshin. Fëmijët ishin në një moshë shumë delikate. Aventurën e bëra kur i kisha kaluar 45 vjet. Isha i mendimit se kur punon mund të bësh një hap të parë.

I dhashë karar të kthehesha. Bleva një klinikë dentare të një italiani dhe të tjera dhe erdha në Tiranë. Në fillim tek poliklinika 10 ku ishte një shoku im i klasës. Ishte karabina, pa dyer e dritare. E ndërtova. Bëra një klinikë modeste 40 metro katrore që ishte shumë e mirë. Punova shumë vjet atje, më se 10 vjet. Pastaj zbrita këtu në qendër.

Kemi marrë një mjedis që duket i bukur kur e sheh por gjëja më e bukur janë njerëzit që punojnë.

Jam i bindur katërcipërisht se po bëj gjënë e duhur. Dikush më ka kritikuar pse i ktheve fëmijët që u specializuan jashtë. Duke qenë bashkë bëjmë gjënë më të mirë.

Vajza ka mbaruar fakultetin këtu dhe ka bërë gati 5 vjet në Bolonjë ku bëri specializim, mas-tër dhe doktoratën që e ka mbrojtur në Shqipëri. Vajza është e martuar me një djalë dibran dhe ka formuar familjen e vet.

Djalin e kam pas në Amerikë. Ka qenë në universitetin e Arcepit, në Konteknikat. Punoi mirë. Jam shumë i kënaqur. U specializua në një degë që këtu nuk e kishim atë mundësi.

Vajza quhet Donika dhe është martuar tek Lazimët në Peshkopi. Djali quhet Ervin Koçi.

Korrik 2016

“Mjeku dhe njeriu shkojnë bashkë. Po nuk qe njeri i mirë, nuk mund të jesh mjek i mirë. Humanizmi është tipari më kryesor në mjekësi.”

Njeriu që mposhti errësirën

Nga XHAFAER MARTINI

Prof. asoc. Ali Tonuzi e kam njohur që në Peshkopë kur ishte mjek okulist. Si shumë dibranë të tjerë ai erdhi në Tiranë kur u krijuan mundësitë për lëvizje të lirë. Por ai nuk erdhi në Tiranë në një punë çfarëdo por si specialist i sëmundjeve të syrit. Pyetja shtrohet kështu: metropoli i kulturës dhe i shkencës, Tirana, ku është grumbulluar ajka e inteligjencës, do ta pranonte Ali Tonuzin, a do të ishte ai në gjendje që të konkurronte me specialistë më të njohur të fushës së okulistikës, apo do të mbetej një mjek i thjeshtë pa emër dhe pa zë, sa për të marrë një rrogë?

Por, përpara se t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje, le të kujtojmë një mjek tjetër të shquar okulist, Prof. dr. Basri Neziri. Shembullin e tij nuk e sjell vetëm për ta krahasuar, por edhe për ta përkujtuar për atë fat të keq që pati nga trajtimi i egër i diktaturës. Kishite mbaruar shkëlqyeshëm Fakultetin e Mjekësisë dhe u specializua për okulistikë; ishte pedagog dhe mjek i aftë, zotëruar i disa gjuhëve të huaja, njeri me kapacitet mendor jo të zakonshëm. Si rezultat i luftës së klasave, e sollën në Peshkopë, por nuk e mbajtën mjek okulist në spital, ku ky shërbim nuk ekzistonte pikërisht pse nuk kishte specialiste degdisën mjek të përgjithshëm në Reç, ku nuk shikon veçse një hektar qiell dhe ku specialiteti i tij nuk hynte fare në punë. Në spitalin e Peshkopisë e prunë mbas tetë vjetësh. Këtu ai ngriti specialitetin e okulistikës dhe bëri sa mundi, tashmë në moshë të thyer dhe me shkëputje të gjatë nga profesioni. Mbas shndërrimeve demokratike edhe ai erdhi në Tiranë, me shpresë për t'u integruar në jetën shkencore të kryeqytetit dhe për t'i hyrë sa më thellë profesionit. Por kur e takova mbas një viti, nuk ishte më ai Basri Neziri optimist, nuk shfaqeshin më tek ai ato shenjat e gjenialitetit që ishin fare të dukshme.

- Na la koha mbrapa, - tha ai me atë sinjeritetin tronditës që e karakterizonte.

- E mo Basri, se me studentët e tu po konkurron, - i thashë.

- E ke fjalën për Ali Tonuzin?

- Për atë dhe të tjerë?

- E ke gabim. Aliu ka ecur shumë përpara. Është djalë i mrekullueshëm.

- Nuk e kam fjalën si njeri, por si mjek.

- Mjeku dhe njeriu shkojnë bashkë. Po nuk qe njeri i mirë, nuk mund të jesh mjek i mirë. Humanizmi është tipari më kryesor në mjekësi.

Unë e Basriu, siç bënim shumë shpesh, e torëm edhe problemin e përhershëm të përputhjes ose të mospërputhjes së jetës dhe personalitetit të njeriut me veprën ose punën e tij. Basriu mbronte idenë se tek mjeku cilësitë morale dhe aftësitë intelektuale dhe shkencore duhet të jenë të përputhshme.

Kanë kaluar vite nga kjo bisedë dhe Basri Neziri nuk jeton më. Unë atij i besoja në gjithçka se ishte njeri shumë i ndershëm që as kritikonte njeri kot, por as nuk lavdëronte atë që nuk e meritonte. Ai gjithçka ta thoshte ndër sy dhe kjo veti ndërsa duhej çmuar si rast i rallë, i bëri shumë armiç.

Tani për t'u përgjigjur pyetjes së fillimit: Ali Tonuzi, ashtu siç pati thënë edhe Basriu, çau përpara përmes shkurnajës dhe pyllnajës së dendur të shkencës mjekësore duke e hapur rrugën me zotësi, talent dhe punë. Nuk e pati të lehtë se edhe ai ia pagoi haraçin e vet provincës ku qëndroi shumë vjet. Çfarë më kishte thënë Basriu për Ali Tonuzin, erdhi rasti që ta provoj vetë dhe ta shikoj me sytë e mi. Është një nga përvojat më të bukura që kam përjetuar kohët e fundit dhe për këtë nuk mund të hesht për shumë arsye, por më kryesorja qëndron në faktin që në këtë Shqipërinë tonë hallemadhe duket sikur nuk ka asnjë shembull pozitiv. Hidhet baltë mbi gjithçka. Titujt e gazetave i zënë shkrimet tronditëse për krime monstruoze ose për politikanë të korruptuar dhe të pamoralshëm.

Prof. asoc. Ali Tonuzin kisha vite e pa e takuar. Kërkesat e shumta dhe të ditpërditshme të njerëzve, të qenurit specialist në një fushë

shumë të rëndësishme të mjekësisë që ka të bëjë me dritën e syrit, vetëdija që njerëzit ta kanë nevojën, mendoja që do ta kishin ndryshuar edhe Aliun, do ta kishin bërë më të rëndë, më autoritar veti këto që shoqërojnë ngjitjen e njeriut në hierarkinë shoqërore. Për nevojën që kisha, kërkova të shkoja tek Ali Tonuzi. Derën e gjeta gjysmë të hapur se ishte orar vizitash dhe njerëzit hynin e dilnin.

- Urdhëroni, profesor? Me se mund t'u shërbej? - më tha sa më.

- Vetë jam mirë, por kam gruan për konsultë.

- Kjo qenka nëna Humë, që e ka derën të hapur tek unë. Ulu të të shikojmë.

Aliu e shikoi me kujdes dhe i tha:

- Ke perde, por tejmase të pjekur. E ke lënë shumë gjatë. Ka pesë vjet që është bërë për t'u operuar. Do të jetë operacioni i vështirë.

- Jam vizituar shpesh për syze tek okulistë të ndryshëm dhe më kanë thënë që perda nuk është pjekur.

- Ata duan të shesin syze.

- Po tani si do të bëhet? - e pyes unë i shqetësuar.

- Ta operojmë, madje shpejt.

- Nuk shtyhet? - pyeta unë duke pasur parasysh vapën e madhe.

- Nuk shtyhet më. Pasnesër ta operojmë.

- Po pare? Sa kushton? - e pyeti im shoqe.

- Çfarë paresh, moj nëna Humë! Asnjë qindarkë. Vetëm do të blejsh lentin. Ajo kushton 23 mijë lekë. Ka në të gjitha farmacitë, bleje ku të duash.

Fëmijët tanë, djali dhe vajzat, donin ta çonin tek spitali amerikan, tek "Hygeja", ku, për të njejtin operacion, kërkonin 500 euro.

Unë nuk do ta bëja kurrë këtë shkrim, nëse do të ishte një rast i veçantë, nëse sjellja, veprimi dhe qëndrimi i Ali Tonuzit bazohej në njohjen dhe respektin ndaj meje dhe sim shoqeje. Me pak fjalë, nëse Ali Tonuzi do ta mbante këtë qëndrim dashamirës vetëm ndaj nesh, nga ana morale nuk do të kisha të drejtë të bëja këtë shkrim. Ali Tonuzi është gojëmbël, i respektueshëm, korrekt me të gjithë ata që paraqiten për probleme okulistike, si dhe me shoqëruarit e tyre. Kështu korrekt, tërheqës, mobilizues dhe pa asnjë mendjemadhësi ai është me gjithë personelin mjekësor. Të gjithë ata që disa ditë më parë kishin bërë konsultën dhe prisnin të hynin në sallë të operacionit, ndiheshin të qetë, be-

Ali Tonuzi është gojëmbël, i respektueshëm, korrekt me të gjithë ata që paraqiten për probleme okulistike, si dhe me shoqëruarit e tyre. Kështu korrekt, tërheqës, mobilizues dhe pa asnjë mendjemadhësi ai është me gjithë personelin mjekësor.



simplot. Ata që dilnin nga operacioni sillnin përvojën e vetë vetjake shumë pozitive dhe frymëzonin me besim dhe shpresë të plotë të tjerët që do të hynin në sallë dhe ata që kishin ardhur për konsultë. Ishte krijuar kudo dhe tek të gjithë një frymë e shëndetshme shprese dhe besimi që rrallë e kam parë në jetë. Dhe këtë frymë nuk e krijoi dhe nuk mund ta krijonte vetëm Ali Tonuzi, por të gjithë ata mjekë të shumtë dhe të përkushtuar ndaj profesionit, gjithë personeli mjekësor aq korrekt dhe i sjellshëm.

Unë nuk do ta shkruaja këtë shkrim sikur në këtë spital mos të më ftonin për një gjë të tillë edhe motive të tjera. E kam fjalën për rregullin, pastërtinë, korrektesën shembullore. Pacientët e okulistikës përgjithësisht janë pleq dhe plaka të rrëguara, që jo vetëm nuk shikojnë (shpesh herë nga të dy sytë) por shumica prej tyre as nuk dëgjojnë. Vinë edhe nga zona shumë të thella të Shqipërisë; disa herë nuk ua kupton edhe dialektin. Pleqëria të thyen nga të gjitha anët. Atyre ishte vështirë t'u shpjegosh një gjë, por doktor Aliu këtë e bënte me durim dhe këmbëngulje, pa u mërzhitur. Nga këto pleq dhe plaka që mund të ndjejnë neveri fëmijët e tyre që u kanë bërë kokat, nuk provonin ndjenja të tilla

Ali Tonuzi dhe kolegët e tij. Përkundrazi, ato ishin mëshirëdhënës dhe altruistë me secilin prej tyre. Kjo mua më bëri përshtypje të veçantë. Nuk mund të ngrihesh në këtë lartësi shpirtërore pa të rënë drita hyjnore. Tani Krishti dhe Muhamedi dërgojnë apostujt të tjerë në tokë për t'u lidhur me njerëzit. Ne shpesh i kemi midis nesh dhe nuk i njohim dhe nuk i dimë.

Unë mora shkas nga Ali Tonuzi për ta bërë këtë shkrim, por shkrimi u takon të gjithë atyre njerëzve që punojnë atje, prej tek pastrueset, portieri e deri tek mjekët duarartë.

Por, pavarësisht nga atmosfera e ngrohtë dhe miqësore, dita e operimit, si për pacientët ashtu edhe për shoqëruarit e tyre, ka emocionet e veta se kurrë nuk dihet ku fshihet e keqja. Nuk operonte vetëm Ali Tonuzi, por edhe shumë mjekë të tjerë. Dhomat e pastra, me çarçafë që ndrisnin nga bardhësia, ishin mbushur plot me pleq dhe plaka që dilnin nga operimi dhe pushonin aty disa orë. Të tjerë prisnin radhën për t'u operuar. Ali Tonuzi atë ditë kishte shumë pacientë për t'i operuar. Dikush nga shoqëruarit tha se doktori mund të lodhej dhe ata të fundit mund të mos kishin gjithë përkushtimin dhe kujdesin si ata të fillimit. Një nga kolegët e Aliut që i dëgjoj këto fjalë rastësisht duke kaluar, qeshi me naivitetin e atij që foli, dhe tha:

Ali Tonuzi është specializuar dhe ka punuar tri vjet në Indi. Atje nuk operonte kaq sa shikoni ju këtu, por njëqind herë më shumë. Popullsia atje është e jashtëzakonshme për nga numri dhe mjekë ka pak. Në ka një mjek që e ka kalitur dorën dhe vullnetin me operacione ky është Ali Tonuzi.

Por, në fund të fundit, të gjitha fjalët e mira i merr lumi po doli operacioni pa sukses. Dhe e keqja është që vetëm një moskuses merr me vete një mijë suksese të tjera. Por, kur ime shoqe hoqi fashon për të bërë mjekimin, tha se shikonte më mirë se me syrin tjetër. Pas tri ditësh u takuam edhe një herë të gjithë të operuarit e asaj dite, për të bërë konsultë me mjekun. Të gjithë ishin të gëzuar se shikimi u kishte ardhur plotësisht. Prandaj Ali Tonuzin dhe kolegët e tij e meritojnë t'i quajsh "Njerëzit që mposhtin errësirën!"

Pas tri ditësh u takuam edhe një herë të gjithë të operuarit e asaj dite, për të bërë konsultë me mjekun. Të gjithë ishin të gëzuar se shikimi u kishte ardhur plotësisht. Prandaj Ali Tonuzin dhe kolegët e tij e meritojnë t'i quajsh "Njerëzit që mposhtin errësirën!"



Misioni për të shkruar historinë e një krahine, është mjaft i vështirë, kur mbi atë nuk janë hedhur penela historike, serioze, konkrete e të argumentuara nëpërmjet dëshmimeve si dokumenteve, gjetjeve arkeologjike, kronikave të kohës, opinioneve të shkruesve apo dëshmitarëve të ngjarjeve, toponomistikës e onomistikës etj.

vendlindja



Nga SELMAN MËZIU

(Vijon nga numri i kaluar)

SI TË ZBARDHEN RRËNJËT HISTORIKE?

Misioni për të shkruar historinë e një krahine, është mjaft i vështirë, kur mbi atë nuk janë hedhur penela historike, serioze, konkrete e të argumentuara nëpërmjet dëshmimeve si dokumenteve, gjetjeve arkeologjike, kronikave të kohës, opinioneve të shkruesve apo dëshmitarëve të ngjarjeve, toponomistikës e onomistikës etj.

1- Relike të neolitit të mesëm

Për të vërtetuar nëse një dëshmi historike apo gjetje arkeologjike ka vërtetësi, duhet të ballafaqosh informacionet, të dhënat historike shkruara, të ndjekësh me kujdes gjurmët që të çojnë në gjetjen reale, dhe kohën e saktë të ngjarjes historike. Kjo për arsye se historia është matematika e jetës njerëzore, por jo e shprehur me numra, por me objekte konkrete, dëshmi e dokumente të shkruara etj. Dhe ja fillojmë:

"Kështu nxënësi i shkollës 8-vjeçare të Shumbatit Fadil Mëziu, gjeti një sopat guri të latuar... Ajo është ekzemplar i rrallë i sopatave të gurta (një e tillë gjetur dhe në Muhurr tek Kodra e Rame) dhe dëshmon për praninë e vendbanimeve prehistorike të periudhës së neolitit (6500-2500 vjet para krishtit) në këtë zonë..." (A. Bunguri Arkeol. "Popull. dhe disipl. arkeol." Ush. e Maleve, f. 3, 23. IV 1983)

Më poshtë po japim një tjetër dëshmitar:

Ndërsa: "Sopat guri tip gjuhe gjetur në shpellën e Gurit të Kuq në Muhurr nga inxhinieri Mustafa Seferi dhe ruajtur nën kujdesin e tij, dorëzuar në muzeun e Peshkopisë. Sopata ka një kanal (të thelluar përsëgjati)." (I. Kaca, "Dibra në faqet e një ditari ark." f.50 Tiranë 2012)

"Një çekiç guri i latuar dhe i vrimuar i gjetur në kodrën e Ballës të fshatit Fushë - Muhurr (Kodra pranë urës mbi Dri ana e majtë), një sopatë guri e latuar gjetur në shpellën e Gurit të Kuq (miniera e Mermerit) në fshatin Muhurr, shpellë e cila ndodhet mu në hyrje të grykës së Murrës në rrugën drejt Selishtës, një majë heshte prej hekuri e gjetur në qytezën e Hurdhë Muhurrit e datuar në periudhën e hekurit. (A. Bunguri, Armët... f. 67- 73) (I. Kaca, Rrugët e vjetra të Dibrës f. 152, Tiranë 2003)

Çekiçi prej guri "Në katundin Fushë- Muhërr të lokalitetit Muhërr në vendin e quajtur Kodra e Balle u gjet një çekan guri." (H. Sadiku, Kontr. Për Hartën arkeol. Të rreth. të Dibrës në Buletin arkeol. f.221 Tiranë 1971)

"Çekiç guri i latuar i gjetur gjatë hapjes së themeleve të shtëpisë së fshatarit Sali Mikli nga Muhurri në vitin 1970 dhe sjellur në M.H.P nga studiuesi H. Sadiku. Është punuar me shumë kujdes, në veçanti vrima për futjen e bishtit... Çekani është i gjatë 8 cm. Vrima ka diametër 2.2cm." (I. Kaca "Dibra në faqet e një dit.ark." f. 50, Tirane 2012)

I njëjti fakt i përsëritur: "Në fshatin Fushe - Muhurr, në shtëpinë e fshatarit Sali Mikli, është gjetur një çekan guri i latuar i vrimuar (fig.41) Tab. XII, 17) si dhe një sopatë gurie latuar në shpellën e Gurit të Kuq (fig 42) (Tab.XII, 13) (I. Kaca po aty f. 77)

M U H U R R I

Vështrim ekonomik, historik dhe etnokulturor

Duke lexuar shkrimet e arkeologeve mund të gjykojmë:

1- Sopata prej guri nuk është gjetur në Kodër të Rame, por në gurin e Kuq. Por aty duhet plotësuar se ajo është gjetur në shpellën Zgjorgj buzë ish rrugës këmbësore që kalonte bregut të lumit Murra e cila lidhte Muhurrit me Selishtën. Por nga asnjëri nuk jepet të paktën viti. Dhe më tej kërkohet të dihet: Si u gjet ky objekt me rëndësi të madhe arkeologjike? Cila është udha e tij deri në Muzeun e Peshkopisë?

2- Çekiçi prej guri na jepet me dy vend gjetje: Një variant në Kodrën e Balle tjetri tek shtëpia e Sali Miklit. Natyrshëm lindin pyetjet: Kemi të bëjmë me dy të tillë apo me një objekt arkeologjik? Gjithashtu Kodra e Balle nuk është mbi Dri në të majtë, se ajo quhet kodra e Shën e Diellit. Ajo ndodhet në një kodër mbi Urën e Murrës që quhet ura e Çikut në të majtë ose mbi shtëpitë e fisit Kurte, Preçe, e shtëpisë së Deme Ballës.

Kjo kodër është mjaft strategjike, jo vetëm si lartësi, si sipërfaqe e formë por edhe si pozicion ku mund të vështrosh gati gjithë Dibrën e poshtme e të kontrollosh rrugët që lidhin këtë krahinë me Katër Gryket dhe Kalanë e Stelushit.

2- Qyteza e vendbanime

Dhe ja se çfarë shkruhet për një kodër tjetër:

"Qyteza e Hurdhë - Muhurrit (Kom. Muhurr). Rreth 300-400 m në juglindje të fshatit Hurdhë - Muhurr, ndodhet një kodër që quhet Qytezë.Qyteza duhet të ketë vazhduar edhe në periudhën mesjetare, sepse fare pranë saj në anën lindore ndodhet vendbanimi mesjetar Mazrekat, që lidhen edhe me Kastriotët dhe Skënderbeun." (I. Kaca, "Di. në faqet e një dit. ark." f. 77 Tiranë 2012)

Dhe më tej për të njëjtën qytezë: "...Përveç gjurmëve të periudhës së metaleve (1200-800 vjetp.k S.M.) ka ofruar edhe gjurmë të shekujve IV-VI pas Krishtit. Dy fragmente enësh ruajnë gjurmë të teknikës dekorative të krehëzimit..." (I.Kaca po aty f.201)

Dhe ja vend banime historike të tjera në krahinën e Muhurrit që e pasurojnë atë më tej dhëshprehin lashtësinë e saj deri në periudhën e metaleve:

"...Qyteza e Hurdhë Muhurrit (Hurdhë-Muhurr), Kisha e Malit të Shën Mërisë, Vakufi i Bulaçit (Hurdhë - Muhurr); Kalivaç (Vendbanim); Varri monumental Vai - Mëdhej (Ndërtim i shekullit të IV-VI era e re)." (A. Bunguri Kujtesë arkeologjike Ush. eMaleve f. 4: 16.IV. 1987) "Një numër emrash, vendesh ose fshatrash në trevën e Dibrës janë me origjinë ilire si Laçes, Terbaç, Kalivaç." (M. Trepça. Toponime dhe arkeologu. Kumtesë e mbajtur në sesionin e parë arkeologjik.

Peshkopi 5.12. 1984) Deshat, Dardhe," (I. Kaca. "Rrugët e vjetra të Dibrës." f.26, Tiranë 2003)

Dhe me tej lexojmë:

"Në të djathtë të Drinit ndodhen rrënojat e këtyre kështjellave: Gradishtia e Vojnikës.... kurse në të majtë të tij ndodhen: Kalaja e Homeshit, Qyteza e Hoteshit, Qyteza e Hurdhë Muhurrit...." (I. Kaca, " Fisi ilir i penestëve." Ush. e Maleve" f.4 10.12 1983)

Më poshtë në këtë artikull shkruhet: "Një problem që duhet t'i japin përgjigje arkeologët, historianët dhe gjuhëtarët tanë, është se cilat ishin emrat e këtyre 11 kështjellave antike dhe me rrënojat e cilave duhen indentifikuar?" (Po aty.)

Sot ky vend thirret Xhutezë. Ndërsa të dhëna të tjera kemi se diku në shpatin jugor ka qenë një shpellë në mesin e shpatit me gurë gëlqeror, e cila lidhte qytezën, pra shërbente si komunikim i nëndheshëm, për furnizime të fshehta me ushqime apo në raste rrethimesh mund të largoheshin banorët e të futeshin në pyje. Toponimet që kemi aty rreth e qark janë, Qafa e Shën e Lleshe (Aleksandrit), Ara e Vilës, e Shën Mërisë (Maris), Kurrizi Kokërdhokut, Lajthia e Trashe ku në vitin 1967 dhe në vazhdim në rrafshin e këtij vendi ka patur mjaft gurë të gdhendur, shqema dyersh e dritaresh, qoshe me gdhendje etj. dhe një Gur Mokërre, me ngjyrë të kuqe që është transportuar tek mulliri i Ballazhe në vendbaskimin e Prrorit të Shishave dhe përroit të Shqathit.

Shpella e Radit ndodhet në shkëmbinj të mermert natyror por jo shumë e thellë, dhe ja se çfarë shkruan arkeologu dhe historiani Iliaz Kaca: "...Shpella ka një sipërfaqe të vogël prej pak metrash katërore, e sheshtë dhe e përshtatshme për banim. Në këto gjetje përmendim një buzë vorbe, që në anën e brendshme ka një kanal të lehte për vendosje kapaku....një bark ene me pesë vija qarkuese... ..E krahasuar me qeramiken me pika të tjera ajo i përket periudhës së vonë antike (650-450 vjet p.k. S.M.) e mesjetare (Shek V-XV pas krishtit S.M.)....por diçka edhe më e hershme, ndoshta dhe prehistorisë." (I. Kaca, po aty f. 201)

Në vitin 1910 po sipas autorit të mësipërm këtu është strehuar patrioti luftëtar dibranë Isuf bej Karasani nga patrioti muhurrak Ramadan Leka. Ajo ka mbetur ashtu e pa përshkruar më tej, e pa plotësuar me të dhëna toponomistike etj.

Ndërsa Mazrekat si vendbanim i familjes së madhe princërore, e kanë përcaktuar mjaft autor, por ne do të përmendim historianin Besnik Këbej i cili e ka përshkruar dhe ka hedhur teza të reja mbi Pal Mazrekun që ende në këtë krahinë ka mjaft gojëdhëna duke shprehur edhe lidhje me fisin Gjini të Kastriotit.

Dhe ja se çfarë shkruhet nga një burim tjetër: " Në lindje të fshatit Hurdhë - Muhurr, në anën lindore të Qytezës së Hurdhë -Muhurrit ndodhet një vend që quhet Mazreka....janë gjetur fragmente tjegullash solene, me trashësi të pllakës 2-3 cm dhe që ruajnë gjurmë vijash të hequra me gisht..." (I. Kaca po aty f.200)

Pas largimit të familjes së Mazrekaseve, në këtë vend u vendosën garnizonet turke. Kemi mjaft toponime me interes dhe me domethënie të cilat shërbejnë, për të gërmuar mbi historinë e tyre si: Shisha e Vogla, Shisha e Madhe, Qafa e Dardhës ku akoma edhe sot ka një dardhë të egër, Kurrizi nga Maja e Sukës në qafën e Dardhës e vazhdon me majën e Vakufit e zbrit në formë V në Kodrën e Rreskave ku pas saj kemi Arën e Robit. Ara e Kurte në të dy anët me kurrize ku duhet të kenë qenë shtëpitë e familjeve që iu shërbenin familjes së Mazrekaseve ku gjenden edhe dy varre mbi rrugën që bashkon Arën e Kurte të Vogël me Mazrekën e poshtme. Pastaj kemi toponimet, Rrahanajt, Përroi i Mazrekave, Krizat e ononimi Perroi i Krizave, Gjuri i Shqipës etj.

Vazhdojmë me vendbanime të tjera si: Çukat e Epra: "Rreth 3 km në perëndim të Fushë Muhurrit, ndodhen Çukat e epra, një vendbanim mesjetar i braktisur. Duken gjurmë të zbehta muresh të banesave, fragmente enësh prej qeramike tepër fragmentare, një buzë vorbe dhe një fund i sheshtë. Duhet të jetë Fushë Muhurri mesjetar(shek V-XV era e re S.M.) i braktisur dhe konkretisht Lagjia e madhe Çurkaj e Fushë Muhurrit të sotëm." (I.Kaca po aty f.200) Ngjitur me ato kemi toponimin Ferra e Xhanit, ara e Mihirit, Arat e shmetrave ku kemi gjurmë e kishës së Shën Dhimitrit. Nga emri i së cilës ka mbetur i tjetërsuar toponimi kishtar mesjetar.

Dhe më poshtë vazhdojmë:

Gardhi i Poshtëm.(Kom. Muhurr):"Rreth 2 km në veriperëndim të Fushë Muhurrit, ndodhet Gardhi i Poshtëm. Gjurmët e banimit janë të pakta, ndonjë banesë tepër e rrafshuar dhe fragmente tjegullash solene."(I. Kacapo aty, f.200)

Ky vendbanim është në Kodrën e Mozës (e Mizit sipas regjistrat turk të vitit 1467 përkthyer nga Ali Hoxha, Gjoni i Mizit) ku plotëson kushte vendbanimi, si kodër e ngritur me një rrafshinë strategjike dhe përshtatshme, ku në regjistrin turk të vitit 1467 përmenden disa familje. Matan përroit kemi vendin e quajtur Vneshtat, Toponimin e një kodre, Reçi, me pusin dhe varret poshtë tij në krahun verior (mbiemër familjeje i shkruar në regjistrin turk të vitit 1467), ndërsa në anën jugore poshtë kësaj kodre të ngritur kemi Bushenin.

Dhe ngjitemi buzë Runjës ku kemi gjetur këtë shkrim të Arkeologut Iliaz Kaca:

Kisha e Malit të Shmrajs (Komuna Muhurr): "Në jugë lindje të fshatit Shqath ndodhet mali i Shën Mërisë. Në pikën më të lart të këtij mali në lartësinë 1163 m ndodhen rrënojat e një kisha, e cila quhet kisha e Malit të Shën Mëris. Muret..... ndërtuar me gurë...Qoshet janë me gurë shtufi të punuar. Gurët janë me llaç gëlqereje. Në anën lindore ndodhet muri i kullës së këmbanës së kishës." (I. Kaca po aty. f. 200)

Këtu kemi gjetur një shqem dere prej guri te latuar (Gjetur gusht 2006). Dy sheshe që përdorshin për ceremonira, një mur që ndjek kurrizin e malit, nga pika më e lartë përgjatë rreth 150 metra. Në pjesën lindore kemi gjetur Shpellën e Zojës së Shën Marisë, siç e thërresin banorët e këtyre anëve.

Në vitin 1986 në shtatin veri - perëndimor të përroit të shehut, ku ndodhen një grumbull arrash në vitin 1986 u gjetën shenjat e një varri. Gjip Pira ia bën të ditur arkeologut dibran Profesor Adem Bungurit, i cili menjëherë filloi gërmimet arkeologjike dhe më pas në një artikull të shkruar mbi atë ndër të tjera thëkson: "Ndodhej në veri të fshatit Vajmëdhej, në krahun e majtë të Drinit të Zi dhe përroit të Shehut, në vendin e quajtur "Kodrat e Rencit", afër Zall-Sinës. Varri ishte i tipit me një ambient, me planimetri katërkëndëshe dhe qemer cilindrik të ndërtuar me tullë. Përbëhet nga dhoma e varimit dhe hyrja e varrit ." (A. Bunguri, Varre monumentale në Dibrë (Monumentet 2008, f. 117-134)

Varri sipas studiesit i "përket shekullit të V-VI pas Krishtit" ndërsa në gërmimet e mëtejshme ai zbuloi disa gjetje të ndryshme ku arrin në konkluzionin se "ai është përdorur edhe në periudhën e vonë antike" dhe "shprehin shtrirjen e kulturës së Komanit edhe në trevën dibrane." Fatkeqësisht ky monument i një rëndësie shumë të madhe historike për krahinën e Muhurrit është shkatërruar.

Një gjetje arkeologjike me rëndësi shumë të madhe është ajo e një shigjete. Ja si trajtohet gjetja e saj: "...një majë heshte prej hekuri gjetur në Qytezën e Hurdhe Muhurrit e datuar në periudhën e hekurit (1200- 800 vjet p.k. S.M.)..." (I.Kaca "Rrugët e vjetra te Dibrës" f. 152 Tiranë 2003) Autori i mësipërm i referohet një burimi, A. Bunguri, Armët... f. 67- 73. Une e shfletova këtë material ku trajtonte armë të tilla, por fatkeqësisht nuk gjeta frazën e përdorur. Ne bisedën me Kapllan Qokën me datën 20. 08. 2013 më tregoi: "Në vitin 1964-1965 kam gjetur një shigjetë, ndoshta m ebisht druri, dhe maj ishte e gjatë rret 50 cm. Ku ia tregova dhe ia dhashë mësuesit Xhemal Berisha, ku ai e dorzoi në Muzeun e Peshkopisë, se tha ka vlera të mëdha historike." Natyrshëm lindi pyetjet: Historiani dhe arkeologu Iliaz Kaca mos ndoshta ka shfrytëzuar këtë gjetje te bashkëfshatarit tim? Apo kemi një gjetje tjetër shigjete dhe ka gabuar referimin bibliografik?

Në të vazhdim bisede ma zotin Qoka, një intelektual me shumë kulturë e me kujtë të rrallë, tregon: "Në përroit që vjen pas shtëpisë se Xhelal Metës ne Sheher të Vajmdeheve, kam gjetur një cope tjegull me një vulë romake, po shkoja në Sinë të Epër ku shërbeja si mësues..."

Një dëshmi me rëndësi të madhe, por që fatkeqësisht tani nuk dihet ku ka përfunduar, por që dëshmon për gjurmët e sundimit romak edhe në këtë krahinë.

Një gjetje e rastësishme për periudhën e Gjergj Kastriotit, ka qenë ajo tek Ara e Bushit, Mëzest e Epër, në vitin 1976. Kur po hapnin toka të reja u gjetën: "... një kuti prej bronzi ku brenda kishte një çekiç bronxi, një kup e tillë sa një tavëll duhani dhe një stemë e Skënderbeut..." (Bisedë me Suzana Meziu (Hoxha) më 11.08.2007) Pas disa provash gjetëm stemën që përmbushte kushtet në memorien e deklaruës në atë ishte figura e heroit tonë kombëtar ku shkruhej DVX EPIRI ALB. SCANDEBERGUS. Vlerat historike të kësaj gjetje arkeologjike te rastësishme, janë pjesëmarrja e kësaj treve në luftërat e shekullit të XV dhe shejtëria dhe madhështia e heroit tonë kombëtar iu kërkoi banorëve të fisit Mëziu ta ruanin nga terrori turk stemën e tyre me gjithë kuti në tokë pranë një lisi shekullor.

Dëshmi i luftës kundër Serbit në vitin 1920 në Rrafshen e Merke, ka mbetur një kazangjelle marrë serbëve gjatë luftimeve të përgjakshme të muhurrakëve, të udhëhequr nga Dine Hoxha e Ramadan Leka, i cili ruhet në shtëpinë e Skënder Lekës.



Kronika e zbulimeve arkeologjike të kryera nga historianët e arkeologët apo gjetjet e rastësishme shprehin më se miri, lashtësinë e popullsisë së krahinës së Muhurrit dhe dallgëzimet historike që kaluan mbi këtë trevë.

LUFTRAT E LUFTËTARËT NË KOHËRA

Nuk mundemi kurrën e kurrës të hedhim historinë e një krahine në një studim që duam ta futim në kornizat e një artikulli, prandaj do ti japim disa ngjarje kulmore shkurt dhe pa argumentime apo detaje.

Familja e Berishe ndër shekuj është shquar për heroizma, zgjuarsi e diplomaci, por që ka mbetur e pa dritësuar, e virgjër, e mbuluar me pluhurin e harresës. Ne po japim disa fragmente: "Ndërmjet më fisnikeve të tjerë të at vendi dhe kryetrimave të rinisë ishin dy vëllezër nga familja e lashtë e Berishëve, ndihmën e të cilëve Skënderbeu e kishte të shënuar e të dendur." (M.Barleti, Historia e Skënderbeut. f. 314. Tiranë 2005)

Në betejën e prillit të vitit 1465 u kapen rob nga ushtria turke në Valikardh të Bulqizës, tetë gjeneral të Skënderbeut si Moisiu i Dibrës, Gjuriç Vladi, Muzaka i Angjelinës, Gjini Muzaka, Gjon Perlati, **Nikoll Berisha**, Gjergj Kuka dhe Gjini Maneshi të cilët "Mehmeti nuk desh as t'i dorzonte me ar, as t'i ndërroste me robër, por, pasi nuk la mizori e turp pa bërë kundër tyre, urdhëroi, sipas zakonit të tij, që të ripeshin të gjallë." (M.Barleti, Historia...f. 448). Pra krahina e Muhurrit ka heroin e parë, një gjeneral të paepur e legjendar, të saj në shekullin e XV Nikoll Berishën.

Dhe ja një tjetër figurë historike: Gjip Pira, njeri i zgjuar, punëtor, diplomat, luftëtar i zjarrtë i cili jetoi rreth viteve 1700-1800. Origjina, Mirdita, një pikëpamje tjetër nga Shkodra. I ati i tij, Korbi banoi në Grishqan. Pastaj ai vetë ngjitet në lagjen Shorokan. E vretpabesisht tek ura e Topojanit, Sali Kraja.

Një lëvizje tjetër për të mos paguar taksat është ajo e vitit 1714, dhe ja lexojmë: "Ata kundërshtuan pagimin e taksës së xhizës. Kryengritja u përhap në Çidhën, Muhurr, Qafë-Murrë e në Selisht." (R. Sinani, Dibra dhe dibranët ne faqet e historisë.f. 45. Tiranë 2005).

Dibra në kryengritjen e vitit 1836, e cila kundërshtoi emërimin e Sulejman Beut, Myrteselim i Dibrës. Dhe ja sesi shkruhet në një dokument të 14 janarit 1836: "... qeveritari i Dibrës mori garanci që kryepleqtë e Çidhnës, Muhurrit, Luznisë.....me të cilët zotoheshin se nuk do të lejonin kryengritje në këtë krahinë" (Po aty. f. 59)

Trimi Nezir Lleshi nga Bulaçi krahas dibranëve të tjerë, shkon në ndihmë të Ali Pashë Tepelenës në vitet 1820-1821. Ndërkohe krahas dibraneve të tjerë për të mbrojtur trojet e tyre, trevën Dibrane ishte edhe Isuf Pira nga Muhurri gjyshi i Selmanit.

Në luftën e Gjoricës në Korrik 1844, mori pjesë Nel Hoxha me disa muhurrak. Të tjerët nuk pranuan si rrjedhojë e mosmarrëveshjes të feudalëve Karahasni me Abaz Pirën. "Forcat (mercenare) e Pashe Sakatit të Zogollit përparuan drejtë Luznisë e Muhurrit të ndara në dy pjesë." (H. Ndreu, Dibra në udhën e historisë. f. 127. Tiranë 2003) Ndërsa në luftën kundër hordhive turke me Demir Pashën në Brestin e Epër, po citojmë vargjet e këngës: "T'çojme e t'hrasim Hazis Nelin (Hazis

Hoxha i pari i Muhurrit. S.M.), Hazis Neli një plak i ri, Mbledh miletin e bien'Dri. Shumë të vra e të plague, iku pashai mbarrue..." (Po aty, f.160) Dhe: "Demir Pasha në krye të ushtrisë, kaloi Drinin dhe doli në Muhurr, për të shtypur kryengritjen e zonës malore. Dibranët si ortek, sulmuan me shpejtësi armikun dhe e detyruan atë të tërhiqet në krahun lindor të Drinit." (R. Sinani, Dibra...f.78)

Në luftën e Gjoricës në prill 1909 mori pjesë edhe Kurt Hoxha më Muhurrakët. Në mbledhjen e Nande Maleve të Dibrës tek Gurra e Mazhicës, krahas krerëve të ndryshëm të kësaj krahine morën pjesë edhe Tahir Abazi (Pira. S-M) e Kurt Hoxha. Në prill të vitit 1910 sulmohen garnizonet e ushtrisë turke në luginën e Drinit dhe të kodra e Prusës mbi Rodovesh. Në të cilën morën pjesë, "... luftëtarët e fshatrave të Grykës së Vogël, Grykës së Madhe, Luznisë, Muhurrit dhe Reç e Dardhë..." (R. Sinani, Dibra..., f.130.)

Fronti kundër ushtrisë serbe në korrik 1912 nga Ura e Spiles e deri tek ura e Dodës, forcat kryengritëse u vendosen në Hotes, Topojan, Luzni, Muhurr, Arras etj. Në dhjetor 1912 ushtria Serbe vendosi të shtrij pushtimin në zonat malore duke i përqendruar forcat në Prat dhe lartësinë Gjurasit për të mbajtur nën sundim Grykën e Vogël, Luzninë, Muhurrit e Selishtën.

Më 19 nëntor 1912 në betejën e përgjakshme të Qafës së Kolosianit morën pjesë edhe muhurrakët nën drejtimin e Kurt Hoxhë. Forcat Dibrane shkuan në ndihmë të Shkodranëve "me në krye Selman Alin e Llan Kaloshin." (H. Pernezha, Krahina e Çidhnës. f.106 Tirane 2013). Më 9 shkurt 1913 u zhvillua beteja më e përgjakshme, më frontalja dhe më heroikja, ku spikati qendresa stoike e dibranëve. "Në mes të muhurrakëve pjesëmarrës në këtë luftë nga Shorokani (Shqathi S. M) ishte edhe një burrë në gjysmë të moshës." (H. Pernezha, Krahina...f.108) Një plumb e godet për vdekje shqathjanin, por për çudi, ai mbeti në këmbë me pushkën shtrënguar fort. Ai ra shahit në llogoret e luftës së Berdices. Një stoizëm, një shëmbëlltëri e dinamizmit të qëndresës, një dukuri njerëzore që ndodh vetëm në legjenda. Por kjo është e dokumentuar.

Ushtria serbe në mesin e janarit 1913 pushtoi gjithë Dibrën dhe ja si shkruan Haki Stërmilli, në malësi "zhdukeshin njerëzit të cilët gjendeshim më vonë në breg të Drinit të shpuem keqas prej bajonetave". Krimet e llahtarshme në Muhurr, ja kush janë: "Bënë rrëmbujt të fshatit. Dogjën 14 shtëpi; rrëmbuen herën e parë: 200 dhen, 100 dhi, 30 lopë dhe 15 kuaj; muarën mbi 300 lira turke duke rrjepur gjindjen e fshatit, në herën e dytë muarën 10 dele, 10 dhi dhe 1 kalë, ndër të vrarët me bajoneta jane: Hajradin Demiri, Sulejman Halili, Beqir Xhaferri, Ymer Sulejmani, Mahmut Abazi, Hysein Dervishi, Bajram Dervishi, Islam Dervishi, Xhafer Ismaili, Halil Ismaili etj. (Revista. Kalendari Kombiar 1914. f. 82-83; Sofje 1914) Natyrshëm lindi pyetjet: Cilët janë mbiemrat dhe moshja e gjithësecilit? Cilët janë të pa rregjistruarit në këtë statistik, por që ushtarët serb i masakruan? Cilat janë lagjet e krahinës së Muhurrit që u gjakosën e grabitën nga ushtria gjakatare, banditeske serbe?

Një tjetër ngjarje me rëndësi të madhe. "Në mëngjesin e 19 shtatorit 1913 forcat e Dibrës së Poshtme luftonin për të kapur lartësitë e

Gjarecës, Ostushit e të Shkerkës në krahun lindor të Drinit." (R. Sinani Dibra... f. 159)

Një tjetër pushtues iri shkel mbi Dibrën, dhe ja: "Ushtria austro hungareze hyri në Bulqizë në mars të vitit 1916 dhe e shtriu pushimin në krahun perëndimor të Drinit të Zi." (R.Sinani, Dibra...f. 169) Pra edhe krahina e Muhurrit pushtohet nga ky armik i ri.

Në javën e parë të muajt gusht, serbët qëlluan me artileri Luzninë, Tërnovën etj"...dhe mund të kapnin Kodrën e Mollës dhe Rrafshën e Myrkajve." (R. Sinani, Dibra... f. 176). Dhe më tej, ja si zhvillohen ngjarjet: "Dibranët filluan sulmin për rimarrjen e Rrafshës se Myrkaje dhe (13 gusht 1920 S. M), pas një lufte prej 14 orësh deri në ndeshjen trup me trup e detyruan armikun të tërhiqet në krahun tjetër të Drinit të Zi." (Po aty f.176) U shquan për trimëri muhurrakët, Liman Xhani, Hysen Mani, Ramadan Leka etj.

Dhe le të lexojmë se si u zhvilluan ngjarjet më 16 gusht 1920 në disa vende strategjike: "Marrja e lartësisë së Ostushit krijoi mundësi për manovrim e dalje në shpinë të armikut, që përpigje t'i që- ndronte sulmit të muhurrakëve në Pasmarr enë Gjericë. Muhurrakët pas manovrës kraharrëse, që bënë në krahë të majtë të armikut, iu ngitën kodrës së Gjericës me shpejtësi." (R. Sinani, Dibra...f. 180)

Më 26 tetor 1920 kemi një ngjarje tjetër ku: "Në fshatin Rreth Kale, Taf Kaziu kishte grumbulluar 1000 forca mercenare dhe serbe dhe nisi sulmin në drejtim të Muhurrit. Forcat jogusllave arritën të zënë Kodër Leshën dhe pushtuan fshatrat Muhurr, Bulaç, Vajmdehej, Arras...; (Bajram Xhafa, Lufta e Dibrës më 1920, f. 207, Shkodër 2001)

Kronikat e luftës në këto vite përbëjnë gjerdanin e heroizmit dibranë, sakrificat e mëdha që ato bënë, qëndresën e pashembullt dhe shpirtin heroik që manifestuan në çdo pëllëmbë të kësaj toke të përgjakun nga bijtë e vetë. Dhe vazhdojnë përsëri sulmet e egra serbe dhe kësaj radhe edhe ruse, lexojmë: "Në mars të vitit 1921 forcat serbe mes të cilëve, gjendeshin edhe ushtarë rusë të Vragjelit, pushtuan Arrasin dhe Muhurrit, por dibranët, përsëri i goditën dhe i detyruan të kalojnë në krahun e djathtë të Drinit të zi. Forcat ushtarake serbe u vendosën në kodat e Gjericës, Pasmarrit, Ostushit dhe në Laçaj." (Po aty f. 184)

Dibra ziente nga përvëlimet e një lufte të egër, kundër një armiku të organizuar e të armatosur modern dhe përsëri: "Me 27 tetor 1921 ushtria serbe goditi me artileri dhe, pastaj, u hodh në sulm të përgjithshëm. Si rezultat forcat serbe, sëbashku me ato mercenare morën kodrën e Mollës në Muhurr dhe vazhduan lëvizjen në drejtim: Muhurr-Selishtë- Qafë Murre..." (Po aty f.189)

Shkurt disa të rënë në beteja të ndryshme në luftën me serbin në Shkodër dhe Lezhë (Kakariq) 1912- 1913, bie heroikisht Taf Llan Dashi (...) Në Qafën e Kolosianit nëntor 1912 bie heroikisht Sahit Fer Rina. Në betejën e Grykës së vogël 22 shtator 1913 bie në fushën e betejës Beqir Xhafer Meta Vajmdehej, Hysen Dervish Bushi, Bulaç, në Vllanicë vritet Sulë Met Sula. Dhe një tjetër dëshmi e heroizmit Muhurrak: "Edhe në këtë betejë (Plave-Gucise) Mustaf Mëziu bëri emër si trim e atdhetar sëbashku me luftëtarë të tjerë muhurrakë si Lik Berisha, Ramë Prençi e të tjerë." (Naim Berisha Pushkën kurrë s'e lëshoi nga dora" Ushtima e mal.n.44 2.06. 1982) Nje figurë tjetër me shpirt patriotik e rebelues ndaj fashizmit ishte Nezir Këbej. Dhe ja si shkruhet për atë: "...censura fashiste e internoi Nezirin bashkë me shume antifashistë te tjerë shqiptar në kampin e e Ventotenës në Itali. Bisha naziste pas kapitullimit të Italisë fashiste të "pabindurin" Nezir Këbej nga një qeli në tjetrën e çoi në kampin e Mat'hauzenit (Gjermani S.M.)" (N.Berisha, Amneti I bab. Tri fj. të shejta. Ushtima e maleve f.3, 15.08. 1987) Muhurraku Ali Lleshi luftoi në portin e Durresit me 7 prill 1939 kundër ushtrisë fashistë italiane. Aqif Qoka bie dëshmor në Shkam të Krujës në vitin 1948, Xhetan Laci bie në luftime në Labino të Elbasanit, pastaj dëshmoret Ramadan Deva e Adem Dobi. Nuk po zgjatemi më tej se ato janë të shumtë në periudha të ndryshme historike. Shumë prej tyre duhen zbuluar nëpërmjet rapsodive popullore, dokumenteve e studimeve historike të autorëve të ndryshëm e kronikave të shtypit etj.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Fotoreportazh / Udhëtim në kohë

KOHË KORRJESH...

Korriku është muaji i korrjeve, muaji kur korret dhe shihet gruri, kur kositet e mblidhet bari e jonxha, kur vaditet misri, perimet e jonxha, kohë pune intensive, kohë që dibrani i punës e shfrytëzon deri në palcë.

Nga arkivi im fotografik nuk mund të lija jashtë "korrikut" disa fotografi me njerëz të punës...

A. ASHIKU



Nuk asht sharra, nuk asht turrela, / asht pushka e Dibrës lidhë me tela...
Selman Stafa një burrë i vogël, / nam të madh ka lan në Shkodër...

Okshtuni në këngët e trimërisë

Nga Prof. As. NAZMI KOÇI

Në një tubim intelektualësh dibranë, tek i dëgjoja pjesëmarrësit, ekspertë të fushave të ndryshme, mendja më shkoi të një ngjarje që një i afërmi im më kishte treguar kur isha fëmijë në shkollë fillore.

I shtrënguar nga hallet e jetës, ai, siç bënin zakonisht shumica e burrave nga anët tona, kishte shkuar për të punuar në Shkodër. E kishte bërë rrugën nga Okshtuni në Shkodër në këmbë dhe kur kishte arritur, i lodhur nga udhëtimi i gjatë, ishte ulur në kafe të madhe për të pirë një kafe e për t'u çlodhur pak. Dy të rinj që e kishin vënë re dhe e kishin kuptuar nga qelshja e bardhë se duhej të qe dibran, i ishin afruar për të "nxjerr kunj" me të, por ai i zgjuar siç ishte e kishte kuptuar menjëherë. Të rinjtë i thanë të pinte kafën dhe pastaj do të shkonte me ta. Ai piu kafën dhe i pyeti: përse me doni? Ata i qenë përgjigjur se nga veshja duhet të jesh dibranë, ju merreni me ndërtime dhe ne kemi nevojë të na ndërtohet një hajat për gomarë.

Po, u qe përgjigjur ustai, por si e doni dy hajate veç e veç, apo një për të dy së bashku?

Ata e kishin kuptuar ironinë therëse dhe kishin dashur të justifikoheshin. Ai më tej i kishte sqaruar:

Unë vërtetë jam dibran dhe merrem me ndërtime, por veproj sipas rastit. Kur e do puna ndërtoj shtëpi, po kur ma do puna edhe djeg shtëpi. Bashkëbiseduesit qenë larguar kokulur...

Mu kujtua kjo ngjarje pasi jemi mësuar ta njohim Bulqizën si vendi i kromit, i minatorëve, i nëntokës e i galerive, i njerëzve të ndershëm e punëtor. Por nuk dimë sa duhet për vlerat e zonës, për patriotizmin dhe trimëritë e bulqizakëve, për traditat dhe mirësitë e tyre. Gazeta Bulqiza me sa duket tenton të rrokë këtë dimension jo krejt të njohur të Bulqizës, jo vetëm atë të vendburimit të katërt të kromit në botë.

Në një farë kuptimi edhe unë jam bulqizak dhe kam detyrimet e mija. Okshtuni nga unë jam është një zgjatim i Bulqizës e Zerqanit, ka qenë historikisht pjesë e asaj nënprefekturë dhe veshja, sidomos ajo e grave, gjuha dhe zakonet tona kanë një ngjashmëri që e vë re kushdo. Ndaj vendosa të shkruaj diçka për fshatin tim...

Krahina e Okshtunit shtrihet në pjesën jugperëndimore të Dibrës dhe kufizohet me Çermenikën në jug dhe me Martaneshin në jugperëndim, është kufi ndarës i tre rretheve, pjesë e rëndësishme e Dibrës që e lidhte atë me Shqipërinë e e Mesme. Siç do të theksonte studiuesi ynë i mirënjohur Kristo Frashëri, kufijtë e trevës në shumicën e rasteve i ka përcaktuar vetë natyra - male të larta, të vështira e të pakapërcyeshme.

Okshtuni, i ndodhur në kufi të tre rretheve dhe nën trysinë e vazhdueshme të ambicieve



Malet e Okshtunit. Foto arkiv © Abdurahim Ashiku

të krahinave të tjera për territore e kullota, i ka vendosur kufijtë e tij historikisht sipas rrjedhjes së ujërave. Rrethohet nga tre anë me male të larta: Në lindje ndodhet mali i Brezhnikut, Maja e Zylit, maja e Gurit (lartësi 1850 m. mbi niveli e detit). Nga jugu ka Qafën e Prevallit që e lidh me Çermenikën, majën e Kalasë dhe fushën e Kolgirekut, ndërsa nga perëndimi malet e fushës së Kuqe, fusha e Drenit dhe Kaptina (1900m). Nga veriu kufizohet nga Fusha e Kishës, Mali i Zi, Shullani i Kuq, kodrat e Golemaranes dhe përroi i Cenajve. Okshtuni kufizohet nga lindja nga fshatrat Sebisht e Zabzun, nga jugu me Prevallin, në jug perëndim me Kostenjën dhe Martaneshin, nga veriu me Tërnovën dhe Lejçanin. Ka një sipërfaqe terriori prej rreth 140 km² dhe përbëhet prej 5 fshatrave:

Fshati Prodan, fshati im i lindjes, me një histori shumë interesant dhe qytezë ilire e që shtrihet më në jug.

Okshtuni i Vogël ka dy lagje, Shulla e Plepe e shtrihet në perëndim të Zallit Prodan e Shulla.

Fshati Oreshnjë me lagjet Oreshnjë e Golemarane e që ndodhet në perëndim të zallit të Okshtuni.

Fshati Muglicë që shtrihet në perëndim të Zallit të Sebishtit.

Okshtuni i Madh me lagjet Katund, Cenaj e Ballaj.

Okshtuni është një krahinë krejt e veçantë, pjesë e rëndësishme e Dibrës, e gjeografisë dhe historisë së saj. Edhe pse ka qenë në kufij me krahina e rrethe të tjerë, ka jetuar në fqinjësi të mirë me ta (kur një gjë e tillë është varur prej tij) dhe po ashtu ka ruajtur besnikërisht traditat e zakonet e veta dhe ka luftuar në shekuj për lirinë, gjuhën e pavarësinë e vendit të vet e ndër shekuj është krenuar me përkatësinë e tij si trevë e Dibrës. Ka luftuar e derdhur gjak për të dhe i ka kënduar me pathos këngë Dibrës dhe shqiptarisë. Fqinjësia me krahina të tjera as nuk e ka asimiluar dhe as e ka tjetërsuar këtë krahinë. Një përcaktim të qartë për Okshtunin

si trevë dhe banorët e tij ka bërë autori Imer Stojku në librin e tij "Dibra në vite", botuar në vitin 2002.

Popullsia e Okshtunit vitet e fundit është rrudhur së tepërmi.

Duke qenë një krahinë tejet specifike, me tradita të vyera ku spikatin besa e bujaria, dashuria për krahinën dhe për vendin, trimëria e zgjuarsia, mikpritja e kultura e punës, dashuria deri në vetëmohim për gjuhën shqipe, arsimin, kulturën dhe folklorin e Dibrës e plot cilësi të tjera të veçanta, Okshtuni meriton të studiohet e vlerësohet në meritë si një trevë dinjitoze (7). Ka shumë gjëra për të thënë për Okshtunin e banorët e tij, kësaj radhe unë zgjodha të shkruaj disa radhë për këngët e tij. Kjo gjë merr rëndësi të posaçme në këtë kohë pasi shumë nga banorët e Okshtunit në vitet e demokracisë janë larguar nga krahina dhe janë vendosur në rrethe të ndryshme për një jetë më të mirë. Shumë nga pasardhësit tyre kanë ikur të vegjël, disa kanë lindur në vendbanimet e reja. Pas disa vitesh ata do të dinë pak për vendin e origjinës së tyre dhe për historinë e Okshtunit. Gjithashtu një ndarje territoriale e viteve të demokracisë bëri disa bashkime jo natyrale dhe e kaloi një pjesë të Okshtunit me komunën e Steblevës dhe këtë të fundit ia kaloi rrethit të Librazhdit, u bënë dy tjetërsime njëherësh, mbi të gjitha u cënua përkatësia e Okshtunit si pjesë e Dibrës. Megjithatë këto janë masa të karakterit administrativ. Okshtuni ishte dhe është pjesë e Dibrës.

Këngët, veçanërisht ato të trimërisë, të cilat kanë ardhur nëpër shekuj deri sot, me tekstet e tyre tregojnë ngjarje, ndodhi ku okshutnasit janë përballur me dinjitet për familjen, për pronën, për fshatin, për krahinën, për Dibrën dhe për vendin. Ata kanë dhënë edhe jetën, por nuk kanë pranuar të nëpërkëmben nga të tjerët edhe kur janë ndodhur në rrethana të pa favorshme a të vetmuar. Tekstet e këtyre këngëve kanë secili nga një histori. Copëzat e historisë, bëjnë historinë e krahinës, të Dibrës dhe më gjerë.

Nuk është qëllimi im të sjellë në këto radhë besnikërisht tekstet e plota të këngëve të krahinës, qëllimi është të evokojmë disa ngjarje dhe kontekstin në të cilin ato janë krijuar e kënduar. Lidhur me tekstet e këngëve të trimërisë të Okshtunit kanë shkruar shumë autorë si Haki Stërmilli, Bilal Salku, Selman Koçi, Imer Stojku e ndonjë tjetër.

Një nga këngët e vjetra që i këndon trimërisë së kësaj zone është ajo e Selman Stafës. Sipas shumicës së autorëve që janë marrë me këtë problem, ajo daton më shumë se dy shekuj më parë, i kushtohet një ngjarje që ka ndodhur rreth gjysmës së para të shekullit 19-të. Burrat e kësaj zone duke jetuar në një vend malor e me pak tokë, detyroheshin të emigronin më shumë se gjysmën e vitit për të përballuar vështirësitë e jetesës. Ata rrahën rrugët e kurbetit në Stamboll e Selanik, shkuan gjer në Bullgari e Rumani, por për ta ishin të zakonshme lëvizjet brenda territorit shqiptar ku punonin si specialistë; në Dibër, Strugë, Gostivar, Elbasan, Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Mat, Shkodër e gjetkë.

Në një rast të tillë Selman Stafa nga Okshtuni

u ndodh në Shkodër së bashku me mikun e tij nga Ternova, Osman Gjokën. Një mbrëmje Selmani po kthehej i vetëm në banesën ku flinin, i lodhur, i veshur me rrobat e pluhurosura të punës dhe duke medituar për hallet e familjen e vet. Befas u ndodh përballë me valiun turk të Shkodrës, Haxhi Mela, i cili i hipur në kalë dhe i rrethuar nga 20 sejmënë në të dy krahët, po bënte xhiron e mbrëmjes. Kur e vuri re, Selmani ishte mjaft afër tij, sejmënët i bënë shenjë që të hapte rrugën dhe ai atë tentoi të bënte. Sidoqoftë rrugicat e ngushta dhe eskorta e madhe nuk i dhanë hapësirë sa duhet. Ai u mbështet pas murit, por kur kaloi Valiu, shpata e tij preku në rrobat e ustait dhe ai mbajti kalin.

- "Nga je ti?" - e pyeti.

- Nga Dibra", ju përgjigj tjetri.

- "Ore 'gogë' Dibre, a nuk e sheh se me bgane tagane" (me bëre pis shpatën). Ustai u ndodh i vetëm dhe i paarmatosur. U largua i mërziutur për në banesën e tij. Ai tashmë e kishte marrë një vendim. Nuk kishte armë, por ishte i armatosur me krenarinë e dibranit dhe mjeshtërinë e përgatitjes artizanale të armëve. Kështu iu fut menjëherë punës për përgatitjen e një naganti. Kur erdhi Osmani e gjeti të mërziutur e duke përgatitur armën. Ai e pyeti shumë herë se përse ishte mërziutur, por nuk mori përgjigje. Pasi insistoi shumë herë Selmani i tha se kishte vendosur të vdiste të nesërmen.

- "Përse?, i tha Osmani, në se është nevoja do të vdesim të dy bashkë".

I tregoi historinë me valiun, por Osmani u përpoq ta qetësonte.

- Po ne "gogë" jemi vërtetë përderisa nuk na mban vendi jonë dhe detyrohemi të endemi për të mbajtur familjen. Por Selmani ju përgjigj shkurt.

- Ai nuk më tha "Gogë", por "Gogë Dibre", nuk më shau si person, por më shau Dibrën. Sonte në Shkodër Dibrës vetëm unë i kam qëlluar, nesër do t'i dal zot. Përgatitjen të dy nga një nagant, i provuan në një pus aty afër dhe që të ishin të siguri u lidhën me tela nga dy plumba, në mos i pari i dyti do të ndizte.

Të nesërmen Selmani në të njëjtën orë ja zuri me qëllim rrugën valiut. Pranë kishte dhe Osmanin. Kur kaloi aty vali u ai e preku me qëllim, vali u njohu, mbajti kalin dhe ju drejtua:

- Prapë ti, "gogë Dibre"?

Selmani ju përgjigj:

- Nuk jam gogë Dibre, por zog Dibre - iu përgjigj. Dhe e qëllloi në mes të 20 sejmënëve mu në krahator.

Kur vali u rrezikoi nga kali, Osmani nga prapa shokut e qëllloi mes këmbëve të tij direkt në kokë dhe vali u vdiq në vend.

Sejmënët i ndoqën, e kapën Osmanin, por Selmani u fsheh. Shkodranët e mbrojtën atë duke rrezikuar jetët e tyre.

Dhe populli thuri këngë:

Ç'asht kjo luftë e ky tufanë,
Luftë po bajnë nja dy dibranë,
Selman Stafa me Osmanë,
Haxhi Melës sa mirë ja banë,
Hajde, hajde Haxhi Mela,
Nuk asht sharra, nuk asht turrela,
Asht pushka e Dibrës lidh me tela,
Lidh me tela e zinxhirë,
Qenka mbushur për vezirë,
Lidhur plumbat bisht për bishti,
Të dy djemve u lumtë gishti,
Haxhi Mela nxjerr taganë,
Donë me vra usta Selmanë,
S'mund ta vrasësh usta Selmanë,
se shoq të mirë kishte Osmanë,
Selman Stafa një burrë i vogël,
nam të madh ka lan në Shkodër.

Ngjarja vazhdoi me hakmarrjen e pushtetit të kohës, perandoria u trondit. Për kokën e usta Selmanit, motra e valiut vuri gjysmën e Shkodrës. Shkodranet qëndruan, nuk e dorëzuan trimin nga Dibra, ai ishte bërë idhulli i tyre.

Dhe kënga mbyllet me vargjet:

Ty o Shkodër të qofsha falë

Mu bëre nënë, t'u bëra djalë.

Vargjet e këngës kanë arritur deri në kohët tona, me ndonjë ndryshim të vogël ajo vazhdon të këndohet edhe sot e kësaj dite...

(Vijon numrin e ardhshëm)

Sebishti. Foto arkiv © Abdurahim Ashiku



Festivali "Muza poetike budiane" ishte tregues i forcave krijuese të trevës, model i bashkërendimit të punës mes organeve të qeverisjes vendore dhe Klubit të Shkrimtarëve të Matit. Do të mbetet në kujtesë, jo vetëm të poetëve pjesëmarrës, por dhe të të pranishmëve, dashamirës të fjalës poetike.

Muza poetike budiane, ushqim i shpirtit artdashës

Nga **HAMDI HYSUKA**

Në nderim të 450-vjetorit të lindjes së Pjetër Budit, poetit dhe prozatorit të parë të letërsisë shqipe, Qendra Kulturore Mat, Qendra Shqiptare e Studimeve Letrare "Pjetër Budi" Tiranë dhe Klubi i Shkrimtarëve Mat, organizuan në fillim të muajit Festivalin e Parë të Poezisë "Muza poetike budiane" Mat 2016. Morën pjesë poetë matianë e të ftuar nga qytete e trevat shqiptare, pasardhës të Budit, shkrimtarë, artistë, deputetë, drejtues të qeverisjes vendore, punonjës të arsimit e kulturës, pasardhës të familjes Budi, media lokale, të rinj e të reja. Mirëseardhjen festivalistëve ua uroi kryetari i Bashkisë Mat, zoti Nezir Rizvani.

Në prag të mbajtjes së festivalit, akademiku Rexhep Qosja shfrytëzoi rastin duke na uruar për gjithë veprimtaritë që janë bërë dhe po bëhen për shënimin sa më të plotë e më të gjithanshëm të përvjetorit të lindjes së Pjetër Budit.

"Ju dhe Klubi i Shkrimtarëve Mat, në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare të Studimeve Letrare "Pjetër Budi" Tiranë, -thekson në përshëndetje, -po bëni një punë shumë, shumë të rëndësishme kulturore, letrare, gjithëkombëtare. Po shënoni përvjetorin e një figure shumë të rëndësishme kulturore e historike, që me të drejtë çmohet poeti i parë shqiptar, për të cilin mund të thuhet se dhuntinë krijuese poetike dhe letrare shqiptare në përgjithësi e dëshmoi në një kohë larg të shkuar, kur kushtet shoqërore, kulturore e historike ishin tepër të rënda për një dëshmim të tillë. Dhe, kjo e dhënë e bën edhe më të rëndësishme krijimtarinë e tij, edhe më të madh emrin e tij, e edhe më të çmuar veprimtarinë tuaj për Pjetër Budin".

Kështu, arti dhe poezia mblodhën pranë vetes emra të njohur autorësh, poetë dhe studiues, kritikë letrarë dhe artdashës. Hapja e festivalit që një surprizë për të gjithë artdashësit, sepse me poezitë e tyre u ngjiten në skenë, shoqëruar me duartrokitje, poetë të njohur e të rinj.

I pari skenës së emocionit konkurues të poetëve pjesëmarrës iu ngjiti poeti Agim Gjakova dhe pas tij poetët e poetet Adile Baleta, Adritatike Lami, Agim Bajrami, Agim Gjakova, Aqif Heta, Bajram Canameti, Basir Bushkashi, Ervisa Ruka, Ethem Çipi, Fatmir Neli, Fato Male, Gjokë Dabaj, Hamdi Hysuka, Kolë Ndreka, Kurt Kola, Lindita Doda, Merita Rama, Mevlud Buci, Namik Selmani, Nuri Koleci, Qemal Cenaj, Sabri Aliaj, Sokol Lozhi, Sami Velçani, Shyqyri Koçi, Valentina Kurti. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. "Muza poetike budiane" i dhuroi Burrelit një atmosferë të ngarkuar me emocione, duke përmbushur detyrimin atdhetar ndaj poetit të parë shqiptar, Pjetër Budit të Gurit të Bardhë, të Matit dhe gjithë Shqipërisë.

Artdashësit përjetuan me emocione poezitë "Zemër e coptueme" dhe "Gruas sime" të poetit Agim Gjakova, "Bisedë me ullinjë e vendlindjes" dhe "Duke të pritur ty" të poetit Agim Bajrami, ato me titull "Për ty, burrë i kombit" e Adile Baletës dhe "Babait të poezisë" (kushuar Pjetër Budit) nga Bajram Canameti, "Ndre Mjeda" dhe "Një rë" të Basir Bushkashit, "Mallkoj lotin që më zgjoi" e "Truni jem kërkon me hangër" të autorit Gjokë Dabaj, "Qe maj, ditë nderimi" dhe "Pa moshë" të Hamdi Hysukës, "Mbahu Dej" dhe "Ecni lehtë mbi fosilet e dhimbjes" të autorese Lindita Doda, "Syth në pemë të madhe" e Fatmir Nelit, "Përditë takoj një Jago" e Sami Velçanit, "Në Londër foli burri i dheut (Isa Boletini) me autor Koli Ndrekin, fragmente të poemës "Epika budiane" të dibrano-matjanit Mevlud Buci, "Ty po të pres" (Në gjurmë të Emineskut) dhe "Shtylla" të Majlinda Nana Ramës, "Elegji për Pjetër Budin" dhe "Letër e ngrohtë nga Çamëria" të poetit Namik Selmani, sipas të cilit "ne dhe ata që do të vijnë pas nesh, kemi në sup barrën e amanetit të pathënë të poetit për ta bërë sa më të ndriçme fjalën e shqipes", "Hajnia" dhe "Nëse..." të Nuri Koleci, "Hapi krahët shqipe" dhe "Mall" nga Qemal Cenaj, "Barot Mati" e "Dola n'at buzë zalli" të poetit



e kompozitorit Sabri Aliaj, "Themel i vjetër" dhe "Mezi pres të vijë vjeshta" të Valentina Kurtit etj.

Studiuesi Behar Gjoka, drejtor i Qendrës Shqiptare të Studimeve Letrare "Pjetër Budi" Tiranë, duke folur për këtë jubile të madh, theksoi se sa kohë të ketë poetë dhe poezi, aq kohë do të ketë qenie njerëzore, do të ketë komb e shtet. Ky festival pason vizitën në shtëpinë e poetit në Gur të Bardhë, si dhe të mbajtjes së konferencës përkujtimore në Klos, më 23 prill, në Ditën Ndërkombëtare të Librit. Po ashtu, përvjetori i lindjes së Budit u përkujtua dhe në Panairin e Librit në Prishtinë, më 8 qershor të këtij viti. Mund të veçoj dy momente kryesore: së pari, nga 27 autorë pjesëmarrës, gati gjysma e tyre erdhën nga krahina të tjera, nga Kosova, Dibra e Madhe, Tirana, Fieri, Durrësi etj. Pra, festivali përmbushi përmasën e një takimi poetik kombëtar. Së dyti, pati autorë të rinj dhe poetë, që me krijimet e tyre i sollën festivalit zëra të ndryshëm. Me të drejtë festivali i poezisë "Muza poetike budiane" është pelegrinazh nderimi për poetin dhe prozatorin e parë të letrave shqipe.

Kurse skulptori i njohur, Fatos Kola, ngriti me dhimbje një shqetësim. "Kemi nderuar simbole pa kuptim, por harruam, -theksoi me zë të lartë, -që t'i ngremë përmendore babait tonë të gjuhësisë, për të cilin jemi mbledhur në këtë ditë nderimi. Edhe sa kohë do të vazhdojmë ta lejmë Budin pa varr e pa një monument?"

Nuk e teproj kur them, se festivali ishte një mrekulli, ushqim i shpirtit artdashës. Por në

gjirin e kësaj atmosfere, shkrimtari, studiuesi dhe poeti Gjokë Dabaj, tërhoqi vemendjen për poezitë konkuruese. "A arritëm të prekim shpirtin e dëgjuesve me ato që lexuam në skenë? Një Mjedë, dikur pati thënë: "Po shkrihet bora, / dimri po shkon..." Ne sot e dimë përmendësh atë çfarë tha Mjeda. Dhe një Gjergj Fishtë dikur pati thënë: "Eni, eni mori shkina, / eni eni te Vranina...", / e i mësoni djelm' tuaj mas sodit, / mos iu lakmoni tokës së Kastriotit...". I mbajmë mend sot që kur i ka thënë ai dikur... Po vrgjet tanë i mbajti mend kush? Sa ua kemi shpërblyer lexuesve, dëgjuesve me mjeshtërinë tonë, apo u jemi borxhlinj?! Unë e ndiej që jemi shumë borxhlinj ndaj lexuesit. Nëse erdhën kaq njerëz, s'i kemi tërhequr ne. Jemi ne ata borxhlinj, që nuk i kemi tërhequr aty, që rinia e Burrelit, intelektualët e Burrelit dhe të gjithë të tjerët çfarë janë, të vijnë e të na dëgjojnë. Pra, jemi ne fajtorë, jo ata. Prandaj të marrim përgjegjësitë tona mbi veten tonë, të krijojmë vepra më të mira. "Ti Shqipëri më jep nder, / më jep emrin shqiptar..." të gjithë e dimë. Gjithashtu edhe "shqiptar mos rri, / po duku shqiptar"... e dimë. Pse nuk di kush vargjet tona?! E përsëris, kemi borxhe ndaj lexuesit".

Ndërsa poetët durrsakë, Agim Bajrami dhe Sami Velçani, pas përfundimit të festivalit, u shprehën se ndjeheshin jashtëzakonisht mirë mes kolegëve matjanë e më gjërë, të cilët, siç theksuan, "na nderuat dhe respektuat me duartrokitje të ngrohta". Kurse për poeten e re matjane, Ervisa Ruka, çmimi nuk ka shumë

rëndësi. E rëndësishme dhe kënaqësi është të marrësh pjesë.

"Po t'i hedhim një sy hartës etnike shqiptare, -u shpreh gjatë përshëndetjes kryetari i Bashkisë z. Nezir Rizvani, -shohim se Mati ynë është në zemër të Shqipërisë etnike, me konfiguracion në formën e zemrës. Jo rastësisht ka qënë epiqendër e pricipatës së Arbërit dhe e Kastriotëve pak më vonë. Pra, nuk është rastësi që Pjetër Budi u lind në këto troje, klerik i madh, poet dhe atdhetar i madh. Poetët për nga natyra janë pak hyjnorë, idealistë dhe shumë patriotë. Ankohe se nuk lexohet poezia. Po poezia është shpirtërore. Sa të ekzistojë njeriu, do të ekzistojë dhe poezia".

"Një manifestim që meriton çdo lëvdatë, -u shpreh poeti i Dibrës së Madhe, Nuri Koleci. Të gjithë shqiptarët, -theksoi ai gjatë përshëndetjes, -po veçanërisht matianët, kanë me kë të mburren. Pjetër Budi tregon lartësinë e kulturës sonë. Fljalët më të sinqerta organizatorëve, poetëve dhe pjesëmarrësve, që na ngjallën emocione të papara. Dashtë Zoti që ky manifestim të vazhdojë edhe në të ardhmen".

Vërtet këtë festival poetik e përjetuam me emocion të veçantë, por siç thuhet, torta është e zbukuruar kur i vihet një qersh. Dhe qershia mbi tortë ishin tre fituesit. Për poezinë më të mirë, si dhe për kontributin e dhënë në lëvrimin e poezisë ndër vite, me mbështetje financiare të Qendrës Shqiptare të Studimeve Letrare "Pjetër Budi", juria profesionale ndau çmimet, shoqëruar me certifikatë dhe vlerë monetare simbolike. Çmimi special "Muza poetike budiane" Mat 2016 iu dha poetit kosovar Agim Gjakova, çmimi i parë poetit matjan Basir Bushkashi, ndërsa me çmim të dytë u vlerësua poetja Majlinda Nana Rama.

Festivali "Muza poetike budiane" ishte tregues i forcave krijuese të trevës, model i bashkërendimit të punës mes organeve të qeverisjes vendore dhe Klubit të Shkrimtarëve të Matit. Do të mbetet në kujtesë, jo vetëm të poetëve pjesëmarrës, por dhe të të pranishmëve, dashamirës të fjalës poetike. Në llojin e tij ky festival që gjithëpërfshirës, sepse në skenë u ngjiten poetë nga disa qytete të Shqipërisë dhe të gjitha viseve shqiptare. Drejtimi i moderatorit Sokol Meta dhe interpretimi nga Shkëlqim Farrici i këngëve "Gjuha shqipe m'shungullon", "Lufton Mati për liri", "Në këmbë tan' Kosova" sollën gjallëri, ritëm dhe freski.

RECENSË & POEZI


Një libër që përcjell tinguj dashurie

Nga **RENATO TOTRAKU**

Në këtë muaj të nxehtë të verës, për të ndalur vapën, vjen një fresk i hollë për ta shuar atë, vjen si një fllad ledhatues, libri me poezi me titull "Kjo quhet dashuri" me autoren Fitore Doma, nga fshati Pleshë, Bashkia Klos. Është libri i parë i saj. Me përmbajtjen e titujve dhe të vargjeve, pas leximit befasoshes, sepse ato poezi përveç frymëzimit dhe optimizmit, paraqesin një kompleks emocionesh që të mbërthejnë rreth temës së dashurisë, madje "forcërisht" të rrëmbejnë e të pozicionojnë brenda dashurisë.

Në nëntëdhjetë faqet dhe tetëdhjetë e shtatë poezitë, libri bëhet i dashur dhe i kërkuar për t'u lexuar, pasi brenda gjenden mendime, sugjerime dhe figura të bukura letrare, madje ka mjaft figura krahasuese që iu shërbejnë të interesuarve. Mund të themi, ky libër përbën një kufi midis ndjenjës dhe arsyes nga njëra anë dhe ndëshkimi i merituar "për tradhtarët" nga ana tjetër.

Autorja, ndonëse në profesion është mami-infermiere, me librin e saj, ajo të duket si një profesioniste me eksperiencë në fushën e krijimtarisë letrare. Qysh e vogël, gjatë viteve në shkollën 9-vjeçare, kishte pasion dhe dallohej midis moshatareve të saj për një të ardhme në krijimtarinë, në gjininë e poezisë dhe rezultati



i parë i saj i sukseshëm është botimi i këtij libri. Siç thuhet në popull se "oreksi vjen duke ngrënë", si thotë edhe vetë autorja në të ardh-

men do t'i përkushtohet më me pasion kësaj fushe të krijimtarisë poetike.

Në çdo strofë dhe varg të këtij libri, gjen një ide të veçantë dhe me shpërthim të saj, si të moshës ashtu dhe të jetës përmbushet ajo fjalë, që dashuria, si shprehje e ndjenjës dhe emocioneve për të. Që në kopertinë, ku është kompozuar një peisazh vjeshtë, ku nën hijet e pemëve dhe të gjitheve të vjeshtës piktoreske, është vendosur një stol i thjeshtë, por që bart brenda fllad dashurie. Ky peisazh, së bashku me disa trëndafila të harruar nga çifti në momentin e largimit, përcjell imazhin se këtu bëhet dashuri e sinqertë. Ky park i veshur me petkun e vjeshtës, përcjell idenë se dashuria vazhdon për jetë të jetës. Prapa librit në kopertinë, zë vend një fotografi me portretin e autorese "imcake", por simpatike, e cila krahas transmetimit të fjalëve biografike, bëhet përfaqësuese e moshës së rinisë, me ndjenjat e saj plot shprese e dashuri.

Përmbajtja e këtij libri me poezi, përbën një kompleks ndjenjash e zhvillimesh të botës shpirtërore, ku shfaqet fuqishëm optimizmi, por pa lënë mënjanë dhe hijen e pesimizmit, sepse jo rrallë jetë ka patur dhe ka dhe zhgënjime, që nuk i shërbejnë asaj që quhet DASHURI. Madje, kjo e fundit është përdorur dhe si një mesazh për të ardhmen, sidomos tek moshë e të rinjve, duke mbajtur një qëndrim kritik të

Për Jashar Haxhi Delishin, flasin faktet, lufta, puna, arsimimi, thjeshtësia, përkushtimi, krenaria legjitime për shkrepat e Selishtës, për shkallën e Pratit, Tollën, Zmaçin, Shkëmbin e Bilbilit, Runjen, Shëngjiothin, për kroin e ftohtë në Prat ku sa herë është njohur e freskuar edhe i biri inxhinier Fatmiri a të tjerët.

Jashar Delishi, veterani i lirisë

Nga MEVLUD BUCI

Jeta e njeriut ka prova. Këto i japin rrezatim, thjeshtësi e madhësi. Provat e jetës janë dëshmitë e djersës, të drejtësisë, të përkushtimit e të diturisë. Dibrani i Lezhës historike Jashar Haxhi Delishi nga Selishta e Katër-Grykëve nuk jeton më, por për mua që e kam njohur dhe i njoh provat e atdhetarisë, provat në LAN, provat në frontin e nderuar të ushtrisë më duket sikur e kemi të gjallë, sikur flasim, sikur i dëgjojmë zërin, fjalët e thjeshtësisë e të urtësisë, fjalë e krenarisë si veteran i lirisë, si ushtarak i paharruar i ushtrisë. Prova jete do të thotë prova, djersë, besë, prova të shpirtbardhësisë e të mirësisë. Këto ishin e mbeten dëshmitë e të paharruarit Jashar Haxhi Delishi.

FISI DELISHI I SELISHTËS SË KATËR-GRYKËVE

Fisi Delishi i Selishtës së Katër-Grykëve si kurse çdo fis e kullë në Dibër ka plot histori, qëndrese e bujarie, gjurmë të cilat u rrezatojnë kohërave, brezave. Përkrah selishtjanëve qëndruan edhe Delishët. Në shkallë të Pratit trimi Demir Delishi iu hodh pashait turk mbi kalë dhe thonë se e shqeu me shëmbë. Ngjarjet janë gdhendur në kujtesë, në bisedat e odave. Nga Selishta ishte "Vajsh Manuka me openga që kalasë kuçe i hini mrena, Haziz Xheka mustaqezi që ban luftë me ni urdi". (Ky në kullë të tij në Gjoricë, zbritur nga Selishta). Po kështu edhe Koka i Selishtës "Ali Koka ni trem drague, me kunja pashe nëpër thue, krejt u dogj e u shkërumue, la të ve nusen e re, faqebardhë hini në dhe". Qëndresë bënë edhe plot të tjerë prijës popullorë si Salë e Sefer Bodini.

Kur vikati Salë Bodini / U dridh toka, u tun qielli / Bini or trajma për liri / Ta bëjmë serbin shkëmb e hi...

Janë plot e plot ngjarje e figura të Selishtës, njëri prej nëntë maleve besnike e heroike të Dibrës, të cilët kanë shkruar epope lavdie. Në këtë mjedis atdhetari në kullat me rrasa guri, në odat e mençurisë u rrit dhe edukua babai i Jasharit Haxhi Delishi. Më 1942 Haxhi Delishi bleu tokën e Saraçëve në Kërçisht të Epër të Maqellarës.

U vendos atje me pesë djem e dy vajza me: Ismailin, Jasharin, Osmanin, Abdullahun, Halilin; Vajzat: Salien e Zilen, kurse në Selishtë la vetëm njërin nga 6 djemtë: Mehmetin. Burrë

i punës e urtësisë, i mikpritjes dhe vlerave të çmuara së bashku me djemtë u mëkëmb mirë, lartësoi traditat nga vinte dhe aty ku nisi jetën e re, në Kërçisht të Epër të Maqellarës.

JASHAR DELISHI NË SHITIGJET E LUFTËS E TË USHTRISË

Është sa lehtë aq edhe e vështirë, sa e thjeshtë aq edhe e rëndë dhe e madhërisme të gdhendësh vërtetësitë e jetës, provat e jetës. Këto janë vërtet si yjet që shëmbëllojnë në qiell, këto prova dëshmojnë qenien njeri, rritjen dhe rrezatimin, mirësitë dhe dëshmitë e shpirtit. Kështu të ndodhë me gjurmët e provat e jetës të Jashar Haxhi Delishit të Selishtës së Katër-Grykëve të Dibrës. Provat e punës e të luftës së këtij ish luftëtari të lirisë, ish ushtaraku shembullor, kurrsesi nuk mund të bëhen në plotësi në caqet e një shkrimi, ata meritojnë kronika të gjata, faqe të shumta monografie, sepse janë modeli i thjeshtësisë, i përkushtimit, modeli i njeriut, luftëtarit, ushtarakut e intelektualit të lidhur me atdheun, me vendlindjen, me llogoret, me traditat e luftës e të punës.

Jashar Delishi u lind më 31.7.1924 në Selishtën mes shkrepave. Mësimet e para i mori në vendlindje. Babai, Haxhiu dhe e ëma Maksude bija e Kokës së Lukanit e edukuar me virtytet më të mira njerëzore. Djalë i urtësisë, me kulturë të leme si i thonë, i guximshëm, i matur, i thjeshtë e me shpirt krenarie, për të afërmit, fisin, vendlindjen, me përkushtim për jetën. Jashari në gusht 1944 u bashkua me luftëtarët e Brigadës 18-të Sulmuese. Luftoi përkrah trimave të lirisë në Dibër, Kolesjan, Dragash etj. Një jetë në luftë për jetën, tokën, lirinë, një jetë në llogore të atdheut. Pas çlirimit vazhdoi shkollën për oficer në Tiranë. Pas përfundimit të mësimëve shërbeu me devotshmëri në Kukës, Gjirrokastër, Burrel, Shëngjin, Laç, përfundimisht në Lezhë. Në vitet 1963-1970 la familjen në Laç (Kurbin), dhe në vitet 1963-1966 përfundoi me rezultate të larta Akademinë Ushtarake për prapavijë. Shëmbëlloeu si major me dije e përkushtim me takt e thjeshtësi duke lënë mbresa tek eprorët, tek vartësit, kurdoherë me prova diturie, organizimi e gatishmërie, siç i ka hije nga luftëtari, një biri të urtë, një ushtaraku të lidhur me llogoret e atdheut. Në krah kurdoherë i erdhi edhe bashkëshortja e nderuar Zyrie Delishi (Markja) bija e Azem e Shefkie Markës nga Al-

labejgia (Burimi) i Maqellarës. Prova në udhët e jetës dhanë edhe 6 fëmijët e Jashar e Zyrie Delishit, fëmijë të mbarë, të kulturuar secili më i mirë se tjetri: Nazmia, Natasha, Fatmiri, Kujtimi, Luljeta, Suzana dhe Vera. Nga këto 5 me shkollë të lartë.

Fatmiri (inxhinier), Kujtimi (oficer), Luljeta (doktoreshë gjinekologe), Suzana (merceologe tani në emigrim në Angli), Vera (mësuese me arsim të lartë për ciklin fillor, themelin e diturisë), Nazmia e Natasha (ekonomiste). Kur një ecjen në udhët e jetës të fëmijëve të Jashar Delishit, s'ke si nuk kujton filozofin e Rilindjes Sami Frashëri, i cili thoshte: Njeriu më i lumtur është ai që ka fëmijë të edukuar. Prova jete, prova diturie e pune, prova malli e krenarie për vendlindjen, për kombin, e mbi të gjitha për detyrën, kanë të 6 fëmijët e Jashar Delishit, po kështu edhe nipërit e mbesat. Pra del ajo që thotë i shquari, filozofi popull: Ku rrjedh pikon; bëmë baba të të ngjaj.

Për Jashar Haxhi Delishin, flasin faktet, lufta, puna, arsimimi, thjeshtësia, përkushtimi, krenaria legjitime për shkrepat e Selishtës, për shkallën e Pratit, Tollën, Zmaçin, Shkëmbin e Bilbilit, Runjen, Shëngjiothin, për kroin e ftohtë në Prat ku sa herë është njohur e freskuar edhe i biri inxhinier Fatmiri a të tjerët.

PROVA JETE...

Dekorimet nuk janë stoli por prova jete, prova atdhetarie e fisnikërie. Jashar Delishi mban dekoracionin "10 vjetori i Ushtrisë" nga Ministria e Mbrojtjes, urdhrin "Ylli i Kuq" (më 06.07.1955 dhe 1.07.1965) (Dekret 2081 dhe 4026) e Medaljen e trimërisë" (4.10.1954, dekret 1940), "Urdhërin e Skënderbeut", klasi III (6.06.1960 dekret 3121), "Medaljen e punës (dhënë më 15.10.1979, dekret 5978), Çertifikatë të Këshillit të Ministrave "Për kontribut të shquar në çlirimin e atdheut", dëshminë e Brigadës 18 Sulmuese dhënë nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare plot fletë nderi etj. Prova që flasin, prova trimëria, prova pune e atdhetarie, prova të fisnikërisë, prova jete...

KRENARI BREZASH

Po thuajse kanë kaluar mbi 40 e ca vite kur u njoha birin e shquar të vendlindjes time, ushtarakun Skënderbegas Jashar Haxhi Deli-



Jashar Haxhi Delishi

shi. Kushedi sa e sa herë qëndruam bashkë në Lezhë, Qafëmurrë e gjetkë. E kam mbajtur peng për shumë vite që të gdhend qoftë edhe pak radhë ai ishte burrë i karareve, njëhte traditat, ligjet, peshën e bukur të fjalës, ai e donte e përmallohej me Selishtën, me Dibrën, me çdo trevë të atdheut. Secili nga fëmijët e tij ka marrë shumë nga i ati, nga shpirti, mençuria e bujaria e tij. Inxhinier Fatmiri, drejtori rajonal i Lezhës (Lezhë, Mirditë, Kurbin) pra, drejtori rajonal i punësimit ka një CV të shkëlqyer, ka prova djersë e organizimi, prova jete, së bashku me bashkëshorten, ish deputeten e nderuar (dha dorëheqje për arsye shëndetësore) juristë dhe prokurorë Merjeme Delishi. Provat e përkushtimit të saj, të drejtësisë flasin me Prokurorinë e Shkodrës e të Lezhës, vazhdon notere në Lezhë, bija e urtë e Ibrahim e Durie Kaçaçit, intelektuale e palodhur, me gjumë e prova pune, me shëmbëllim drejtësie. Fatmiri dhe Merjema kanë rritur e edukuar fëmijën e vetëm Sidritin, i cili vazhdon master për drejtësi. Familja Delishi ka bërë emër në qytetin e Lezhës. Emër pune, emër mençurie e atdhetarie. Major Jashar Delishi, ish-luftëtar i lirisë, shëmbëlloeu mbi 30 vite në ushtri. Fëmijët e të afërmit e tij, vendlindja Selishta vendbanimi Lezha e kudo që punoi e kujtojnë dhe e nderojnë. Më 1 gusht 2004 në moshë 80-vjeçare u nda nga jeta, dy ditë më vonë më 3 gusht 2004 vdiq edhe bashkëshortja, gruaja fisnike Zyrie Delishi (Markja). Vërtet jeta është e shkurtër, por kur lufton e punon si Jashar Delishi e fëmijët e tij në heshtje shkruhet përjetësia e djersës, e diturisë dhe e mirësisë. Dritë në breza e kohëra Jashar Haxhi Delishi – dibrani i provave të jetës.

hapur e të brendshëm, herë me nënkuptime dhe herë direkt me shpjegime poetike, si një e keqe shumë e madhe që i kanoset jetës në çift në përgjithësi dhe asaj të rinisë në veçanti, duke cënuar e rrenuar konceptin dhe qëndrimin rreth dashurisë. Meditimi dhe rruga për të arritur tek dashuria e vërtetë dhe e sinqertë, ku herë për shkak të nxitimit dhe herë për shkak të mos-thellimit, kanë sjellë anomali njerëzore në këtë fushë. Edhe pse nuk është vetë protagoniste, autorja të jep arsye dhe mënyrën se faktor në prishjen e dashurisë, shpesh janë faktorët logjistikë, që në kushte të vështira social-ekonomike dëmton "shëndetin e të dashuruarve" në çift. Faktori ekonomik jo se nuk duhet, por ai nuk mund të jetë thelbësor në atë që i bashkon të dashuruarit. Së këtejmi autorja, nëpërmjet disa vargjeve, kritikon dëshirat e shthurura, e kërkon lidhjen jo thjeshtë si një akt i veçuar, por si një proces logjik i shëndoshë, që krahas njohjes së thellë midis të rinjve, vëmendje i kushton karakterit dhe zotërimit të tij në dobi të harmonisë dashurore të qëndrueshme dhe se duhet të vijë duke u thelluar për ta mbrojtur dhe përjetuar aktivisht ndjenjën e dashurisë së sinqertë, e cila jo vetëm është e domosdoshme si shpirt, por si një proces trashëgimie midis çifteve. Bashkëjetesa është një nga faktorët për njohje e zhvillim të këtij karakteri njerëzor.

Titujt e poezisë janë me përmbajtje të shëndoshë ideore që të mbërthejnë fort pas murit të "kalasë familje". Të tillë janë titujt: "Ç'ke moj zemër"; "Këtë natë nuk kam gjumë"; "Dua të lundroj"; "Lëre zemrën që të rrahë"; "Tije lumturia ime"; "Parajsa ime je ti"; "Kurbeti"; "Një pikë loti"; "Mjekoje zemrën që ma çave";

"Nuse unë, dhëndri ti" etj, përveçse evidentojnë jetë, ato përcjellin dhe mesazhe dhe si ngjyra ylberi, thithen nga retë në prag shiu, duke forcuar karakterin dhe ndjenjat njerëzore kur bëhet fjalë për dashuri të fortë e të sinqertë.

Këto tituj, bashkë me figurat e shumta letrare e bëjnë librin jo vetëm tërheqës për lexuesin, por dhe udhërrëfyes në jetën e përditshme, sa herë gjendesh në këto rrethana dashurore. Ato përbëjnë "sulm" apo "tërheqje" si një mësim për të gjithë. Libri në tërësinë e tij i bëhet shok aktiv moshës së rinisë, por jo vetëm. Brenda tij ka episode investigative që shërbejnë si një "ilaç" për të shëndoshur fenomenin dashuri. Libri përshkohet nga një ekuacion me dy të panjohura: atë të zgjedhjes së rrugës së shkurtër për t'u lidhur dhe atë të largimit për të mos rënë në "humnerë". Metodikisht, secili nga ky libër mund të marrë më të mirën, që i shërben ndërtimit të familjes së shëndoshë.

Libri tregtohet në të gjitha dyqanet e shitjes së librit dhe kushton vetëm 500 lekë. Është estetik dhe praktik në përdorim. Zënia vend në bibliotekën e çdo qytetari lexues, rrit jo vetëm fondin, por dhe personalitetin e çdo lexuesi. Për këtë e të tjera veçori positive, lexuesi me siguri do t'i përcjellë autore mirënjohje.

T'i fala të gjitha

Të fala qetësinë, me shiun e verës
Të fala krahët, me filladin e pranverës
Të fala bukurinë, me flokët e borës
Të fala shpirtin tim, me gishtat e dorës
Të lash çastet e mia, në akrepat e orës



Të fala buzëqeshjet, në cepat e buzës
Të fala dashurinë, me gonxhen e lules
Të fala jetën, në hapat e kohës.

Buza e qeshur

Ku po bisedonim bashkë
Sytë e mi po të shikonin me shumë dashuri
Papitur ranë dy pika lot buzë
Me puthjen tënde doje me m'i fshi.

Nga emocionet s'të lejova fare
Por t'i mua më puthe pa dashje
Lotin ma fshive në buzë
Duke më thënë të kam dashur dhe të dua shumë.

Pa titull

Afër meje ti nuk je
Ku ndodhesh vallë ti i dashur
Po më digjet për ty zemra e shkreta
Shpirti më është kalbur.

Ty të kam në zemër dhe shumë të ruaj
Kodi i saj është emri yt
Askush tjetër s'do hyjë tek mua
Sepse ty të kam shtrenjtën dashuri.

Lamtumirë

Mora një L
Largohu nga unë
Mora një A
Andej ik
Mora një M
Më lër të getë
Mora një T
Tradhtar qenke ti
Mora një U
Të urrej ik
Mora një M
Të qetë më li
Mora një I
Interesaxhi qenke
Mora një R
Ringjallje pak jetën
Mora një E
Ëndrën s'ma realizove.

